

Dhjetor 2012
Numri: 57
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 150 Lekë
Kosovë: 1 Euro
Maqedoni: 60 Den

LA



dhe

IL-LA





Editorial

“La” është procesi i pastrimit dhe filtrimit të mendjes nga çdo gjë e papranueshme. Ndërsa **“il-la”** është procesi i vendosjes së të vërtetës themelore në bazamentin e mendjes së pastruar plotësisht.

“La” dhe **“il-la”** janë stacione pjekurie të mendjes. Nuk mund të ecet gjithmonë me **“la”**, sepse kjo do të thotë të shumëzosh me hiç çdo gjë tjetër. Kur mendja kalon nga **“la”** tek **“il-la”**, arrin pjekurinë dhe besimin e vërtetë.

Përdorimin më të qartë dhe më të afërt të **“la”** dhe **“il-la”**, e gjejmë te Formula e Teuhidit.

- La ilahe il-lallah

Nëse e shqyrtojmë këtë përdorim, vëmë re se këto fjalë janë krijuar për të qëndruar pranë njëra-tjetrës. Mbase për këtë arsye, Islami i ka përmbledhur pjesët më themelore të besimit në këto katër fjalë.

A ka ndonjë vend tjetër ku **“la”** dhe **“il-la”** mund të përdoren në mënyrë kaq ndikuese? Një vend ku **“la”** fiton një identitet kaq mohues dhe **“il-la”** një identitet kaq këmbëngulës në ekzistencë dhe ku ky përdorim fiton një cilësi kaq jetësore?

Me shprehjen **“la ilahe”**, themi **“nuk ka Zot”**. Ky është një pohim i rëndë. Prandaj nuk mund të qëndrohet këtu. Nëse i japim **“la”** së qëndrueshmëri në rolin që ka këtu, mendja juaj shkon drejt shkatërrimit, sepse nuk është e mundur të mendohet një botë **“pa Zot”**.

Për të deklaruar ekzistencën dhe njëshmërinë e **“Allahut”** me qartësi dhe pa lënë pas asnjë fije dyshimi, më parë duhet bërë **“një mohim gjithëpërfshirës”** dhe më pas vjen në mënyrën më të qartë të mundshme, **“deklarimi i ekzistencës”**.

Sigurisht që në edukimin e **“Teuhidit të vërtetë”**, është paraparë që **“la”**-ja të kryejë pastrimin e vërtetë të mendjes. Prandaj, njeriu duhet të jetë i vetëdijshëm ndaj çdo gjëje që përmban rrezikun për t’u konsideruar si një **“zot”** dhe kur të thotë **“la”**, nga mendja e tij duhet të pastrohen të gjitha fundërrinat.

Kurani i identifikon ato që njerëzit adhurojnë si **“zot”** dhe kërkon të vendosë formulën e teuhidit në vend të tyre. Ndër ato që njerëzit i adhurojnë si **“zot”**, mund të përmendim:

- Shenjtërimi i **“heva”**së, pra i dëshirave të ulëta të nefsit...
- Shenjtërimi i atyre që cilësohen si **“tagut”**. Pra, çdo përqendrim fuqie e cila pretendohet të jetë e fortë kundër Allahut...
- Shenjtërimi i njerëzve të fesë dhe murgjve, nëse pranohet gjykimi i tyre kur e bëjnë hallallin haram dhe haramin hallall...
- Shenjtërimi i gurit, drurit, diellit, hënës etj...
- Shenjtërimi i vetes nga ana e liderëve politikë ose besimi nga ana e të tjerëve se ata zotërojnë fuqi hyjnore...
- Shenjtërimi i pasurisë dhe pronës...
- Dashuria dhe respekti i tepëruar për fëmijët apo familjen, deri në atë masë sa të shtyjnë dikë që, për hir të dashurisë ndaj tyre, të shkelë urdhrat dhe ndalesat e Allahut Teala...

Do të lexoni:


Ahmet Tashgetiren / 4	La dhe Il-la
Prof. dr. Hasan K. Jëllmaz / 6	Të jetosh me vetëdijen e Teuhidit
Bedri Telegrafi / 10	Kontributi i Hafiz Ali Korçës për arsimin dhe shkollën shqipe
Dr. Adem Ergyl / 14	Anatomia e brengosjes
Nexhat Ibrahimimi / 16	Duke lexuar veprën "OSMANËT" të autorit Osman Nuri Topbash
Mustafa Erish / 20	Ç'të mbjellësh do të korrësh
Edison Çeraç / 22	Për etikën dhe historinë
Xhafer Durmush / 24	Llogaria e namazit
Altin Torba / 26	Drejt lumturisë, objektivi optimal
Ali Riza Temel / 30	Shiko kurthin dhe jo ushqimin
A. Jasin Demirxhi / 33	E fshehta e shprehjes "La ilahe il-lall-llah"
Ma. Luan Ahmeti / 34	Shpallja kuranore dhe synimi i saj
/ 36	Fotoja e Muajit
/ 38-39	Një ajet - Një hadith

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz



6

Nexhat Ibrahimimi



16

Altin Torba



26

Viti: VI | Numri: 57 | Dhjetor 2012

Drejtor & Kryeredaktor:

Alban Kali

albankali@yahoo.com

+355 67 20 86767

Redaktor:

Zija Vukaj

Korrektore:

Dr. Irida Hoti

Përkthyesit:

Albert Halili / Arjan Ymeraj

Artur Tagani / Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

Dizajn-Grafik:

Bledar Xama

bledar_xama@hotmail.com

Për artikuj:

e-mail: revistaetika@progresibotime.com

Dhjetor 2012

40

Osman Nuri Topbash



Muhammedul - Emin

"Probleme në rrugën e jetës Islame"
një libër me vlerë në duart
e rinisë islame...

40 / **Osman Nuri Topbash**

44 / **Imam Muhamed Sytari**

50

Neslihan Nur Turk



Humanizmi, feja e epokës

Ligji kozmik

Marrëdhëniet Kuran-njeri

Njeti i singertë

Qytetërimi Islam

Që kur lind,
njeriu është shumë plak për të vdekur

46 / **Xhemil Meriç**

48 / **Ramazan Çelik**

50 / **Semra Kyrin Çekmegil**

52 / **Muhammed El-Gazali**

54 / **Prof. dr. Zija Kazëxhë**

58 / **Nuredin Nazarko**

Respekti është si një kandil

Përse "Një ymet i vetëm" ka mbetur
thjesh një sllogan emocional?

Veprimtaria e qeverisë së Vlorës

Të rinjtë sotshëm si mejtojnë
dhe kujt i mbesojnë?

Butësia

Njeriu duhet të dijë se çfarë ha

Historia e postës elektronike

Berisha: Rishqyrtim
të historisë kombëtare

60 / **Neslihan Nur Turk**

62 / **Asgar Ali Enginer**

66 / **Ma. Ermal Nurja**

68 / **Zani i s'kaluemes**

70 / **Naim Drijaj**


72 / **Shëndet**

73 / **Teknologji**

74 / **Aktualitet**

62

Asgar Ali Enginer



PROGRESI
BOTIME
www.progresibotime.com

Adresa:

L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi
Shkodër / Albania

Tel: +355 22 254 634
Fax: +355 22 254 633

Zyra e përfaqësimit Maqedoni

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25
Shkup / Maqedoni
+389 71 956 271

Zyra e përfaqësimit Kosovë:

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin
Prizren / Kosovë
Tel: +381 29 222 795
Fax: +381 29 222 797
+377 4411 98 48

Çmimi:

Shqipëri: 150 Lekë

Abonim (një vjetor): 1500 Lekë

Kosovë: 1 Euro

Abonim (një vjetor): 10 Euro

Maqedoni: 60 DEN

Abonim (një vjetor): 720 DEN

Europë: 2 Euro

Abonim (një vjetor): 24 Euro

Ahmet Tashgetiren

La dhe Il-la



“La” dhe “il-la...”

Kjo është një disiplinë mendimi.

“Përkufizimi” i përkufizimit, është i lidhur pikërisht me këtë disiplinë mendimi.

Përkufizimi është procesi i inkudrimit të plotë të pjesëve përbërëse dhe lënia jashtë e pjesëve të huaja. Këtë disiplinë mendimi, Kurani na e mëson me anë të parimit themelor të besimit.

“La” është procesi i pastrimit dhe filtrimit të mendjes nga çdo gjë e papranueshme. Ndërsa **“il-la”** është procesi i vendosjes së të vërtetës themelore në bazamentin e mendjes së pastruar plotësisht.

“La” dhe “il-la” janë stacione të cilat duhet të jenë në shkallë të caktuara të mendjes. Nuk mund të ecet gjithmonë me **“la”**, sepse kjo do të thotë të shumëzosh me hiç çdo gjë tjetër. Kur mendja kalon nga **“la”** tek **“il-la”**, arrin pjekurinë dhe besimin e vërtetë.

Përdorimin më të qartë dhe më të afërt të **“la” dhe “il-la”**, e gjejmë te Formula e Teuhidit.

- La ilahe il-lallah

Nëse e shqyrtojmë këtë përdorim, vëmë re se këto fjalë janë krijuar për të qëndruar pranë njëra-tjetrës. Mbase për këtë arsye, Islami i ka përmbledhur pjesët më themelore të besimit në këto katër fjalë.

A ka ndonjë vend tjetër ku **“la” dhe “il-la”** mund të përdoren në mënyrë kaq ndikuese? Një vend ku **“la”** fiton një identitet kaq mohues dhe **“il-la”** një identitet kaq këmbëngulës në ekzistencë dhe ku ky përdorim fiton një cilësi kaq jetësore? Në fakt, kjo nuk dihet!

Me shprehjen **“la ilahe”**, themi **“nuk ka Zot”**. Ky është një pohim i rëndë. Prandaj nuk mund të qëndrohet këtu. Nëse i japim **“la”** së qëndrueshmëri në rolin që ka këtu, mendja juaj shkon drejt shkatërrimit, sepse nuk është e mundur të mendohet një botë **“pa Zot”**.

Për të deklaruar ekzistencën dhe njëshmërinë e **“Allahut”** me qartësi dhe pa lënë pas asnjë fije dyshimi, më parë duhet bërë **“një mohim gjithëpërfshirës”** dhe më pas vjen në mënyrën më të qartë të mundshme, **“deklarimi i ekzistencës”**.

Për t'i dhënë deklaramit të ekzistencës cilësinë më determinuese, është futur në lojë mohimi gjithëpërfshirës, si një instrument mendor. Kur shihet nga kjo pikëpamje, mund të lind pyetja: **“A duhet të kuptohet Formula e Teuhidit: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut?”** Kjo mënyrë e të shprehurit nuk është e gabuar. Por, nëse vihet re me kujdes, kjo është një shprehje e ndërtuar mbi **“la”**. Ndërsa në fakt, theksi në Formulën e Teuhidit bie mbi **“il-la”**. **“Mosekzistenca e Zotit”** është thënë **“vetëm për të shprehur ekzistencën e Allahut”**. Për këtë arsye, mbase kuptimi i drejtë do të ishte: **“Përveç Allahut nuk ka Zot tjetër”**.

Kjo është edhe arsyeja që gjatë dhikrit përsëritet ose e gjithë Formula e Teuhidit **“La ilahe il-lallah”**, ose vetëm pjesa e dytë **“il-lallah”** dhe, asnjëherë nuk bëhet dhikër ve-

tëm me pjesën e parë **“La ilahe”**.

Kjo gjë nuk e bën të pakuptimtë dhe nuk ia humbet funksionin **“la”**-së. Përkundrazi, në sajë të **“la”**-së, realizohet procesi i pastrimit të mendjes. Të gjitha mundësitë e tjera shumëzohen me zero dhe përgatitet baza për një të vërtetë të madhe.

Sigurisht që në edukimin e **“Teuhidit të vërtetë”**, është paraparë që **“la”**-ja të kryejë pastrimin e vërtetë të mendjes. Prandaj, njeriu duhet të jetë i vetëdijshëm ndaj çdo gjëje që përmban rrezikun për t’u konsideruar si një **“zot”** dhe kur të thotë **“la”**, nga mendja e tij duhet të pastrohen të gjitha fundërrinat.

Kurani i identifikon ato që njerëzit adhurojnë si **“zot”** dhe kërkon të vendosë formulën e teuhidit në vend të tyre. Ndër ato që njerëzit i adhurojnë si **“zot”**, mund të përmendim:

- Shenjtërimi i **“heva”**-së, pra i dëshirave të ulëta të nefsit...

- Shenjtërimi i atyre që cilësohen si **“tagut”**. Pra, çdo përqendrim fuqie e cila pretendohet të jetë e fortë kundër Allahut...

- Shenjtërimi i njerëzve të fesë dhe murgjve, nëse pranohet gjykim i tyre kur e bëjnë hallallin haram dhe haramin hallall...

- Shenjtërimi i gurit, drurit, diellit, hënës etj...

- Shenjtërimi i vetes nga ana e liderëve politikë ose besimi nga ana e të tjerëve se ata zotërojnë fuqi hyjnore...

- Shenjtërimi i pasurisë dhe pronës...

- Dashuria dhe respekti i tepruar për fëmijët apo familjen, deri në atë masë sa të shtynjë dikë që, për hir të dashurisë ndaj tyre, të shkelë urdhrat dhe ndalesat e Allahut Teala...

Islami kërkon t’u thuhet **“la”** të gjitha këtyre dhe mbase çdo gjëje që zotëron damarin e **“shenjtërimit”**. Të jesh i vetëdijshëm për **“damarin e shenjtërimit”**, kërkon një vetëdije teuhidi të veçantë.

“Damari i shenjtërimit”, për të cilin po flasim këtu, duhet të kuptohet drejt. Mund të thuhet se njeriu nuk mund ta bëjë veten zot, t’i përulet e t’i bëjë sexhde ose nuk del përpara murgut dhe e adhuron atë, ose edhe se nuk i bën sexhde pasurisë e pronës... Atëherë çfarë është shenjtërimi?

Shenjtërim do të thotë, t’i përdorësh të gjitha këto për ndërmjetësim dhe të kalosh të gjithë kufijtë që ka vendosur Allahu Teala. Pra, pikërisht kjo është ajo që duhet kuptuar kur themi **“damari i shenjtërimit”**. Dhe të gjitha

këtyre duhet t’u hiqet **“vija e la”**-së.

Nëse themi **“La ilahe”** me gojë, qoftë edhe njëmijë herë në ditë dhe në zemrën dhe jetën tonë vazhdojnë të jetojnë idhujt e ngulur prej nefsit, do të thotë se **“la”**-ja nuk po e kryen funksionin e saj, pra nuk po i spastron ata idhuj.

Mund të themi edhe se, nëse zemra juaj nuk është kapur fort pas vetëdijes **“il-lallah”**, nuk është e mundur që **“La ilahe”** të kthehet në një mekanizëm spastrimi të vetëdijshëm.

Mbase shumë njerëz jetojnë duke thënë gjithmonë **“La ilahe”**, pra duke mohuar të gjitha fuqitë dhe mes këtyre edhe ekzistencën e Allahut. Për shembull, agnosticizmi, i cili ndikon më së shumti tek intelektualët, është një rrymë filozofie e cila shpreh **“mosdijen”**. Në fakt, nuk beson në asnjë gjë e cila adhurohet si zot, por nuk arrin as tek pika e **“besimit të Allahut”**. Pra, ngelet në një vend

duke thënë vetëm, **“nuk e di”**, por të njohësh Krijuesin dhe ekzistencën e Allahut, është e domosdoshme. Mendjen, që nuk mund ta konceptojë ekzistencën e Tij, islami nuk mund ta pranojë si një mendje e cila i ka përcaktuar koordinatat e veta. Një mendimtar, këta të devijuar modernë, i përkufizon si **“intelektualë la”**istë. Pra, bota e mendimit, e cila çdo gjëje i thotë **“la”** dhe nuk arrin të vijë deri tek **“il-la”**...

Kurani Kerim, gjatë ndërtimit të vetëdijes së besimtarit, mekanizmin e **“refuzimit dhe dëshmisë-mohimit dhe deklarimit të ekzistencës”**, e përdor shpesh dhe në kombinime të ndryshme:

- **“Ijjake na’budu ue Ijjake nes-teijn.”** Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. (el-Fatiha, 5.)

Ky është një kombinim i refuzimit dhe dëshmisë ku fjala **“Ijjake”** përmban **“la”** në dhe **“il-la”** në.

“Jo qenieve të tjera që hiqen si hyjni, por vetëm Ty...”

- **“Ue ma halaktu’l-xhinne ue’l-inse il-la li ja’buduun”** **Nuk i kam krijuar xhindët dhe njerëzit (për diçka tjetër), përveçse të më adhurojnë Mua.** (edh-Dharijat, 56)

Në këtë ajet, vendin e **“la”**-së, e ka marrë para fjala mohore **“Ma”**. Por në fund, përsëri ka ardhur **“il-la”**.

Pastrimi nga gjërat negative dhe vendosja e Hakut (Allahut)...

Nëse myslimani e përvetëson në kuptimin e vërtetë të fjalës disiplinën e mendimit të Formulës së Teuhidit, kjo do të bëhet një element ndikues në vendosjen e së vërtetës në të gjitha fushat e jetës. Lum ai që e gdhend në mendje vetëdijen e teuhidit...





Të jetosh me vetëdijen

e Teuhidit

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Teuhidi është një mënyrë jetese përtej të qenit një sistem besimi dhe mendimi. Besimi në njësimin e Allahut Teala, në ahadijet dhe vahdanijet, është baza e parë e teuhidit. Në të njëjtën kohë, teuhidi është një përpjekje për të parë vetëm Njërën (Zotin) e për ta perceptuar Atë si të vetëm në këtë botë. Këtë të vërtetë e shprehin shumë bukur vargjet e poezisë:

*Ti je Ai që jep, Ai që merr dhe Ai që krijon,
Çfarë mund të kemi ne përveç asaj që Ti dhuron?*

Teuhid do të thotë që në ubudijet dhe adhurim t'i drejtohesh Atij, i cili është Një, të largosh nga bota e zemrës, mendjes e mendimit çdo gjë përveç Atij dhe të mendosh vetëm ekzistencën e Tij, duke u zhveshur nga egoizmi.

Në literaturën e mistikës islame, flitet për teuhidin njerëzor dhe atë hyjnor. Teuhidi njerëzor është teuhidi që realizohet me anë të frikës së ndëshkimit. Ndërsa teuhidi hyjnor është ai që bëhet me ndjenjën e madhërimit, sepse natyra njerëzore është e prirur

për të pritur shpërblim për atë që ka bërë dhe për t'i dhënë vlerë asaj. Përderisa njeriu të mos shpëtojë nga këto dobësi në besimin e teuhidit, nuk mund të arrijë teuhidin hyjnor. Në teuhidin hyjnor ka madhërim dhe respekt të përzier me dashuri. Sigurisht se teuhidi i lindur nga dashuria e respekti, nuk është i njëjtë me teuhidin që formohet duke pasur frikë nga ndëshkimi. Të kesh frikë nga ndëshkimi i Allahut të Madhëruar, sigurisht është një sjellje e mirë, por madhërimi i mbështetur në dashuri, është një ndjenjë më sublime.

Për të arritur teuhidin hyjnor, ne duhet ta përmirësojmë moralin e nefsit që me egoizëm pohon "unë, unë" duke ia atribuar vetes ato që ka bërë. Vetëm Allahu i Madhëruar e meriton atë "Unë" në kuptim të plotë të fjalës. Allahu Teala e paralajmëroi të Dashurin e Tij dhe sahabët e nderuar që të mos kaplohen nga dehja e fitores së Luftës së Bedrit dhe u tha: **"Sigurisht, nuk یشان ju që i vratë ata, por i vrau Allahu! Kur gjuaje, nuk ishe ti (Muhamed), por**

ishte Allahu Ai që gjuante, me qëllim që t'u bënte besimtarëve një dhuratë të bukur. Vërtet, Allahu dëgjon dhe di çdo gjë.”¹

Historikisht e dimë se ushtria islame prej më shumë se treqind ushtarësh, e shkatërroi ushtrinë e politeistëve, që kishte më shumë se nëntëqind ushtarë. Në të njëjtën kohë ajo pati vlarë edhe prijësit e mushrikëve. Në momentet më të ashpra të luftës, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, u lut duke ngritur duart nga qielli dhe një grusht rërë që e mori nga toka, ua hodhi armiqve drejt e në fytyrë. Në fund, politeistët u shkatërruan dhe myslimanët fituan, por Allahu Teala, si një domosdoshmëri e besimit të teuhidit, i paralajmëroi ata me këtë ajet fisnik, me qëllim që të mos harrohej se Ai (xh. sh.), ishte vepruesi absolut.

Teuhid, përveç synimit të Allahut Teala në ibadet e në adhurim dhe drejtimit nga Ai, do të thotë edhe që të shikosh vetëm Atë si veprues absolut. Kjo e vërtetë vihet re qartë në ajetin fisnik.

Të shohësh “Një”, arrihet vetëm në sajë të ndihmës hyjnore. Nëse Allahu i Madhëruar ia tregon robit të Tij, atëherë ai mund ta shikojë atë të vërtetë, nëse jo, është i paaftë të bëjë një gjë të tillë. Për të parë Një, duhet të shpëtojme nga hutimi. Tregimi i çirakut të hutuar e shpjegon shkëlqyeshëm këtë. Sipas një transmetimi, një mjeshtër e urdhëron çirakun e tij të hutuar, që i shikonin sytë dysh (që vuante nga diplopia, në kuptimin metaforik të fjalës), që t'i sillte shishen nga rafti. Çiraku vrapon të marrë shishen, por në raft shikon dy shishe. Ai i tha mjeshtrit: “Mjeshtër! Në raft ka dy shishe. Cilën të të sjell?” Edhe pse mjeshtri i thoshte se në raft kishte një shishe, çiraku insistonte në mendimin se ishin dy. Atëherë mjeshtri i tha: “Thyeje njëren dhe sill tjetrën!” Por kur u thye njëra shishe, u zhduk edhe tjetra. Kur u thye shishja, çiraku e kuptoi të vërtetën. Edhe teuhidi kështu është. Ata që e shikojnë botën

të hutuar, gjithmonë shohin dy apo më shumë. Por ata që e thyejnë shishen e dytë, e kuptojnë teuhidin e vërtetë.

Në teuhid fshihen dy kuptime. Ai i mushahedes (dëshmimit, shikimit), dhe ai i murakabes (vëzhgimit). Në përkufizimin e ihsanit (mirësia e adhurimit të Allahut sikur e shikon Atë, sepse, edhe nëse nuk e shikon, Ai të shikon ty) në hadithin që njihet si hadithi i Xhebrailit, mund të shikohen të dy dimensionet e teuhidit.² Kuptimi i mushahedes (dëshmimit, shikimit) shprehet në fjalinë: “*Të adhurosh Allahun sikur e shikon Atë*” dhe kuptimi i murakabes (vëzhgimit) shprehet në fjalinë: “*Edhe nëse nuk e shikon Atë, Ai të shikon ty.*”

Teuhidi në kuptimin e mushahedes (dëshmimit, shikimit) është perceptimi i besimtarit në lidhje me veten dhe çdo gjë tjetër duke e lidhur me Allahun e Lartmadhëruar, pa i atribuar asnjë gjë vetes dhe aftësive të tij. Kur shikon gjërat, dëshmon fuqinë që i administron ato dhe e kupton se ato ekzistojnë prej Tij. Në këtë mënyrë, ia lë Atij vullnetin dhe administrimin e tyre. Kështu, e vërteta e teuhidit e pushton të gjithë robin. Si rezultat, rob i shikon se çdo gjë ekziston prej Allahut Teala. Ngado që të hedhë sytë, dëshmon argumentet që tregojnë ekzistencën dhe njësimin e Tij.

Në një teuhid të tillë, nefsi i robit ka dalë jashtë funksionit. Tashmë, rob i ka filluar të shikojë vetëm Atë si vepruesi absolut dhe nuk ka nevojë të kërkojë ndonjë shenjë apo të gjejë ndonjë argument për teuhidin.

Ndërsa, në konceptin e murakabes (vëzhgimit) që tregon gjendjen e atyre të cilët nuk e kanë arritur mushaheden (dëshmimin), bëhet fjalë që rob i tërë me ndojë se kontrollohet e vëzhgohet vazhdimisht nga Allahu Teala dhe ta nxjerrë “egon” jashtë funksionit, duke e reflektuar këtë mendim te sjelljet e tij. Një teuhid i saktë, është një teuhid i pastruar nga egoja

*Ai që ka arritur
vetëdijen e teuhidit, ka për qëllim
dhe synim vetëm Allahun Teala.
Dashuria dhe përzgjedhjet e atij
që ka arritur vetëdijen e teuhidit,
nuk janë më personale dhe vetjake,
por i përkasin vetëm Zotit,
sepse ai që do Zotin,
nuk mbart ndonjë përzgjedhje
që i përket vetes së tij.*

1. Sureja el-Enfal, 8/17.

2. Buhari, Iman, 37.

e nefsit. Ebu Bekir Shibli, i cili ishte prej mistikëve të parë, pyeti një burrë: “A e di pse nuk e ke të saktë teuhidin?” Burri u përgjigj: “Jo!” Atëherë Shibli i tha: “Sepse ti e kërkon Atë (Allahun), pa e hedhur egon, por kjo është e pamundur.”

Në namazet që falim çdo ditë, e themi ajetin e sures el-Fatiha: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”**, së paku dyzet herë. Me këtë shprehje, pohojmë se ibadeti dhe adhurimi ynë realizohen vetëm me ndihmën e Allahut Teala. Sepse, si mund të bëjmë ibadet, nëse Ai nuk i jep botës sonë shpirtërore kënaqësinë e ibadetit dhe dëshirën e adhurimit? Fakti që Ai i ka dhuruar zemrës një mirësi të tillë, është sikur po na thërret: “Urdhëro, eja o robi Im!” Ne i drejtohem Atij me atë thirrje. Drejtimin tonë nga Ai nuk duhet ta pranojmë si një aftësi tonën, por si një mirësi nga Ai. Si mund t’i kalojmë dëshirat vetjake dhe të vrapojmë drejt Tij, nëse Ai nuk e jep këtë ndjenjë?

Ibadetet janë një sistem sjelljesh, që Kurani dhe Suneti i kanë bërë shkak për adhurim. Specifikat shpirtërore, që janë domosdoshmëri e këtyre sjelljeve, e shtojnë cilësinë e tyre. Në këtë mënyrë, një namaz i falur pa neglizhencë, një agjërim i mbajtur pa përgojim, një zekat dhe sadaka e dhënë pa ndjerë nevojë për falënderim, një haxh dhe një xhihad pa shtrije, një dhikër i bërë me gjithë dëshirë dhe një bindje larg fatkeqësive vetjake, konsiderohen ibadet i vërtetë. Edhe një kënaqësi pa armiqësi, një durim pa ankesë, një dije e vërtetë që nuk përmban dyshim, një mushahede e vazhdueshme, një drejtim që nuk ka kthim dhe një takim i pandarë, janë veprime shpirtërore si rezultat i teuhidit.

Ai që nuk synon asgjë tjetër në adhurimin e tij përveç Allahut Teala dhe i drejtohet vetëm Atij me zemër, shpirt dhe trup, arrin gradat më të larta shpirtërore. Ai që e kryen adhurimin dhe ibadetin e tij me shumë ndjenjë, e cila quhet qetësi shpirtërore dhe ia atribuon Allahut veprën e bërë e jo vetes, arrin sinqeritetin në veprat dhe sjelljet e tij. Në këtë mënyrë,

fillon të shfaqet e vërteta që shprehet në hadithin kudsij: **“Robi shikon me Mua.”** Ai tashmë është një rob i sinqertë. Nuk është i lidhur apo i dhënë pas ndonjë gjëje apo shumë gjërash të kësaj bote. Ai është i preokupuar vetëm me dëshmimin e Allahut të Madhëruar.

Ai i hap dritaret e shikimit me ajetin kuranor: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”** dhe arrin një gjendje sikur po flet me Zotin. Sepse në tre ajetet e para të sures el-Fatiha, lidhja e robit me Allahun është në vetën e tretë njëjës, ndërsa në këtë ajet e tutje, lidhja kthehet në vetën e dytë njëjës. Në këtë mënyrë, robi ia paraqet Allahut kërkesat dhe lutjet sikur e shikon Atë përballë tij. Përgjatë kësaj lutjeje, nuk ka asnjë pengesë ndërmjet Allahut dhe robit

përveç pengesës së nefsit. Robit, që shpëton nga nefsi, i largohen pengesat dhe fillon të shikojë Zotin. Sipas një transmetimi, Bajezid Bistami pyet: “O Zot! Si është rruga, e cila të shpie tek Ti?” Zoti i dërgoi frymëzim zemrës së tij duke i thënë: “Lëre nefsin dhe eja pa të!”³

Pasi robi e falënderon dhe e lavdëron Zotin, duke e përkujtuar me cilësitë e uluhijetit, rububijetit dhe të mëshirës që shprehen në suren el-Fatiha, shpëton nga robëria e nefsit në sajë të ndikimit të këtyre cilësive. Pastaj robi fillon të thotë: **“Vetëm ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”**

Në këtë shprehje ka një perceptim teuhidi në shkallë të lartë. Nëse dikush që e lut Allahun Teala me këto shprehje, troket akoma në dyert e njerëzve, e kalon kohën në adhurim ndaj robit dhe kërkon medet e ndihmë nga njerëzit e sendet e tjera, atëherë kjo gjendje ia shkatërron teuhidin. Miku i Allahut, Sufjan eth-Theuri u bë imam për një xhemat në namazin e akshamit. Kur po lexonte Fatihanë dhe arriti në këtë ajet, i ra të fikët. Atyre që e pyetën për shkakun e asaj gjendjeje, u tha: **“Kur thashë vetëm Ty të**



3. Shik. Ruhu'l-Bejan, I, 39-43.

adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë, pata frikë se do më thonë: “Atëherë, përse troket te dera e sulltanëve, e doktorëve dhe e njerëzve? A nuk je i singertë në këtë fjalë?”⁴

Në kuptimin e ajetit: ***“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”***, gjendet koncepti i teuhidit të Ibrahimit, alejhisselam. Kur Nemrudi e hodhi në zjarr Hazreti Ibrahimin, Xhebraili (a.s.), erdhi dhe e pyeti: “A ke ndonjë nevojë?” Ibrahim (a.s.), iu përgjigj: “Prej teje? Kurrë!” Xhebraili (a.s.), i tha: “Atëherë kërko nga Allahu atë që doje të kërkoje!” Ibrahim (a.s.), këtë herë i tha: “Ai e shikon dhe e di gjendjen time. ***Unë i jam dorëzuar Zotit të botëve.***”⁵

Në ato momente, Hz. Ibrahim i kishte duart e këmbët të lidhura me zinxhirë dhe po zvarritej drejt një fundi që pandehnin jobesimtarët. Por shikimi që i jepte teuhidi, nuk i la vend ndonjë devijimi në zemrën e tij.

Tani le të mendojmë. Në ato momente, Ibrahimit, alejhisselam, i ishin lidhur vetëm duart dhe këmbët. Ne nuk kemi mundësi të lëvizim kur i kemi duart e lidhura, nuk mund të ecim kur i kemi këmbët e lidhura, nuk mund të shikojmë kur i kemi sytë të mbyllur, nuk mund të dëgjojmë kur i kemi veshët të zënë dhe nuk mund të flasim kur e kemi gjuhën të lidhur. Me këtë gjendje, jemi në krye të zjarrit të xhehenemit. Ne jemi të detyruar të kërkojmë ndihmë nga Allahu Teala, që të na shpëtojë nga zjarri i xhehenemit, ashtu siç nuk pranoi Hazreti Ibrahim, alejhisselam, ndihmën e askujt, përveç ndihmës së Allahut të Madhëruar kundrejt zjarrit të Nemrudit.

Ai që ka arritur vetëdijen e teuhidit, ka për qëllim dhe synim vetëm Allahun Teala. Dashuria dhe përzgjedhjet e atij që ka arritur vetëdijen e teuhidit, nuk janë më personale dhe vetjake, por i përkasin vetëm Zotit, sepse ai që do Zotin, nuk mbart ndonjë

përzgjedhje që i përket vetes së tij.

Mevlana e shpjegon kështu këtë çështje:

“Një i dashuruar pyeti personin që dashuronte: ‘A më do më shumë mua apo veten tënde?’. Përgjigjja qe: ‘Unë kam vdekur prej vetes sime dhe jam i gjallë me ty. Kam kaluar nga vetja, ekzistenca dhe nga cilësitë e mia. E kam harruar vetëdijen e vetes. Unë di me dijen tënde. Unë e kam hequr nga mendja fuqinë dhe forcën time. Kam fituar fuqi me fuqinë tënde. Nëse dua veten, do të thotë se të dua ty. Nëse të dua ty, konsideroj se kam dashur veten.”

Ndërsa një tjetër, për ta provuar të dashurin e vet, e pyeti atë në një kohë mëngjesi: “O filani, i biri i filanit! O i dashuruar, që ke rënë në halle! A më do mua më shumë apo veten tënde?

Më thuaj të drejtën!” I dashuri ia ktheu kështu përgjigjen: “Unë jam shkrirë aq shumë te ti, sa që jam i mbushur me ty nga koka te këmbët. Në ekzistencën time nuk ka ngelur gjë përveç emrit. Edhe në trupin tim nuk ka gjë tjetër përveç teje. Unë jam tretur si uthull, në detin e mjalhtë të ekzistencës tënde.”⁶

Kjo e vërtetë shprehet në një formë shumë të qartë në bejten e para të Mesnevisë së Mevlanës:

Çdo gjë është i Dashuri, ndërsa i dashuruari është perde,

I gjallë është vetëm i Dashuri, ndërsa i dashuruari vdekje.

Nga këto shprehje, kuptohet qartë se vullneti i atij që ka arritur teuhidin e vërtetë, duhet t’i nënshtrohet vullnetit të Zotit. Zgjidhja, pranimi dhe refuzimi i tij duhet të jetë pranimi dhe refuzimi i Zotit e jo i nefsit, i epshit apo i diçkaje tjetër. Kjo është një ngjarje që mund të ndodhë me hyrjen e teuhidit në zemër. Kjo është një ndodhi që mund të realizohet, nëse njeriu e shikon Atë në çdo fushë të jetës aq sa e shikon në ibadete, nëse e ndjen Atë dhe nëse e kupton se jeton me Të.

4. Shik. RuHu'l-Bejan, I, 43.

5. Sureja el-Bakara, 2/131.

6. Mesnevi, V, 2020.



Kontributi i Hafiz Ali Korçës për arsimin dhe shkollën shqipe

Bedri Telegrafi

Hafiz Ali Korça i përket asaj breznie shqiptare lindur e brumosur në vllugun e epokës madhore të Rilindjes shqiptare. Si shumë rilindas të shquar e kuptoi se kambana që do t'i zgjonte shqiptarët nga gjumi do të ishte drita e diturisë që do të përhapej në truallin shqiptar nëpërmjet gjuhës amtare. I gjithë rrugëtimi jetësor i këtij atdhetari, ideologu rilindas do të ecte paralel me idealet e kolosëve rilindas. I ndikuar dhe frymëzuar prej ideve të tyre dhe i motivuar prej dëshirave të çdo shqiptari për një atdhe më të përparuar, iu përkushtua çështjes së mësimin dhe shkollës shqipe si premisë e fuqishme për zgjimin kombëtar.

Biografët e tij shkruajnë: "Si nacionalist shqiptar Ali Korça zhvilloi një veprimtari të gjerë. U dënua me vdekje. Dha kontribut të madh për mbajtjen në këmbë të Mësonjëtores së parë shqipe, ku qe edhe mësues i saj".¹

"Që në moshën 20- vjeçare, në vitin 1893, kur udhëtonte me tren prej Sofies për në Stamboll i ngarkuar me libra shqip, të cilat atëherë ishin të ndaluara për t'u kënduar, u kap dhe u internua në Sinop për të vetmin faj se propagandonte në favor të Atdheut të tij. Rreth vitit 1900, kur aty u gjet një fotografi politike, u mbyll shkolla shqipe në Korçë dhe së bashku me patriotët Korçarë, Orhan Beu, Hysen Qani Dibra, Emin Xurka, Sulejman Ohreja, Thimi Mihal Markoja u kapën dhe u internuan për në Anadoll nëpër vise të ndryshme të atjeshme".² Në Kongresin III të myslimanëve shqiptarë, Vehbi Dibra në diskutimin e tij theksoi: "Kur u shpall 'Liria turke', më 325, u mbledh një kongres në Dibrën fatzezë. Kryesia e këtij kongresi iu ngarkua Vehbi Dibrës. U bënë luftëra të rrepta në këtë kongres, sidomos për çështje të shkronjave shqipe... Kryetari i Kongresit me gjithë shqiptarët e vërtetë, si me kolegun tonë Hafiz Ali Korça e shumë të tjerë luftuan

sa mundën dhe në fund fituan, kongresi pranoi. Kështu mori fund Kongresi me pranim të shkronjave..."³

Këto ngjarje ishin preludi i një jete plot me rreziqe, por të lavdishme: sinoptika paralajmëronte se anija e ngarkuar me shkronja shqipe do të lundronte në një det të trazuar. Këto shkronja thotë Avdyl Ypi, Naim Frashëri i mbolli, kurse Hafiz Ali Korça me shokë i vaditi.

Kongresi i Dibrës ishte fushë beteje për çështjen e gjuhës dhe shkollës shqipe.

Ky kongres, i mbajtur më 23-28 korrik 1909, përbën një pikë kulmore, ku shpalosen cilësitë më të larta të një patrioti shqiptar dhe personalitetit të shquar të Rilindjes Kombëtare Hafiz Ali Korça. Kongresi me rreth 315 delegatë nga pesë vilajetet e rajonit ballkanik: 16 sllavomaqedonas, 15 grekë dhe pjesa e mbetur shqiptarë u thirr me nismën e komitetit qendror "Bashkim e përparim". Me këtë akt, xhonturqit kërkonin konfirmimin se shqiptarët i qëndronin ende besnikë perandorisë osmane, të forconin lidhjet me parinë shqiptare për ta përdorur si topuz kundër lidhjes kombëtare shqiptare. Organizatorët bënë të gjitha përpjekjet, duke shpërndarë ftesat vetëm 5 ditë para kongresit e duke mos i përcjellë lajmërimet tek klubet përparimtare shqiptare, synonin të përbënin shumicën e tij. Nën këtë aspekt, Kongresi i Dibrës ishte fushëbetejë e krerëve të patriotëve shqiptarë: Hafiz Ali Korça, Feim Zavalani, Sotir Peci, Aqif Pasha, Avdyl dhe Ferid Ypi, Loni Lagori, Benjamin Nosi etj., të cilët vepronin në kushte terrori, si e ka përshkruar edhe Hafiz Ali Korça: "Aso kohe askush nuk guxonte ta merrte në gojë çështjen e gjuhës shqipe, se do të quhej tradhëtor i rreptë e jo të ngulte këmbë për mësimin e saj zyrtarisht. Pale ta çelte këtë çështje në këtë kongres, që qëllimi i këtij kongresi ka

1. Prof.dr. Shefik Osmani, Panteoni Iranian dhe iranologët shqiptarë. Botim 1998 fq. 237.

2. Hafiz Ali Korça, vepra 2, fq. 37, Shtëpia botuese "Logos" Maqedoni, viti 2006.

3. Ali M. Basha- Rrugëtim i fesë islame në Shqipëri (1912-1967), Botim 2011, fq. 207.

qenë krejt ndryshe”⁴ Me artikullin e tij “Me qa e me qesh”, autori H. Ali Korça bën aluzion për prishjen e gjuhës shqipe, si rezultat i përdorimit vend e pa vend të fjalëve të huaja. Ndër të tjera, ai shkruan se në një letër prej 40 radhësh që kishte marrë, vetëm një fjalë kish gjetur shqip, ndërsa të tjerat ishin frëngjisht, latinisht, anglisht, gjermanisht, greqisht dhe sllavisht, disa turqisht, dy arabisht dhe një fjalë persisht. Në fund të artikullit, autori pyet: “Po Samiu e Naimi, a nuk dinin fjalë të huaja?”

Hafiz Ali Korça pati guximin të mbante fjalën kryesore dhe të deklaronte para delegatëve: “...*fqinjët tona nga ana arsimit kanë arrirë shkallën më të lartë, na për fat të keq kemi mbetur si populli i Afrikës së mesme. Me gjithë atë, në Shqipëri kurse të gjithë gjuhët mësohen, gjuha jonë perse të mos mësohet?*”⁵

Falë këmbënguljes së tij dhe mbështetjes së patriotëve shqiptarë, kongresi u kthye në kurorë suksesi në lëvizjen kombëtare shqiptare dhe për herë të parë në historinë e perandorisë osmane, merren vendime të rëndësishme në favor të kombit shqiptar dhe midis tyre për riorganizimin e arsimit, modernizimin dhe shkollëzimin e shkollave, hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Në kongres u shtrua edhe çështja e reformave që duhej të pësonin medresetë në drejtim të përmirësimit të planprogrameve, me synim përfshirjen e studimit në to të lëndëve ekzakte: kimi, fizikë, trigonometri, algjebër, astronomi. Sepse sipas tij, studimi i lëndëve fetare duhet të ndërthuret me studimin e lëndëve shkencore, sepse Zoti i besimit është edhe Zoti i shkencës. Ai shtroi gjithashtu edhe çështjen e përmirësimit të metodave dhe didaktikës së mësimi të gjuhëve të huaja, veçanërisht të gjuhës arabe. Për shkak të shkallës së lartë të vështirësisë së saj, një nxënësi i duhejshin 8-10 vjet për ta përvetësuar këtë gjuhë. Pak vite më vonë, vetë ai përgatiti një abetare dhe metodë që u mundësonte nxënësve mësimin e kësaj gjuhe brenda një afati kohor 2- vjeçar.

Më tej, në fjalën e tij, Hafiz Ali Korça shtroi problemin e ndërtimit të rrjetit të shkollave të mesme, ku fëmijët shqiptarë të mësonin mjeshtëritë (shkolla profesionale, B.T), si dhe një shkollë pedagogjike për të plotësuar nevojat për mësues të gjuhës shqipe në shkollat shqipe që parashikoheshin të hapeshin.

Në vazhdim edhe të detyrave që kishte shkruar kongresi i Manastirit për çështjen e alfabetit shqip, edhe në kongresin e Dibrës u shtrua dhe u diskutua rreth këtij problemi. Pa nënçmuar vlerat e alfabetit arab, si gjuha e Kuranit dhe një tërësi shkencash të ardhura nga bota islame, Hafiz Ali Korça e

konsideronte më të lehtë e më të përdorshëm për shkrimin e gjuhës shqipe alfabetin latin. Pikërisht për këtë, nisi një kalvar përndjekjesh ndaj tij dhe iu vu epiteti “llatinxhi”.

Triumfi i kërkesave të patriotëve shqiptarë, në Kongresin e Dibrës, për problemet e arsimit dhe shkollës shqipe shkonin në favor të zgjidhjes së platformës me të cilën kishte ecur Rilindja Kombëtare Shqiptare. Punimet e këtij kongresi demonstrian se zgjimi kombëtar, si devizë e Rilindjes, tashmë kishte ndodhur, idealet për të cialt ishin sflitur dhe përpjekur rilindasit e shquar nuk kishin shkuar dëm. Bashkimi Kombëtar shqiptar ishte realizuar dhe tashmë, shqiptarët përbënin forcë dhe ishin kthyer në faktor të zgjidhjes së problemeve në Ballkan dhe zot të fateve të tyre. Tashmë në Shqipëri, balanca historike anonte në favor të forcave përparimtare. Problemet e arsimit dhe shkollës shqipe ishin kthyer në një çështje mbarëkombëtare dhe çdo përpjekje për të ndaluar këtë proces rezultonte e dështuar. Mbas kongresit të Dibrës, arsimit dhe shkolla shqipe njohu zhvillime e vullte të reja, që patën jehonën e tyre në Kongresin e Elbasanit, mbajtur më 2 shtator 1909. Ky kongres mori vendimin për hapjen e normalës së Elbasanit, për çeljen e shumë shkollave të ulëta e të mesme në tërë vendin, sipas propozimeve të Hafiz Ali Korçës në Kongresin e Dibrës. Kongresi i Elbasanit vendosi gjithashtu edhe krijimin e shoqërisë, emëruar “Shoqëria e mësonjëtoveve shqiptare “Përparimi” me seli në Korçë, e cila mori përsipër detyrën e ngritjes në trojet shqiptare të një sistemi të ri arsimor, duke organizuar më mirë punën mësimore dhe duke bërë përmirësime në metodat e mësimi dhe edukatës.

Në udhëheqje të kësaj shoqërie qëndronin forca të shquara të lëvizjes kombëtare, si: Orhan Pojani, Stavre Karoli, Mihal Grameno, Sami Pojani, Idhomeno Kosturi dhe Hafiz Ali Korça, të cilit iu ngarkua detyra e këshilltarit të kësaj shoqërie. Edhe në këtë funksion, ai mbrojti me vendosmëri alfabetin e vendosur në Kongresin e Manastirit. Shoqëria “Përparimi” i dha hov të ri zgjerimit të rrjetit arsimor shqip, në Korçë e në disa fshatra të saj, si dhe në hapjen e Liceut të Korçës me profesor të parë Hafiz Ali Korçën, ku: “*Njihet dhe nga profesorët më me famë se njëzet vjet në gjimnazin e Korçës ka mësuar matematikë, gjeografi, literaturë*”⁶

LUFTA PËR ALFABETIN SHQIP

Duke filluar që nga viti 1879, me krijimin e “Shoqërisë së Stambollit ose të të shtypurit shkronja shqip”, ish hedhur ideja e dy alfabeve, e shkrimit të shqipes me alfabet arab ose alfabet latin. Hafiz Ali Korça ishte përkrahës i përdorimit të alfabetit latin, si më i lehti dhe në përputhje me fonezën

4. Hafiz Ali Korça, vepra 2, fq. 49, Shtëpia botuese “Logos” Maqedoni, viti 2006.

5. Hafiz Ali Korça, vepra dhe jeta f. 25, Dr. Ismail Ahmeti, Shtëpia botuese “Logos” Maqedoni, viti 1999.

6. Rauf Fico, Rubairët e Omar Kahjemit f.3, Botim 2009.

shqipe dhe që buron nga vetë natyra dhe veçoritë e gjuhës shqipe si gjuhë e familjes indoeuropiane. Herë – herë diskutimi mori tone të ashpra. Përkrahësit e alfabetit arab mallkonin shkronjat latine, ndërsa përkrahësit e alfabetit latin organizonin protesta dhe digjinin në mënyrë demonstrative abetaret dhe librat me shkronja arabe. Një ndër këto mitingje u zhvillua më 18 shkurt 1910, për të cilin Hafiz Ali Korça shkruan: *“Më 18 shkurt 1910, ditën e hënë paradeke, më tepër se 12 mijë burra, 150 prej të cilëve ishin kalorës e të tjerë në këmbë, erdhën bashkë më bandën shqiptare te porta e shtëpisë sime... Si dola jashtë, më rrëmbyen në krahë dhe si më mbajtën mjaft kohë, më vendosën përmbi kalë duke bërë titur: ‘rroftë shqipja, rroftë babai i Shqipërisë’”*⁷

Mbas fjalimit të zjarrtë të Sami Pojanit, në këtë mitingje mori fjalën edhe Hafiz Ali Korça, i cili theksoi... kjo nuk do të thotë se ne urrejmë shkronjat arabe, me të cilat mësojmë Kuranin. Por meqë statuti shtetëror për të kënduar gjuhën e mëmës po na lë të lirë, atëherë me gëzim të madh do të këndojmë gjuhën tonë me këto shkronjat e saj, se asnjë fuqi nuk mund ta ndajë”⁸.

Ky rilindas i shquar e vështroi luftën për alfabetin në dritën e bashkimit kombëtar dhe të përhapjes së kulturës në masat popullore, si pjesë e programit për zgjimin kombëtar. Sipas tij, detyrë e parë është të shkruhet dhe të lëvrohet gjuha amtare dhe të përhapet arsimit shqip.

Përsa i përket alfabetit të përbashkët me shkronja latine, për të cilin u bënë shumë përpjekje për t’u vendosur, ai do të shkruante: *“Shkronjat s’janë as mumin (besimtare) as qafir (jobesimtare)”*. Dhe në këtë moto shkroi një distik:

*Vegla për të shkruar janë,
shkronjat ngjyrë feje s’ kanë
Gjuha me çdo shkronjë shkruhet
Kjo hallall kjo haram s’ thuhet
Kot e bëni vegël fenë
Na trubulloni atdhenë.”*⁹

Ai theksonte se qëllimi i vetëm i këtij alfabeti është: *“...që ky komb, që është mbytur në moçalet e padisë, të dalë nga kjo gjendje dhe të zgjojë këtë komb që të mundonjë të dalë në dritë e të bëhet një element i dobishëm.”*¹⁰

Mbas shpalljes së pavarësisë, Hafiz Ali Korçën e shohim të aktivizuar në organizimin e sistemit arsimor në shtimin e shkollave shqipe. Në vitin 1916 ai emërohet drejtor i arsimit për rajonin: Tiranë, Durrës, Elbasan, Mat, Pogradec. Kontributi i tij në këtë funksion shprehet në përmirësimin e ndjeshëm të programeve mësimore, në ngritjen e nivelit të mësimdhënies e posaçërisht në forcimin e rolit edukativ të shkollave, në kultivimin tek nxënësit të dashurisë për gjuhën shqipe dhe duke nënvizuar rolin e pajisjes së nxënësve me edukatën fetare. Edhe në detyrën e kryemyftiut dhe anëtarit në Këshillit të Naltë të Sheriatit në qytetin e Shkodrës, ai krijoi strategji pune në fushën e arsimit dhe të edukimit fetar të fëmijëve dhe rinisë shqiptare. Sipas tij, pa i kushtuar

kujdes këtij procesi, Shqipëria humbet perspektivën e saj. Ky parim dhe bindje e karakterizoi atë gjatë gjithë jetës së tij dhe u la si amanet pasardhësve:

*“Çdo shqiptar dhe shqiptarkë ka detyrë e shtërngesë të mësojë... Zoti të paditurin e quan të verbër, të shurdhër, mbase edhe të vdekur.”*¹¹

Duke folur për aktivitetin në këtë drejtori, ai do të thekson-te: *“... derisa isha në funksionin e drejtorit të arsimit, m’u dhanë edhe dy anëtarë, Z. Aleksandër Xhuvani, dhe Sali Ceka, kurse si inspektorë kam patur Dervish Himën dhe Petër Pognin.”*¹²

Po në qytetin e Shkodrës, Hafiz Aliu u emërua anëtar i komisionit letrar, ku së bashku me Gjergj Fishtën, Luigj Gurakuqin, Mati Logorecin dhe Sali Nevicën dhanë kontribute të ndjeshme në mbrojtjen e gjuhës shqipe nga fjalët e huaja, sipas porosive të Naim Frashërit se përdorimi i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe, kur ne i kemi fjalët tona, është njëllloj sikur me duart e tua të vrasësh nënën tënde.”

Përgjatë viteve 1918-1924, Hafiz Aliun e gjejmë në krye të Këshillit të Naltë të Sheriatit në Tiranë. Me iniciativën e tij, së bashku me Vehbi Dibrën, Sali Vuçiternin, Ferid Vokopolën dhe Qamil Balën u hap “Medreseja e Përgjithshme” në Tiranë. Ai drejtoi të gjithë punën për hartimin e plan programeve mësimore në të gjitha medresetë e vendit, sipas kërkesave bashkëkohore, përcaktoi detyrat dhe kriteret që maturantët e shkollave të mesme të vendit tonë të mund të regjistroheshin dhe vazhdonin studimet në universitetet botërore. Përgjatë viteve 1924-1949, Hafiz Ali Korça punoi si mësues i profilit lëndë fetare si dhe gjuhë arabisht e persisht në “Medresenë e Përgjithshme” në Tiranë. Midis nxënësve të tij, Rauf Fico thekson: *“Unë, prej Hafiz Aliut kam marrë mësim të persisht. Nuk besoj të ndodhet ndonjë njeri në Shqipëri që ta zotërojë persishten kaq mirë sa ky. Për ta mësuar persishten brenda tre muajve ka shkruar edhe një libër persisht-shqip... Mjafton të kujtojmë librin shqip-arabisht, të cilin e ka shkruar në mënyrë të tillë, që kushdo me atë metodë të mësojë gjuhën arabe brenda dy viteve.”*¹³

Ndërsa publicisti dhe ish- medresisti Sadik Bega, kujton: *“Sa për ne, që kemi qenë studentë të tij, na përket të pohojmë me sinqeritet se me metodën e librit shqip-arabisht, që Hafiz Aliu pati shkruar, megjithëse fillon prej alfabetit arab, mësuam gramatikën, sintaksën, retorikën dhe logjikën brenda tre vjetësh.”*¹⁴ Në medresenë e Tiranës, duke qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me procesin mësimor dhe në pozicionin e mësimdhënësit, u angazhua për të vënë në jetë detyrën për modernizimin e medreseve, për të cilën ai kishte këmbëngulur në Kongresin e Dibrës. Modernizimin e medreseve në Shqipëri e ndeshim në planin mësimor të këtyre shkollave, në futjen e lëndëve të reja shkencore: logjikë, filozofi, astronomi, anglisht, krahas lëndëve të mëparshme laike, e vërejmë në përmirësimin e ndjeshëm cilësor të lëndëve fetare nëpërmjet zëvendësimit rrënjësor të teksteve të vjetra me tekste të reja. Në planprogramet e shkollave fitoi prioritet lënda e gjuhës shqipe dhe historisë së popullit

7. Hafiz Ali Korça, vepra 1, fq. 50, Shtëpia botuese “Logos” Maqedoni, viti 2006

8. Po aty, fq. 51.

9. Hafiz Ali Korça, vepra 1, fq. 50, Shtëpia botuese “Logos” Maqedoni, viti 2006.

10. Hafiz Ali Korça, Vepra dhe jeta f. 37, Dr. Ismail Ahmeti, Shtëpia botuese “Logos” Maqedoni, viti 1999.

11. Po aty, fq. 41.

12. Po aty, fq. 41.

13. Rauf Fico, Rubairët e Omar Kahjemit fq. 3, Botim 2009.

14. Revista Kultura Islame Nr. 3-4, Nentuer-Dhetuer 1941, fq. 272-275.

shqiptar. Në këto vite, prej këtyre shkollave dolën studiues, intelektualë të shquar deri në nivele shkencore në fusha të caktuara, si Shaban Demiraj, Vexhi Buharaja, Sherif Putra, Sadik Bega. Përvoja e frytshme pedagogjike e didaktike e Hafiz Aliut atyre viteve, shërbeu si model i platformave për përmirësimin e ndjeshëm të metodave të edukimit dhe mësimin. Në drejtim të ndërtimit të marrëdhënieve mësues-nxënës, mbi bazën e mirëkuptimit dhe partneritetit reciprok, në trajtimin e nxënësit si personalitet dhe subjekt, në shmangien e frymës autoritariste të zyrtarizimit, sipas devizës se nxënësi është shoku, miku i mësuesit, pa ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e tij aktive nuk mund të konsiderohet suksesi në punën e shkollës dhe të mësuesit. Si teolog, ai porosiste se për nxënësin marrja e diturive është përgjegjësi para Zotit, si edukator dhe mësues porosiste se marrja e diturive është përgjegjësi para shoqërisë, familjes dhe shkollës. Detyra e mësuesit qëndron në aftësimin e nxënësit për të fituar dituri, qoftë nën drejtimin e tij, por edhe në mënyrë autodidakte.

Medresea e Përgjithshme e Tiranës formoi brenda pak vitesh fizionominë e vet si institucion serioz, ku merrej një formim i shëndoshë fetar dhe kombëtar. Kjo u arrit në sajë të trupit mësimor të gruplëndëve të kulturës së përgjithshme, i cili u gërshetua me gruplëndët që karakterizonin shkollat e mesme shtetërore, laike klasike, siç ishin gjuha dhe letërsia, që merreshin gjatë gjithë periudhës së studimit dhe kishin përparësi ndaj lëndëve të tjera laike.

Që në fillesat e shkollës shqipe, Hafiz Aliu kuptoi domosdoshmërinë e përgatitjes së teksteve të reja në gjuhën shqipe dhe, veçanërisht për shkollat fetare, të cilat ishin shkruar në gjuhën turke. Motoja e tij ishte se besimin dhe dijet fëmijët duhet t'i nisin në gjuhën e mëmës.

Ky parim e udhëhoqi atë që në përgatitjen e abetares në vitin 1910, në të cilën mëton t'u mësojë nxënësve alfabetin e gjuhës shqipe dhe, pas zotërimit të të gjitha gërmave edhe shkrim-leximin e gjuhës së mëmës. Edhe pse e hartuar, kjo abetare, me alfabetin e Stambollit, në variantin e provuar nga Kongresi i Manastirit, me disa ndryshime të vogla, jep informacione edhe për variantin e alfabetit latin, përmes ushtrimeve për shkrimin e fjalëve dhe leximin e teksteve me këtë variant. Për shkak të rrethanave dhe kushteve historike të kohës kur u shkrua, por edhe për shkak të alfabetit të përdorur, kjo abetare është ndihmesë e çmueshme e autorit për alfabetin e njësuar dhe për historinë e teksteve në gjuhën shqipe, si kërkesë madhore në pragun e shpalljes së pavarësisë. Në vitin 1916, Hafiz Aliu përgatiti tekstin *Gramatika, sintaksa shqip-arabisht dhe fjalime*, i cili u përdor për mësimin e gjuhës arabe në medresetë e nivelit të mesëm. Në këtë tekst autori u bë themelues i gramatikës arabe në

gjuhën shqipe dhe shënoi përmirësime të ndjeshme në përvetësimin e kësaj gjuhe prej nxënësve shqiptarë. Në vitin 1919, prej të njëjtit autor është shkruar libri "Myslimania" me mësim të besimit islam dhe me njohuri shkencore mbi natyrën, qiellin, yjet, diellin, ujin, detin. Njohuri për Zotin dhe besimin sipas fuqisë mendore të fëmijëve dhe me destinacion për shkollat fillore. Me këtë vepër didaktike fetare, ai ka dashur të emancipojë nxënësit e besimit islam me gjuhën shqipe, për rrjedhojë libri përmban vlera historike, fetare dhe metodologjike.

Duke analizuar edhe të gjitha veprat e mëvonshme në gjuhën shqipe të Hafiz Aliu Korçës, si:

Mevludi, Fe-rrëfenja, Morale dhe besim, Muhamed Hanefin dhe gjylnaren, Jusufi dhe Zelihaja, Vuajtjet dhe dënimet e mia, Besimet islame dhe filozofitë e feve të ndryshme, Partitë në fenë islame, Logjikë, Histori e Shenjtë, Përhapja e feve islame, Fjalë t'arta prej gjuhësh të zjarrrtë etj., një ish-nxënës i tij, Sadik Bega, shkruan: "Hafiz Aliu, megjithëse di arabisht, persisht, turqisht dhe frëngjisht, është puritan në pikëpamjen gjuhësore. Ai përdor krejt një gjuhë të pastër dhe origjinale. Nuk dëshiron ta fabrikojë këtë. Ai shkruan thjesht shqip me një gjuhë popullore për ta marrë vesh çdokush. Ai thotë: 'Nuk duhet ta mbushim gjuhën tonë engjëllorë me gjemba e ferra, se pastaj s'i qërojmë dot asnjëhrë'. Të më falni se unë nuk dua të shkruaj shkronja të tepërta as fjalë të huaja, po krejt gjuhë popullore me dialekt të përbashkët e të lehtë.' I kam bërë gjuhës nder, me të huaj s'e kam përzier."¹⁵

Demonët keqbërës u përpoqën ta shuanin këtë pishtar ndriçues; këtë tribun të shqiptarizmit do ta internonin, burgosnin, ta dënonin me vdekje, t'i shkatërronin shtëpinë me gurë, ta quanin tradhtar, por edhe ta joshnin me poste e ofiqe.

Poeti, publicisti dhe atdhetari demokrat Hil Mosi, në vitin 1911 në gazetën "Shqiptari", do të shkruante për Hafiz Aliun: "Tërë jetën e tij ia kushtoi luftës për liri dhe arsimin shqip, ky atdhetar nuk u lodh, aq sa dhe guri të kish hequr sa hoqi zotëria e tij do të mos kish duruar dot".¹⁶

Poeti, publicisti dhe atdhetari demokrat Hil Mosi, në vitin 1911 në gazetën "Shqiptari", do të shkruante për Hafiz Aliun: "Tërë jetën e tij ia kushtoi luftës për liri dhe arsimin shqip, ky atdhetar nuk u lodh, aq sa dhe guri të kish hequr sa hoqi zotëria e tij do të mos kish duruar dot".¹⁶

Hafiz Aliu duroi me besimin dhe bindjen se vepra e tij shkonte në dobi të atdheut. Duroi edhe kur u arrestua në vitin 1914 nga rebelët e Haxhi Qamilit dhe kur u pushua nga puna në vitin 1924 nga fanatikët e fesë, dhe kur e internuan në vitin 1949 në Kavajë nga regjimi komunist, ku do të shuhej jeta e tij, por jo vepra, ashtu si Prometeu i lidhur në pranga në malet Kaukaz.

15. Po aty, fq. 278.

16. Hil Mosi. Gazeta "Shqiptare" Stamboll 1911, Faqe 55.



Anatomia e brengosjes

Dr. Adem Ergyl

Ibn Ataullah el-Iskenderi, kuddise sirruh, thotë:

“Brengosja e atij që nuk shfaq vullnet dhe nuk përpiqet t’i kryejë ibadetet, edhe pse shprehet se është zhytur në mërzi nga moskryerja e ibadeteve dhe adhurimeve, faktikisht konsiderohet si një shenjë e mashtrimit të tij.”

Nga el-Hikemu’l-Ataijje

Sinqeriteti është një cilësi njerëzore që fitohet me vështirësi. Me një shprehje tjetër, është shenja e një adhurimi që shkëlqen. Cilësia e një personaliteti që nuk e mashtron veten dhe nuk e gënjen atë, mund të ndërtohet vetëm mbi themelin e një besimi të fortë. Nisur nga kjo, mund të themi se sëmundjet që lindin nga fjalët, sjelljet dhe gjendjet, në të vërtetë janë refleksime që dalin jashtë nga dobësia në besim.

Sa kuptimplotë është fakti që Allahu Teala i cilëson si hipokritë ata që hedhin themele mbi gënjeshtëri¹ dhe sikundër kësaj, pret besnikëri prej besimtarëve.² Po ashtu edhe i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, na kujton duke e përsëritur tri herë njëra pas tjetrës se “Feja është këshillë”.³

Të gjithë miqtë e Allahut Teala pa përjashtim, kanë bërë thirrje për sinqeritet e besnikëri. Abdulkadir Gejlani, kuddisallahu sirruh, e filloi një kuvend të tij me këto fjalë:

“O bij! Jini të sinqertë, qoftë edhe sa një grimcë! Prej jush kërkoj vetëm një gjë, jo për veten time, por për ju: “Jini të sinqertë dhe besnikë!”⁴

1. Shik. Sureja el-Bakara, 10; el-Munafikun 1.

2. Shik. Sureja el-Huxhurat, 15.

3. Buhari, Iman, 42; Muslim, Iman, 95.

4. el-Fet’hu’r-Rabbani, fq. 248 (letra e 57.).

Sinqueriteti është çelësi i gradës së besnikërisë, e cila është grada më e lartë pas gradës së profetësisë. I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, na njofton kështu për këtë përgëzim:

“Të qenët i sinqertë, sigurisht se e shpie njeriun te përsosmëria e mirësisë. Nëse njeriu vazhdon të jetë i sinqertë, në fund fiton titullin “i sinqertë” te Allahu Teala.”⁵

Shpeshherë, kur themi sinqeritet dhe besnikëri, kuptohet vetëm të qenët i drejtë në fjalë dhe mosdevijimi në mashtrim. Ky është një kuptim i drejtë, por i mangët. Faktikisht, sinqeriteti dhe besnikëria janë një mënyrë jete. Madje një stil jete që reflekton ndaj çdo gjëje. Është një rregull jete që duhet të shfaqet në mendimet, sjelljet, marrëdhëniet njerëzore, ndjenjat dhe përfundimisht në gjendjet tona. Ja pra, Ibn Ataullahu, kuddisallahu sirruh, duke treguar sinqeritetin që duhet të jetë në brengosje, tha:

“Brengosja e atij që nuk shfaq vullnet dhe nuk përpiqet për t’i kryer ibadetet, edhe pse shprehet se është zhytur në mërzë për shkak se nuk i ka kryer ibadetet dhe adhuret, faktikisht konsiderohet si një shenjë e mashtrimit të tij.”

Njeriu është një krijesë që herë-herë harron, bie në neglizhencë dhe bën punë të gabuara. Faktikisht, Allahu i Madhëruar nuk pret prej tij që të mos gabojë apo të mos bëjë mëkat. E rëndësishme është që njeriu të mos bjerë në këto gjendje me vetëdije, por edhe nëse bie, duhet të pendohet menjëherë dhe ta kompensojë gabimin. Ja pra, të vepruarit me sinqeritet dhe besnikëri në këtë gjendjen e dytë, është shumë e rëndësishme.

Pendim do të thotë kthim, që përmban brenda tij një pishmanllëk të sinqertë; do të thotë një drejtim të plotë ndaj Allahut Teala dhe të vërtetës. Në këtë kthim duhet të ketë edhe brengosje. Kjo brengosje nuk duhet të jetë pasive, që e gjen të shprehurin e saj vetëm në gjuhë, por duhet të jetë një ndjenjë dinamike, që i ka rrënjët në zemër dhe i jep njeriut emocion për një hedhje të re, e cila e bën atë ta kompensojë gjënë që i ka ikur. Nëse veprohet kështu, atëherë rrëshqitja e këmbëve nga rruga e drejtë mund të jetë çelësi i një fillimi të ri, madje i një jete më të zgjuar dhe më cilësore. Kjo gjendje ndikon te njeriu si një vaksinë e bërë për të aktivizuar mekanizmin e ruajtjes së trupit.

Në lidhje me këtë lloj brengosjeje, Ebu Ali ed-Dekkak,

5. Buhari, Edeb, 69; Muslim, Birr, 102.

kuddise sirruh, thotë: “Gradën që një njeri me brengë të vërtetë e arrin brenda një muaji në rrugë të Allahut Teala, dikush tjetër nuk mund ta arrijë me vite.”

Gjendja e brengosjes që nuk e bën njeriun t’i kompensojë gabimet, nga një aspekt është një gjendje mashtrimi që njeriu i bën vetes dhe burimi i saj shpeshherë është nga nefsi dhe shejtani. Disa dijetarë e kanë quajtur këtë gjendje “mekri ilahi”, e cila është një lloj istidraxhi, domethënë, ndëshkim hyjnor për shkak se rob nuk i respekton rregullat e fesë. Shpeshherë kjo është një shenjë e zemërimit hyjnor, e cila duket si mirësi. Këtë lloj brengosjeje nganjëherë mund ta shoqërojnë edhe lotët.

Brengosja e rreme nuk mund të bëhet shkak për formimin e një vullneti të ri në brendësi të njeriut. Ai që brengoset në këtë mënyrë, duket i mërziur nga rënia në mëkat, por nuk heq dorë nga vazhdimi në të. E qorton

veten për shkak se shfaq koprraci aty ku duhet të japë, por nuk jep për të shpëtuar nga kjo gjendje. Brengoset për shkak se nuk i vlerëson kohët e agimit, por nuk përpiqet për të marrë masat e nevojshme për agimin e ardhshëm. Kjo gjendje e të tjera që i ngjajnë kësaj, janë shenjat që tregojnë se brengosja e përjetuar është një brengosje jo e vërtetë. Me një shprehje tjetër, është një mashtrim i ulët, me të cilin njeriu gënjen veten e tij. Sipas mistikëve, kësaj gjendjeje nuk është e drejtë t’i thuhet brengosje.

Disa dijetarë kanë folur për tri lloj brengosjesh:

1. Brengosja e gënjeshtarëve: Kjo është brengosja e atyre që nuk përpiqen ta kompensojnë atë që u ka ikur, edhe pse shprehen se janë brengosur.

2. Brengosja e të drejtëve: Kjo është brengosja e atyre që janë të sinqertë në këtë ndjenjë, që përpiqen menjëherë t’i kryejnë detyrat që nuk i kanë bërë dot më parë dhe që mundohen ta vlerësojnë në mënyrën më të mirë pjesën tjetër të jetës që ka ngelur.

3. Brengosja e të sinqertëve: Kjo është brengosja e atyre që u dhemb zemra dhe ndjejnë një pikëllim të madh për kohën e kaluar, për formimin e ndonjë gjendjeje neglizhence ndaj Zotit dhe për animin e zemrave, sadopak qoftë, ndaj pasioneve dhe dëshirave vetjake.

Së fundi, brengosja e pranuar është një djegie shpirtërore që e shpie njeriun në veprime të reja. Një brengosje e tillë është një kafshë e mirë mbartëse dhe një shok i sinqertë për udhëtarët e Zotit (xh.xh.).

*Brengosja e pranuar
është një djegie shpirtërore
që e shpie njeriun në veprime të reja.
Një brengosje e tillë
është një kafshë e mirë mbartëse
dhe një shok i sinqertë
për udhëtarët e Zotit (xh.xh.).*

OSMANËT

Duke lexuar veprën "Osmanët" të autorit Osman Nuri Topbash

Nexhat Ibrahim

I. SI E NJOH AUTORIN

Jeta ka dashur që autorin ta njoh nga distanca, fillimisht nga miqtë e përbashkët e më pastaj nga veprat e tij të përkthyer në gjuhën shqipe. Edhe pse nuk jam i thirrur të flas për të, sepse ka më të thirrur sesa unë, megjithatë në këtë rast do t'i shtroj përshtypjet e mia modeste para auditorit të respektuar që kam para vetes.

Osman Nuri Topbashi (Stamboll 1942) është njëri prej teologëve dhe intelektualëve me dhunti të rrallë. Ai shkruan lehtë, qartë dhe thjeshtë. Stili i tij është i kapshëm, mahnitës dhe, do ta quaja, magjik. Ai trajton tema të vështira me një gjuhë të shkoqitur e të kuptueshme për të gjitha shtresat. Duke lexuar veprat e tij, tek ai zbuloj një natyrë kreative, zbuloj se vepra e tij reflekton qetësi të brendshme, urti, mirëkuptim ndërmjet njeriut dhe botës që e rrethon, por i cili me po aq guxim flet për fenomenet dhe dukuritë që shumë autorë të tjerë i heshtin. Ai nuk nxiton drejt zhurmës dhe qëndron larg pangopësisë për të qenë në qendër të vëmendjes, ndërsa në dëm të oponentëve, nëse do të mund t'i quaja kështu rivalët e tij ideorë...

II. VEPRA "OSMANËT, ME PERSONALITETET DHE INSTITUCIONET E TYRE MONUMENTALE"

Libri që po trajtojmë, është botuar në gjuhën turke në vitin 1999, kurse në gjuhën shqipe në vitin 2009. Për fat të keq, u desh të kalojnë 3-4 vite për ta shqyrtuar, që paraqet një lëshim për të gjithë ne. Përse e them këtë? Për arsye se leximi i veprës sjell reflekse që përballen, fërkohen dhe ndeshen me probleme si nga e kaluara, ashtu dhe nga e tashmja dhe e ardhmja.

Vepra paraqet një temë, që në pikëpamjen fetare, morale, por edhe politike, ekonomike dhe kulturore ndërli-dhet drejtpërdrejt edhe me hapësirën tonë, por edhe me njerëzit tanë, si sundues apo të sunduar. Vepra paraqet

një tërësi homogjene, ndarë në dy pjesë: e para paraqet pjesën politike, ushtarake dhe ekonomike dhe e dyta paraqet pjesën fetare, shpirtërore, morale dhe kulturore.


III. DISA PËRSIATJE RRETH PËRMBAJTJES SË VEPRËS "OSMANËT"

Autori, edhe pse jo historian, në mënyrë brilante, shtigjeve të Mukaddimes së Ibn Haldunit, e fillon veprën e tij duke e përkufizuar historinë: *"Popujt dhe kombet i japin vazhdimësi vitalitetit të tyre në skenën e historisë, në sajë të elementeve të vetëdijshmërisë besimore-fetare, gjuhësore dhe historike"*, (fq. 7) për të vazhduar më tutje: *"Historia është një pishtar, i cili, me anë të evidentimit dhe analizës së shkaqeve dhe rezultateve të përjetuara nga njerëzimi në kornizën e këtyre dy elementeve, u ndriçon popujve dhe kombeve rrugët e tyre vetjake."* (fq. 7)

Historianët dhe historiografinë, pa tre elementet bazë (1. vetëdijshmëria besimore-fetare, 2. gjuhësore dhe 3. historike), autori, i quan të ndikuar nga autorë armiq të Islamit dhe të Turqisë dhe me koncepte të shtrembëruara, që nuk do ta shpjegojnë saktë të kaluarën, as që do të orientohen drejt së ardhmes. (fq. 8)

Me pjekuri të pashembullt autori pohon se *"për sa kohë që një komb njuh historinë e vërtetë dhe udhëzuesit materialë-shpirtërorë të tij, si dhe i vlerëson ata siç duhet, tregon se është një komb i madh e i përparuar."* Duke marrë parasysh se kjo është një sëmundje që ka përfshirë shumë popuj, jo vetëm Turqinë, por edhe ne shqiptarët, kërkesa për rishkrimin e historisë, është imediate në të gjitha pikëpamjet: intelektuale, shkencore, politike, ekzistenciale. Këtë e thotë bukur Efendi Topbash: *"Kurrë s'ka qenë e sigurt e ardhmja e atyre që nuk mbështeten në të kaluarën"*, përkatësisht *"Rrënjët duhet të na zgjaten kah e kaluara, kurse degët, kah e ardhmja!"* (fq. 9)

Osman Nuri Topbash, me sens prej historiani e analisti



objektiv në veprën e tij, meditoi e analizoi, hulumtoi e studioi dhe konstatoi se me kalimin e kohës po del në shesh se akuzat e qëllimshme ose injorante nuk kanë asnjë vlerë. Po ashtu, ai konstatoi se *“e djeshmja dhe e sotmja e historisë botërore nuk mund të njihen pa u njohur historia osmane”*. (fq. 10)

Akuzat për dhunë individuale dhe institucionale nga Perandoria Osmane, akuzat për dhunë ushtarake dhe ekonomike, sharjet për sulltanët dhe shtrembërimet për veprimtaritë e tyre, e shtynë autorin t’u qasej më seriozisht akuzave të përmendura dhe reflektimeve të tyre në histori, kulturë, përditshmëri etj.¹ Preokupimi i autorit dha edhe rezultatin që kemi para nesh, një vepër të shkëlqyeshme, që u ngjason krijimeve të autorëve me nam në këtë fushë.

Sulltanët osmanë – si perceptohen ndër ne?

Perandoria Osmane, përkatësisht Turqia dhe **sulltanët**, si personalitete kryesore të perandorisë, për evropianët gjatë disa shekujve të fundit, por edhe në kohën aktuale, paraqet obsesion shpirtëror dhe preokupim permanent diplomatiko-ushtarak, politiko-ekonomik e kulturoroshkencor. Deri sa te disa Perandoria Osmane konsiderohet si *“njëra prej shfaqjeve më të rëndësishme të tërë Mesjetës në Lindje dhe në Perëndim”*², te disa të tjerë ata ofendohen herë me terma etnikë e herë me ata religjiozë. Ata quhen dhunues e eksploatues, mashtrues e blasfemues ndaj *“të vërtetës”* kristiane³. Këto akuza nuk do të ndalen deri në ditët tona. Akuza të tilla te ne shqiptarët zakonisht ba-

zohen në pararendësit fanatikë kristianë, si Pjetër Bogdani, i cili Islamin e quan *“pafeja orientale”* (infedelta orientale), kurse Muhamedin (a.s.), *bari beresh e delesh*.

Mirëpo, Osman Nuri Topbash e fillon rrëfimin ndryshe. Ai mëson se njeriu përbëhet nga dy vlera të çmuara: jeta, fryma dhe mundësitë materiale. Njerëzit e përkushtuar Zotit mjaftohen me këto dy vlera, dhurata. Gjithashtu, autori ynë i nderuar na bën thirrje që sot, në këtë kohë kiçi dhe shundi të vlerave, në këtë kohë të forcës dhe të sundimit të egos, kemi së tepërmi nevojë t’i vëzhgojmë këto personalitete monumentale, t’i kuptojmë dhe të përfitojmë nga struktura ndjesore e tyre, nga vetëmohimi i tyre, duke e ringjallur atë, siç është rasti i Osman Gaziut dhe brezit të tij. (fq. 31 e tutje)

Duke përshkruar brendësinë e sulltanëve, Osman Nuri Topbash do të shkruajë se *“brenda një kohe shumë të shkur-tër, ata e bartën emocionin e besimit që kishin në zemra, në të katër anët e botës, gjithashtu, qenë ata që i mbushën faqet e arta më të zgjedhura të historisë.”* (fq. 11)

Autori u përgjigjet kundërshtarëve të osmanlinjve në mënyrë të shkëlqyer, kur pohon se *“shteti osman përbën një ndër etapat më të shkëlqyera të historisë islame pas periudhës së as’habëve”*, është shtet që e ngriti *“tërë popullsinë e vet, nga sundimtari e gjer te bariu, me dashurinë për Profetin!”* (fq. 12) Për sa u përket sulltanëve, autori pohon: *“Nuk ka sundimtar osman që të ketë urdhëruar hapjen dhe leximin e postës së ardhur nga Medina, pa marrë sërish abdest, pa u ngritur vetë në këmbë dhe pa i puthur dhe vënë në ballë letrat dhe shkresat e ardhura që atje!”* (fq. 12)

Kur njeriu përballet me këtë gjendje, sado i ngurtë në zemër e shpirt, nuk mund të mos emocionohet për këto modele edukate e respekti të papërsëritshëm. Tërë këtë e përshkruajnë më së miri fjalët e Osman Gaziut se *“që-llimi ynë s’është ndonjë trimëri botërore, por vetë lartësimi i*

1. Edhe një islamofob e turkofob si B. Lewis pohon se *“pjesa më e madhe e R - melisë nuk u asimilua kurrë as nga Islami dhe as nga ndikimi i gjuhës turke”*. Sipas: Bernard Lewis, Lindja e Turqisë moderne, Tiranë, 2004, fq. 25.

2. Joseph von Hammer, Historia turkskog (osmanskog) carstva, 1, Zagreb, 1979, fq. VII.

3. Për paragjykimet, gjenezën, rrugën, mënyrat etj. Shih në: Nexhat Ibrahim, “Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve”, botimi V i plotësuar i ndryshuar, Prishtinë, 2011, fq. 83-148.

Fjalës së Allahut", maksimë kjo të cilën e ndoqën të gjithë sulltanët. (fq. 12)

Edhe Orhan Gazi u porositi Sulltan Muratin I: *"S'mjafton t'i bëjmë osmanët sundues mbi dy kontinentet! Sepse përpjekja për lartësimin e Fjalës (fesë) së Allahut është një çështje aq e madhe, sa të mos e nxënë dy kontinentet!"* (fq. 13) (Shih faqet: 31-40)

Por vetë Sulltan Murati I, duke dhënë shpirt në Betejën e Kosovës, bëri një testament të papërsëritshëm: *"I qeshë lutur dhe përgjyruar Zotit që të ma mundësonte sherbetin e dëshmorësisë, nëse fitorja e Islamit do të kushtëzohej prej vdekjes sime! Kështu pra, lutja m'u pranua! Lavdëruar dhe falënderuar qoftë Allahu! Po e mbyll jetën, pasi e pashë fitoren e ushtarëve islamë!"* (fq. 13)

Në vazhdim të fjalimit, në Betejën e Kosovës, ai tha: *"...Një fitore e famshme që do ta arrijmë sot, do të bëhet shkak për lartësimin e Fjalës së Allahut në të gjithë Rumelinë!"* (fq. 44) (Shih faqet: 41-52)

Sundimi i drejtë dhe human osman manifestohet edhe në thënien e një fisniku bizantin, Notarasit, nga koha e Sulltan Mehmetit II Fatihut: *"Parapëlqej më shumë të shoh në Stamboll çallmën e turqve, sesa shapkën e kardinalëve."* (fq. 13)

Përse e themi këtë? Sepse Mehmeti II Fatihu ishte ushtarak kulmor, i cili e mori Konstantinopolin e pamposhtur për disa shekuj më 1453. Ishte dijetar, sepse mësuesi i tij, Akshemsedini i tha: *"...unë dua që ti të jesh jo një sulltan i paditur dhe injorant, por një sundimtar i ditur, i ndjeshëm dhe i zgjuar!"* Kjo iu tha duke e pasur parasysht hadithin e Muhamedit (a.s.): *"Sigurisht që Konstantinopoli do të ngadhënjehet! Ç'komandant i mirë është ai që do të ngadhënjë mbi të dhe ç'ushtarë të mirë janë ata që do ta ngadhënjë atë!"* (fq. 98) Ai nuk mësoi vetëm dijet ushtarake dhe politike, por edhe fikhore, të tefsirit, të kelamit, matematikës etj. (fq. 99)

Madhështia e sundimtarit shihet edhe nga tregimi vijues:

Ka qenë traditë atëherë, por edhe sot, që kundërshtari i mposhtur në fushëbetejë t'i nënshtrohet dhunës së paparë deri në vrasje mizore e përçmuese. Por, a ndodhi kjo me rastin e marrjes së Konstantinopolit nga ana e myslimanëve. Jo, nuk ndodhi, madje patriku i këtij qyteti, i mahnitur me qëndrimin e myslimanëve ndaj tij dhe tyre, i ra ndër këmbë Mehmetit II Fatihut. Por, Fatihu i tha: *"Në fenë tonë është e ndaluar përlulja para njerëzve, siç bëhet përlulja dhe rënia në tokë para Zotit! Ngrihuni! Juve, dhe bashkë me ju, të gjithë të krishterëve, po jua kthej të gjitha të drejtat dhe liritë!"* (fq. 107)

Pra, Mehmeti II Fatihu nuk ishte çfarë e paragjykoi papa Piu II, me rastin e rënies së kështjellës së Smederevës në

Serbi, më 20 qershor 1459, me ç'rast e quajti *"portë të arrestimit"*. (F. Babinger, Mehmet Pushtuesi dhe koha e tij, Prishtinë, 1989, fq. 189), nuk ishte as *"përbindësh i helmuar"* (fq. 193), as gjendja në atë kohë, nga frika e rënies së Serbisë dhe Hungarisë, kur Pietro Tomazi i shkruan nga Budimi një miku të tij në Venedik: *"Çështja e të krishterëve gjendet në rrezikun më të madh."* (Ibid., fq. 188)

Një personalitet tjetër që e ka trazuar Evropën, por edhe vendin është diçka më i vonshëm, krahasuar me të përmendurit më lart. Ai është Sulltan Abdylhamiti II (1842-1918). Këtë sulltan, disa e përshkruajnë autokrat, sundues të fuqishëm, disa e quajnë antishqiptar, ndërsa sunduesi gjerman Bismarku, e përshkroi si vijon:

"Nëse në botë ka njëqind gram mendje, nëntëdhjetë gram ndodhen te Abdylhamiti, pesë gram tek unë dhe pesë gram tek të gjithë të tjerët!"

Autori i librit, nëpërmjet copëzave të jetës së Abdylhamidit II na ofron një pasqyrë të plotë për këtë personalitet. Ishte njeri i dijes botërore dhe shpirtërore, me dhunti të pashembullt. Edhe pse e mori qeverisjen në rrethana të vështirësuar politike, ai e përfundoi sundimin e tij tridhjetë e tre vjeçar në mënyrën më të mirë në kohën e dhënë. Autori ofron shpjegime konkrete se si Abdylhamiti II ishte pengesa kryesore për realizimin e disa projekteve antiislame:

daljen ujore të Rusisë në Mesdhe, tubimin e hebrejve në tokën e Palestinës dhe formimin e shtetit izraelit, problemin ermen e të tjera, ndaj edhe këto qarqe bënë trillime të ndryshme, thurën komplete madje edhe bënë shkarkimin e tij nga posti i halifit (sulltanit). Me të drejtë, autori e quajti shfronësimin dhe vdekjen e Abdylhamitit me fjalët vijuese: *"E gjithë bota islame pothuaj pati mbetur jetimë"*. (fq. 230)

Kjo është përgjigjja më e mirë për ata të cilët kokat i kanë përplot paragjykime për Islamin, sulltanët dhe sulltanatin. (fq. 212-233)

Faktorët shpirtërorë të shpërfillur?!

Shumë autorë jomyslimanë, por dhe myslimanë e trajtojnë Perandorinë Osmane nga ana e jashtme, formale, sipërfaqësore, duke shpërfillur faktorët shpirtërorë, të cilët nëse nuk janë më të shumtë se ata materialë, atëherë janë orientues, drejtues, *alfa dhe omega* e Perandorisë Osmane. Që të dy këta faktorë i japin shtetit osman ekzistencë historike dhe themel moral-shpirtëror. Autori Osman Nuri Topbash heton me akribie të rrallë një fakt që zakonisht *"harrohet"* në veprat e këtij lloji, vazhdimësinë e shtetit osman nga selxhukët. Ata nuk formuan entitet të ri politik, por vazhduan jetën vetëm pas rënies së tyre, me një dallim cilësor; e ky dallim konsiston në faktin se osmanët

**Sundimi i drejtë
dhe human osman manifestohet
edhe në thënien e një fisniku
bizantin, Notarasit, nga koha
e Sulltan Mehmetit II Fatihut:
"Parapëlqej më shumë
të shoh në Stamboll çallmën
e turqve, sesa shapkën
e kardinalëve."**

nuk paraqiteshin si dinasti, por si bashkim entitetesh, vlerash dhe me një frymë të përbashkët që do të njihet si *osmanlinjë*. (fq. 255-257) Për këtë arsye, ky shtet është quajtur edhe *Shteti i Lartë Muhammedian* (Devlet-i Aliyye-i Muhammediyye), duke synuar prejardhjen e lartë.

Autori Topbash ka identifikuar pesë faktorë kryesorë për lindjen, zhvillimin dhe sukseset e perandorisë: 1. Përkushtimi ndaj urdhrave të Allahut; 2. Fryma mobilizuese; 3. Përgatitja e elitës së shtetit; 4. Struktura shoqërore dhe shpirtërore e popullit dhe; 5. Përsosmëria e drejtësisë dhe administrimit. (fq. 546-556)

1. Përkushtimi ndaj urdhrave të Allahut

Historianët myslimanë besojnë se jeta e një perandorie, e një shteti, varet nga përkushtimi i popullit dhe sunduesit ndaj faktorëve ndikues që formojnë themelin e shtetit dhe jetëgjatësinë e tij. Shteti osman, duke përvetësuar besimin e pastër, si në aspektin politik-ekonomik, por edhe moral-shpirtëror, përjetoi një ngjitje të përshpejtuar drejt Absolutes, që kemi vërejtur nga disa shkëputje të shkurtra gjatë ligjërit.

2. Fryma mobilizuese

Kontakti i osmanëve me myslimanët e hershëm në Iran dhe në vende të tjera dha të kuptohet se osmanët kanë frymë të përbashkët me frymën e përgjithshme islame. Nga një tribu 400 çadrash, me Islamin osmanlinjtë u bënë perandori 24 milionë km², u bënë mësues dhe udhërrëfyes botërorë në fushën e besimit, xhiadit, shkencës dhe artit.

3. Përgatitja e elitës së shtetit

Në perandorinë osmane, të gjithë personat që konsideroheshin bartës potencialë të përgjegjësisë së shtetit, përgatiteshin në mënyrë të veçantë. Ata zotëronin disa virtyte, dhuratë e Zotit, pa të cilat nuk mund të bëheshin prijës të botës. Në këtë aspekt, Sulltan Selimi i Reptë tha: *"Të mos na bëjnë krenarë duartrokitjet e vdekatarëve, kurorat e fitores dhe komplimentet e tyre dhe pastaj krenaria të na shtrijë për tokë."*

4. Struktura shoqërore dhe shpirtërore e popullit

Nëse struktura shoqërore dhe shpirtërore do të bazohet vetëm në arsye, kjo do të ishte një pikëpamje shterpe. Për këtë arsye, osmanët përvetësuan edhe fenë në kuptimin e gjerë, sepse përqendrimi vetëm në një aspekt do të çonte në dështim. Këtij faktori iu bë ndihmë edhe institucioni i vakufit, i cili paraqiste pjekuri shpirtërore dhe ekuilibruese sociale dhe moral-shpirtërore në shoqëri.

5. Përsosmëria e drejtësisë dhe administrimit

Drejtësia është ndër shtyllat kryesore të shtetit. Ky parim me shekuj shërbeu si pishtar për popullin osman, duke i ofruar njerëzimit të drejtë dhe drejtësi. Fakti që Mehmeti II Fatihu doli në gjykim me një qytetar kristian dhe humbi kundrejt tij, tregon madhësinë e një sunduesi, por edhe të një sistemi të drejtësisë. (fq. 555-553)

III. Në fund

I detyruar ta përfundoj këtë ligjërim, ndihem i pafuqi-shëm përballë gjithë atij thesari të theksuar në vepër, e të cilat unë do t'i kaloj. Megjithatë, vepra u dedikohet të gjithë lexuesve, të zakonshëm dhe profesionalistë, ndërsa leximi i vepërës, pa dyshim do të nxisë për disa gjendje emocionale dhe shqetësimet intelektuale jo të zakonshme, duke vënë në lëvizje më shumë arterie.

Vepra duhet të lexohet më shumë se një herë. Secili lexim do të reflektojë ndjenja të veçanta. Do të ndjehet se sinqeriteti dhe serioziteti gjatë shkrimit të vepërës, matura dhe pjekuria e manifestuar, dashuria që ngjall mburrje e krenari, janë vlera që nuk i gjen kudo. Vepra na mëson, por edhe qorton, udhëzon dhe ofron mirëkuptim, bashkim, përparim dhe mbi të gjitha, ofron një pasqyrë të re për Perandorinë Osmane, e cila nëpër histori është blasfemuar e anatemuar dhe shpallur për fajtor kujdestar për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen tonë. Mbi të gjitha, autori e vendos në mënyrë mjeshtërore në kohë dhe hapësirë botën materiale dhe atë shpirtërore, nga Ademi e deri te Muhamedi (a.s.).

IV. KREJT NË FUND

Vepra **"Osmanët, me personalitetet dhe institucionet e tyre monumentale"**, e autorit Osman Nuri Topbash, është një arritje e jashtëzakonshme materiale dhe shpirtërore, një sukses intelektual, është një vepër që nderon autorin dhe sfondin e historisë së përgjithshme, historisë politike, është një kontribut për përspirtërinë, kulturën dhe qytetërimin islam, osman, turk, shqiptar, boshnjak, arab.

Në dobi të vlerave pozitive të vepërës, vlen të theksohet edhe përgatitja e mirë teknike dhe estetike e librit. Sidomos, mahnit gjuha e lehtë, e thellë, plot mjete stilistike, që e bën veprën më të këndshme për lexim, më të lehtë në përdorim e më të kuptueshme në përmbajtje.

Ju faleminderit për durimin që patët! Mbetshi në paqen dhe mëshirën e Allahut të madhëruar.





Ç'të mbjellësh, do të korrësh

Mustafa Erish

Për njeriun janë fitorja dhe humbja.

Njeriu, ose ecën andej nga Zoti e drejton dhe fiton xhenetin, vendin e lumturisë së përjetshme, ose devijon dhe e humbet atë.

Ardhja e njeriut në këtë botë për t'u provuar, realizohet vetëm një herë në jetë.

Ndaj, duke u treguar të zgjuar, duhet të përpiqemi me gjithë fuqinë që kemi të shtojmë veprat e mira në këtë botë.

Ç'të mbjellësh në këtë botë, atë do të korrësh në botën tjetër.

Miqtë e Allahut e kanë vlerësuar këtë botë, si vendin e mbjelljeve dhe botën tjetër si vendin e korrjeve.

Në tefsirin "*Ruhulbejan*", është tregimi i një skllavi, që bëhet shkak të zgjohet dhe të shpëtojë i zoti i tij.

Është shumë e vështirë të kthesh në rrugë të drejtë një njeri që jeton në kryengritje dhe shkujdesje.

Por, të përpiqesh të udhëzosh një njeri, që të hyjë në rrugë të vërtetë,

është një vepër shumë e vyer dhe me shumë shpërblime.

Le ta përmendim këtë tregim që jep mësimë shumë domethënëse dhe shton vullnetin për kumtesë në fe:

Tregohet se në Belh, një njeri i tha shërbëtorit që të mbillte grurë.

Ai mbolli elb.

Kur erdhi koha e të korrave, i zoti pa që ishte mbjellë elb dhe pyeti menjëherë shërbëtorin për arsyen.

Shërbëtori, duke bërë sikur nuk po e kuptonte se përse kishte ndodhur ashtu, dha një përgjigje prej naivi:

- Zotëri, mbolla elb me qëllim që të dalë grurë.

Zotëria, duke menduar se shërbëtori po tallej me të, i tha i nxehur:

- O budalla! Ke parë ti ndonjëherë që të mbillet elb dhe të korret grurë?

Shërbëtori, i cili kurrë nuk ia kishte bërë fjalën dysh të zotit dhe që kish treguar gjithnjë kujdes dhe kishte punuar shu-

më për të, po përpiquej me çdo kusht të shpëtonte dhe të thoshte të vërtetën.

Kur mendoi se ishte koha e duhur, dha një përgjigje të tillë, që aty e tutje ndryshoi gjithçka:

- Atëherë, o zotëri! Si shpreson se do të meritosh mëshirën e Zotit, ndërkohë që i kundërvihesh gjithnjë Atij?

Pas kësaj përgjigjeje, i zoti u shtang i tëri.

Kjo ishte një fjalë e vërtetë, qortuese dhe shumë ndikuese.

Shërbëtori ishte i vetëdijshtëm dhe i singertë me sjelljet e tij.

Duke ndikuar që zotëria i tij të zgjohej, dëshironte me gjithë zemër që ai të shmangej nga kundërvënia ndaj Allahut.

I zoti u ndikua shumë nga kjo përgjigje, e ndjeu veten fajtor dhe nisi të pendohej.

Iu mbështet Allahut dhe i bëri istigfar Atij, duke u penduar për kryengritjet që i kishte bërë Atij prej vitesh.

Pastaj, i dha lirinë skllavit të vet, që kishte dhënë këtë përgjigje kaq domethënëse, që u bë shkak të zgjohej dhe të shpëtonte.

Edhe ai edhe i zoti arritën shpëtimin.

Ja pra, përpjekja që tregohet për të shpëtuar një njeri!

Ja pra, kujdesi që tregohet për kumtin islam!

Ja pra, mençuria dhe zgjuarsia!

Mbi të gjitha, qëllimi i pastër!

Pastaj, sinqeriteti, zgjuarsia dhe përpjekja!

Dhe pastaj, me këtë metodë, të përgatisësh zemrën që të ta pranojë Zoti!

Çfarëdo që të ketë mbjellë njeriu në këtë botë, atë do të korrë në tjetrën.

Bota është ara e ahiretit.

Në arë duhet të mbjellësh gjëra të mira.

Duhet të krijosh miqësi për hir të Allahut dhe duhet nisur rrugëtimi drejt Tij.

Në "Ruhulbejan", lidhur me veprat e mira dhe sjelljet e bukura, në et-Tevilatun-Nexhmijje, thuhet këto:

"Për njerëzit e imanit dhe të veprave të mira do të ketë një shpërblim të përshtatshëm me sinqeritetin dhe bukurinë e veprave.

Me disa nga veprat e mira arrihet në xhenet dhe në qoshqet e tij.

Këto janë ibadete fizike, që bëhen me qëllim të mirë.

Me disa nga veprat e singerta arrihet tek Allahu.

Ato janë ibadete shpirtërore.

Të kërkojnë sinqeritetin dhe të vërtetën.

Sinqeritetin në tevhid.

Të heqësh nga zemra dashurinë për këtë botë.

Të heqësh dorë nga gjithçka tjetër përveç Allahut.

Të drejtohesh nga Allahu, me tërë qenien tënde.

Të dorëzosh tek një murshid vullnetin tënd, i cili të shpie tek e përsosura, tek sinqeriteti dhe tek e vërteta,

Ta përqafosh fort atë dhe të mos mashtrohesh nga dëshirat e kota.

Sepse ai që mbjell elb, kurrë nuk do të korrë grurë.

*Ardhja e njeriut
në këtë botë për t'u provuar,
realizohet vetëm një herë në jetë.
Ndaj, duke u treguar të zgjuar,
duhet të përpiqemi me gjithë fuqinë
që kemi të shtojmë veprat
e mira në këtë botë.
Ç'të mbjellësh në këtë botë,
atë do të korrësh
në botën tjetër.*

PËR ETIKËN D

E gjithë ajo që njohim si kulturë dhe që e quajmë të tillë, është rezultat i çështjes së pashmangshme se *pse jetoj?*; ndërsa qytetërimi është rezultat i shtrimit të vazhdueshëm të pyetjes *si të jetoj?*, ose *si duhet t'i plotësoj nevojat e mia?* Njëra është çështje e kuptimit të jetës, kurse tjetra e mënyrës së jetesës. Qytetërimi i shkon me ngulm linjës ngjitesë (kulti i *progresit* sot) që nga shpikja e zjarrit, e mullirit dhe e hekurit, përmes shkrimit dhe makinës e deri te energjia atomike dhe fluturimet kozmike. E gjitha kultura është në gjurmim e sipër, në një kthim prapa, në një rifillim. Njeriu si subjekt i kulturës, të metat dhe virtytet e tij tipike, dyshimet dhe lajthitjet, pra e gjithë ajo që përbën qenien e tij të brendshme, tregon një qëndrueshmëri të jashtëzakonshme dhe pothuaj një pandryshueshmëri.

Të gjitha dilemat dhe pyetjet e sotme etika i ka njohur që para dymijë vjetësh, për të mos thënë që në krye të herës. Konfuci, Sokrati, Jezui, Muhamedi, Kant-i, Tolstoi, Gandi dhe Martin Buber-i, në një distancë kohore që prej shekullit të VI para Krishtit e gjer më sot (Buber-i vdiq më 1965), të gjithë këta edukatorë të mëdhenj të njerëzimit, në thelb predikonin të njëjtin moral.¹

Ndryshe nga normat e rregullimit të shoqërisë apo të mënyrës së prodhimit, të vërtetat morale janë të përhershme/amshueshme; sepse këtu enigma është shfaqur që në Krijim, me "prologu në qiell", te ky akt që i paraprin të gjithë historisë njerëzore.

Intelekti, arsimimi dhe përvoja nuk ndihmojnë vetvetiu që t'u afrohem ose që t'i kuptojmë më mirë. Jezui, të vërtetat i kumtonte si i porsalindur, ndër kohë, kur u dënua, ishte afërsisht tridhjetë vjeç. Për të vërtetat e mëdha² e themelore për Zotin dhe për njeriun, nuk i duhej ndonjë njohuri apo një përvojë e caktuar, pasi këto të vërteta nuk rroken dot me njo-

huri e me përvojë. A nuk "fshihen ato para të urtëve dhe të zgjuarve, kurse të vegjëlve u zbulohen?"³

Kërkesat qenësore morale nuk influencohen prej kohës, vendit apo rrethanave shoqërore. Kundruall dallimeve të mëdha të rregullimeve shoqërore e politike, të shkallës së zhvillimit, madje edhe të shumëllojshmërisë së besimeve e të simboleve fetare, qëndron anekënd botës përputhja dhe unikja e mrekullueshme e parimeve morale.

"Ndonëse njerëzit flasin në mënyra të ndryshme se kush është Zoti, megjithatë, gjithmonë e kuptojnë njësoj se ç'kërkon Zoti prej tyre", - thoshte Tolstoi.

Epikteti dhe Mark Aureli, i pari skllav dhe i dyti mbret, predikuan të njëjtën disiplinë morale, madje pothuajse me të njëjtat fjalë. Po të vështrojmë më me kujdes, do shohim se ndryshimet e pikëpamjeve rreth mirësisë dhe ligësisë, të lejuarës dhe të ndaluarës, i gjejmë vetëm tek ato çështje që janë më pak të rëndësishme.⁴

Shembujt që theksohen për të parë ndryshueshmërinë e normave morale në varësi nga rrethanat historike e të tjera, në fakt, nuk kanë të bëjnë asnjëherë me parimet madhore morale, por me gjëra që i përkasin moralit dhe sjelljes formale. Përkundrazi, çështjet e epërme kanë një përkim dhe një pandryshueshmëri të jashtëzakonshme.⁵

Le ta verifikojmë këtë qasje te "imperativi kategorik" i Kant-it. Këtë parim, formulimin e parë të të cilit Kant-i e jep te trajtesa *Bazat e metafizikës së moralit*, duke shkruar: "Vepra vetëm sipas asaj maksime për të cilën, në të njëjtën kohë, mund të dëshirosh të

3. Bibla, L. 10/21.

4. Izetbegović, A. Po aty, f. 202.

1. Izetbegović, A. (2000) "Islami ndërmjet Lindjes e Perëndimit", f. 201. Përkth.: Eqrem Kryeziu. Shkup: Furkan ISM.

2. Le të bëjë "punën" e vet ingranazhi dekonstruktues apo zhbërës i të vërtetave të mëdha, se të njëjtën "punë" kanë dashur të bëjnë edhe ingranazhe të tjera në çdo kohë.

5. Për shembull, disa syresh janë: thuaj të vërtetën, freno urrejtjen, të jesh i thjeshtë, të tjerët trajtoi si veten, të jesh solidar, syno lirinë, lufto për të drejtën dhe për atë të tjerëve, fitoje bukën me djersën tënde, ndero mundin e tjetrit, ndero prindërit dhe të moshuarit, kryej premtimet dhe detyrat, mbroji të pa-fuqishmit, shoqërohu me njerëz, mos u kënaq me fatkeqësinë e të tjerëve, të mos ua kesh zili lumturinë dhe suksesin të tjerëve, të mos jesh mendjemadh e i llastuar, mos u përlu për para të fortit e mos shfrytëzo të dobët, të jesh i përmbytur në kënaqësi, mos bëj dallime sipas ngjyrës së njerëzve/pasurisë/origjinës, krijo mendim të pavarur, mos u bëj egoist etj.

HE HISTORINË

bëhet ligj i përgjithshëm." Ndërsa më vonë, te *Kritika e mendjes praktike*, lexojmë: "Vepra në atë mënyrë që maksima e vullnetit tënd të mund të vlejë në çdo kohë si parim i ligjeve të përgjithshme", gjë të cilën e hasim, së pari në jetën dhe thëniet e profetëve e pastaj edhe te dijetarë e mendimtarë të ndryshëm anëmbanë botës.

Kur e pyetën Talesin, një prej shtatë të urtëve (lindi në vitin 624 para Krishtit), se si mund të jetohet më drejt, ai u përgjigj: "Kur ne vetë nuk bëjmë atë që qortojmë tek të tjerët." Pitaku i Miletit, gjithashtu një nga shtatë të urtët, ka shfaqur po të njëjtin mendim: "Mos bëj atë për të cilën qorton të afërmin." Kurse Ciceroni thotë: "Çdo gjëje që qorton tek tjetri, duhet t'i shmangesh sa më shumë." Dijetari hebreu Hitei, që jetoj përafërsisht në kohën e Jezuit në Palestinë, kur një politeist i kërkoi t'ia thoshte sa më përmbledhtazi thelbin e besimit, ai iu përgjigj në këtë mënyrë: "Atë që nuk ia dëshiron vetes mos ia bëj as të afërmit. Pikërisht kjo është e gjithë Tora; çdo gjë tjetër është vetëm shpjegim." Të njëjtën dije ka përhapur edhe Konfuci në Kinë, bashkëkohës i Budës dhe i Pitagorës: "Atë që nuk ia dua vetes nuk ia bëj as tjetrit." Fort mirë e ka shprehur këtë parim edhe Jezui: "...atë që dëshironi t'ju bëjnë ju njerëzit, po ashtu bëni edhe ju ndaj tyre." (Mateu, 7/2; Luka, 6/31)⁶

Siç e shohim fare shkoqur, kjo histori/kronologji e imperativit kategorik provon se ky parim themelor etik nuk ka histori; ka vetëm forma të ndryshme shprehjeje, ama thelbi është i njëjtë, i pandryshueshëm.

Izetbegović-i sjell edhe Indinë si shembull tipik në këtë kontekst, që njihet si vendi i "kulturës së lartë dhe i qytetërimit të ulët", që duket sikur ka jetuar jashtë historisë. Përmendoret që ndeshim pas çdo hapi dëshmojnë për një jetë intensive, por të brendshme, pra statike dhe jo-historike. Përmes meditimit "njihen" të fshehtat, por nuk arrihet dot pushteti mbi natyrën dhe as nuk ndryshohet bota. Edhe Hinduizmi nuk

është një rend shoqëror, por etik, dhe njeh vetëm ngritjen vetjake, të brendshme dhe morale.

"Që nga koha e Upanishadave, India preokupohej vetëm me një çështje të vetme: me vendin e njeriut në gjithësi", shkruan Mircea Eliade.⁷ Sistemi indian i kastave, i gurëzuar si një tempull i atjeshëm piramidor, me gjithë madhësinë dhe qëndrueshmërinë mahnitëse, ngërthen mohimin e kohës, shoqërisë, homogjenitetit dhe historisë. Çdo përpjekje historike dhe shoqërore do e rrëronte këtë strukturë magjepsëse, që ia doli të qëndrojë vetëm në botën e kthyer së brendshmi e nga Qielli, pa u bërë aspak merak se çfarë krijohet vetvetiu jashtë, në botën "reale".⁸

Një nga ndryshimet më të qenësishme – për të mos thënë më i qenësishmi – ndërmjet historisë dhe letërsisë është pikërisht dimensionin etik me të cilin është i pajisur çdo vepër e madhe letrare. Megjithatë *Iliada* dhe *Odiseja*, apo *Lufta dhe paqja* mund të lexohen edhe si rrëfime historike, asgjë historike nuk na preokupon kur i lexojmë: nga fillimi e gjer në fund të leximit hasemi dhe përkredhemi vetëm në çështje etike. Ç'rëndësi ka nëse Hamlet-i apo Macbeth-i kanë ekzistuar në të vërtetë apo jo; ama, në dimensionin etik ata kanë ekzistuar dhe ekzistojnë më vërtetësisht sesa në dimensionin historik; janë më të gjallë se çdo hero që ka ekzistuar realisht.

Mbase vetëm nën këtë qasje mund të shpjegohet "paradoksi" i besimit dhe i pranimit të tyre dhe, nga ana tjetër, problemi i mosbesimit dhe i mospranimit nga shumë njerëz i disa figurave përcaktuese në historinë e njerëzimit, si Moisiu, Jezui dhe Muhamedi.

Pra, thelbi i etikës nuk varet nga historia, pasi nuk rrjedh prej saj dhe as nuk varet në asnjë rrethanë nga ajo. Etika ka të bëjë me Pafundësinë, e cila ka dhënë në një çast të caktuar fundësinë (botën) si pohim i saj dhe si mundësi që nuk duhet humbur për t'iu rikthyer origjinës, pra Pafundësisë.

7. Po aty, f. 204.

8. Po aty, 204.

6. Izetbegović, A. Po aty, f. 203.

Logaria e Namazit

Xhafer Dermush



Megjithëse nga ana e jashtme namazi përbëhet nga disa lëvizje, lutje dhe dhikre, në thelb ka qëndrimin në audiencën e Allahut duke u shkëputur nga çdo lloj interesi me këtë botë dhe kërkimin e rrugës së afritit me paqen shpirtërore të Allahut me anë të frikë-respektit në sexhde. (shih. el-Alak, 19.) Sa jemi të vetëdijshëm për këtë?



Si thoni, nëse një ditë uleni dhe flisni përsëri rreth namazit?.. Të mendoni rreth marrëdhënies suaj me namazin si shtyllën më të rëndësishme të Islamit pas Formulës së Teuhidit...

Për shembull, kur e vendosim dorën mbi fisnikërinë e ujit, a e ndjejmë entuziazmin e përgatitjes së shpirtit bashkë me gjymtyrët e tjera që marrin abdest? Sa jemi të vetëdijshëm për faktin se qëndrimi në audiencën hyjnore me një adhurim gjithëpërfshirës si namazi, është një sukses dhe fat i madh? A jemi të vetëdijshëm për urtësinë e namazit, i cili na tërheq dhe na nxjerr nga angazhimi me punët e kësaj bote në mënyrë periodike dhe të shpeshtë?

Kur qëndrojmë (në namaz), na duket sikur e kemi Qabenë madhështore përballë dhe jemi duke lexuar ajetet e Kuranit. A e ndjejmë se jemi duke bashkëbiseduar me Allahun? Çfarë bëjmë që pesë vaktet e namazit, të cilat i falim përditë të mos na kthehen në rutinë?

A përpiqemi t'i zbukurojmë ditët dhe netët më tepër me namaz duke përjetuar miraxhin thellë brenda vetes... Dhe që për arsye të ndryshme t'i bëjmë pjesë të jetës sonë namazet vullnetare? Çfarë vendi zë në jetën tonë ky adhurim, i cili përkufizohet si "shtylla e fesë"? A ka çaste kur na merr malli për namazin dhe shkojmë në sexhde të mallëngjyer?

Në Kuran, namazi përmendet si "element i bashkimit të besimtarëve në një vend" (el-Haxh, 41) Gjithashtu, besimtarët këshillohen ta falin namazin të përqendruar dhe me frikë-respekt ndaj Allahut Teala. (el-Muminun, 2)

I Dërguari i Allahut (s.a.u.s.), e urdhëron më parë njeriun e udhëzuar me islam me faljen e pesë namazeve. Më vonë, faljen e rregullt të namazeve vullnetare në kohë të caktuara të ditës, e tregon si një qëllim të lartë i cili duhet arritur. Ai na mëson që, pothuajse të gjitha gjendjet e ndryshme njerëzore, si frikën, shpresën, gëzimin, hidhërimin, etj., t'i përballojmë me namaz. Dhe ç'është më e rëndësishmja, ai e vendos namazin në qendër të jetës së myslimanit dhe urdhëron që të tregojmë kujdes ndaj namazit edhe në frymën e fundit, sepse kërkon që ne të kuptojmë se namazi është një mekanizëm kontrolli i vazhdueshëm, i cili e mban njeriun brenda kufijve të islamit. Ai kërkon që ne të kuptojmë, se namazi disiplinon mënyrën e veshjes, ngrënies e pirjes, madje edhe mënyrën e mendimit të një myslimani. Ai dëshiron që ne të kuptojmë se namazi është siguria dhe paqja e jetës individuale dhe sociale.

Në një hadith fisnik Profeti (a.s.), thotë: "Allahu e ndihmon këtë popull për shkak të duave, namazeve dhe shqetësimit të të dobëtve." (Nesai, Xhihad, 43) Me këto fjalë, Ai kërkon që ne të kuptojmë se namazet dhe duatë tona do ta tërheqin mbi ne mëshirën hyjnore... Po ne, çfarë familjariteti kemi me namazin që ka treguar Profeti ynë (a.s.)?

Në Kuranin Kerim shohim se namazi ka qenë urdhëruar edhe për profetët e mëparshëm. (shih. Bekare, 83; Junus, 87; Hud, 87; Ibrahim, 37.) Dhe kjo tregon se namazi ka një funksion të rëndësishëm në përballimin e vështirësive. Atëherë, sa të vetëdijshëm jemi në lidhje me mënyrën e kërimit të ndihmës, në përputhje me ajetin: **“O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten me durim dhe namaz!..”** (el-Bekare, 153.)

Sa e kemi mësuar neftin tonë të përballojë me namaz çdo gjë që na gëzon apo na hidhëron? Sa kemi mësuar që me anë të namazit më parë t'i drejtojmë mendimet tona dhe t'ia paraqesim qëllimet tona kënaqësisë hyjnore?

Nëse mësohemi t'i peshojmë në mënyrë të shpesh-të veprimet tona në peshoren e namazit, patjetër që ai (namazi) do të na pastrojë, sepse ashtu siç bëhet shkak për pastrimin fizik, bëhet shkak edhe për shpëtimin e të zotit nga batakut i gjynaheve. (shih. el-Ankebut, 45.) Në një hadith fisnik, Profeti ynë (a.s.), na ka dhënë myzhdënë, se: *“Besimtari që fal namaz pesë herë në ditë, pastrohet nga gjynahet ashtu siç pastrohet një njeri pesë herë në ditë në lumin që i rrjedh para shtëpisë.”* (shih. Buhari, Meuakit, 6.) Pra, sa e dëshirojmë një pastrim të tillë apo edhe më shumë?

Megjithëse nga ana e jashtme namazi përbëhet nga disa lëvizje, lutje dhe dhikre, në thelb ka qëndrimin në audiencën e Allahut duke u shkëputur nga çdo lloj interesi me këtë botë dhe kërkimin e rrugës së afrimit me paqen shpirtërore të Allahut me anë të frikë-respektit në sexhde.

(el-Alak, 19) Sa jemi të vetëdijshëm për këtë?

Për myslimanin, namazi është një mbajtëse e sigurt, e cila i forcon lidhjet e tij me islamin, një burim mëshire, i cili ndriçon gjymtyrët dhe zemrën duke i pastruar nga gjynahet dhe një shkollë ku bukuritë e moralit islam mësohen duke u jetuar. Është një vendstrehim ku njeriu mund t'ia paraqesë Allahut Teala çdo problem dhe gjendje me të cilën përballlet...

Disa nga pyetjet që duhet t'i drejtojmë neftit tonë në lidhje me namazin, duhet të jenë edhe këto:

- Cilat janë qëllimet tona që përpiqemi t'i realizojmë në jetën e cila është si një udhëtim, që fillon me një ezan pa namaz dhe përfundon me një namaz pa ezan?

- Sa përpiqemi të arrijmë përqendrimin në namaz, me qëllim që namazi ynë t'i ngajë atij të Profetit tonë të dashur (a.s.)?

- Sa mundohemi t'i zbukurojmë ditët dhe netët tona me namaze vullnetare?

- A e qëndisim dashurinë për namazin në zemrat tona dhe sa mundohemi ta përçojmë atë dashuri tek zemrat e tjera?

Shoqërinë me namazin, e cila fillon që prej moshës shtatë vjeç e deri në frymën e fundit, duhet ta marrim më seriozisht, në mënyrë që ajo të ëmbëlsohet me kalimin e kohës. Prandaj, duke kontrolluar gjendjen në kohë të caktuara, duhen bërë veprimtari të ndryshme me qëllim që të rinovohet entuziazmi dhe emocioni i namazit.

Lexo, Mendo

“O xhinde dhe njerëz, nëse keni fuqi të përshkoni kufijtë e qiejve dhe të Tokës, atëherë përshkujini ato! Por nuk do të mund ta bëni këtë, përveçse me një fuqi të madhe!” (er-Rrahman, 33.)

Fjala “sulltan” që kalon në këtë ajet dhe është përkthyer me fjalën “fuqi”, në shkencën e tefsirit theksohet se mund të kuptohet edhe si “kompetencë”. Duke marrë për bazë këtë fakt, ajeti i lartpërmendur mund të shpjegohet edhe në këtë mënyrë: “Përshkrimi i kufijve të qiejve dhe tokës, mund të realizohet vetëm me anë të një lloj kompetence apo aftësie të dhënë prej Allahut”. Dhe pas kësaj, vjen ky lloj koment:

“Këtu kërkohet të tregohet një lloj fuqie, e cila do të arrihet si rezultat i përpjekjeve që do të bëjnë ata të cilëve u drejtohet ky ajet, brenda kuadrut të ligjeve të Allahut, të cilat janë të mundshme në gjithësi. Dëshira e birit të njeriut për të njohur edhe pikat më të largëta të gjithësisë nuk është për t'u habitur dhe kjo mund të realizohet nëse arrihet të gjendet një

fuqi e madhe.

Në ajetin fisnik, xhindevë dhe njerëzve u tërhiqet vëmendja të mos mashtrohen pas mundësive që u janë dhënë dhe u kujtohet se nuk do të jetë e mundur t'i shpëtojnë vdekjes dhe dhënies së llogarisë përpara Allahut...”¹

Në Kuranin Kerim gjendet fara e të gjitha ngjarjeve që kanë ndodhur dhe që do të ndodhin. Përveç udhëtimit të jashtëzakonshëm për të cilin bëhet fjalë, ky ajet na fut në një udhëtim në thellësitë e hapësirave të shpirtit, të cilat janë më të rëndësishme për ne. Pra, rezultatet që arrihen me anë të mendjes, t'ia shfaqim njerëzimit me anë të pasurisë shpirtërore.

Besojmë se njerëzit që i japin më tepër rëndësi përmirësimit të gjendjes së tyre shpirtërore, ditën që do të dalin në udhëtimin e përmendur në ajet, do ta gjejnë kuptimin e vërtetë të udhëtimit në hapësirë.

1. Shih. “Kur'an Yolu” përkthimi dhe tefsiri në turqisht në lidhje me ajetin e përmendur.



Drejt lumturisë

OBJEKTIVI OPTIMAL

Altin Torba

Njeriu në këtë jetë është në një udhëtim dhe objektivi optimal që ai bart në shpirtin e tij, është arritja e lumturisë për të dhe dashamirët e tij.

Ndërkaq, kudo rreth e rrotull, teksa hedh sytë, njeriu befasonet nga stresi, ankthi dhe depresioni, që ka kapluar njerëzit e tjerë; dikush nga halle reale e dikush nga halle të sajura.

Në këtë situatë, unin e njeriut e pushtojnë një sërë pyetjesh:

A ekziston apo jo lumturia? E, nëse jo, pse atëherë njerëzit rendin si të marrë pas saj?

Në botën tonë plot halle, a është e mundur që njeriu të jetojë i lumtur?

A ekziston ndonjë çelës apo formulë magjike për ta bërë tonën lumturinë?

Si mund të ndihemi të lumtur në këtë botë, pra cilat janë mënyrat dhe rrugët që çojnë drejt lumturisë?

A mund të arrijë njeriu tek lumturia i vetëm, pa ia shtrirë dorën askujt, pa llogaritur askënd dhe pa ia vënë veshin askujt?

Cili është roli i i prindërve, familjarëve, shokëve, kolegëve, fqinjëve dhe mbarë individëve të shoqërisë, në lumturimin tonë?

A mund të arrihet lumturia pa besimin te Krijuesi i njeriut dhe pa udhëzimin e Tij përmes rrezeve ndriçuese të profetëve të Tij fisnikë?

Të gjitha pyetjet në fjalë qëndrojnë dhe këto pyetje e bartin përgjigjen e tyre brenda vetes. Të përqendruarit tek

këto pyetje zbulon përgjigjen se lumturia është e mundur të arrihet vetëm duke përparuar nën moton: "Një popull që lexon, përparon".

Pa dyshim, rendin e parë në botëformimin tonë e përbën literatura që na njeh me Krijuesin tonë. Një hap tjetër i rëndësishëm drejt lumturisë qëndron tek të kuptuarit se problemi më i madh është mënyra se si i mendojmë dhe trajtojmë problemet tona.

Po kështu, dinamizmi në rrugën drejt lumturisë ruhet duke rinovuar forcën tonë shpirtërore mbi moton hyjnore: "Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata ta ndryshojnë vetveten".

Kuptimi i drejtë i këtyre parimeve do të na ndihmojë me siguri në kapërcimin e barrierave e, pse jo dhe në sheshimin dhe përdorimin e tyre mbi moton: "Ji njeriu që me gurët që i hidhen, ndërton tabanin dhe themelin e kështjellës së tij të lumturisë..."

"Drejt lumturisë", frazë e mrekullueshme dhe shumë e ëmbël, që bart dy fjalët më të ndritura, që bart orientimin, që thith brenda tij mbarë jetën e njeriut...

"Drejt" është vektori, shigjeta e kahut të jetës tënde, por dhe të jetës së mbarë njerëzve të tu të dashur... Ajo të fton të njohësh drejtimet e tua një nga një, segment për segment, sepse janë pikërisht ato, që përbëjnë jetën tënde të shkurtër, o njeri...

Të ftoj të marrësh një laps e një letër dhe të shkruash përkufizimin më të bukur që ti mendon për jetën tënde... Pasi ta kesh shkruar, krahasojë atë me përkufizimin brilant

të të Dërguarit të Zotit, mbi “njeriun dhe jetën”, se kemi të bëjmë me një “Shtegtar të ulur të pushojë në hijen e një peme, në një ditë zhegu, pastaj niset...”; gjë në lidhje me të cilën Profeti (Paqja qoftë mbi të!), thotë:

“Nuk jam unë dhe dynjaja, përveçse si një udhëtar që ka qëndruar nën hijen e një peme dhe pastaj ka ikur dhe e ka lënë atë.” (Tirmidhiu)

Pra kjo jetë është vetëm një udhëtim, i cili ka një distancë fare të shkurtër. E vërteta qëndron se “udhëtimi jetë” është i mbushur me sfida dhe vështirësi, por pas tij çfarë vjen?...

Pas tij vjen destinacioni “Lumturi” ose ai “Dështim”.

Kjo duhet të na bëjë që jetën tonë ta shohim në përmasat e saj të vërteta, pa e ekzagjeruar, por edhe pa e neglizhuar. Gjithsesi fakt është se udhëtimi “jetë”, është shumë i shkurtër, përfundon shumë shpejt e që të bindesh, hidhi sytë në jetën tënde të shkuar, të cilën të sfidoj ta mbash për freri, e cila vetëm të merr dhe nuk të jep asgjë, ajo është siç thotë populli “hyr në këtë derë e dil në tjetrën”.

Në fakt, pyetja më e madhe që shtron veten e saj para njeriut, është:

Cili është qëllimi optimal, rendja pas të cilit i mundëson njeriut të arrijë tek lumturia?

Psikologët myslimanë na ftojnë ta zbulojmë dhe vendosim Objektivin tonë Optimal përmes dy mënyrave në vijim...

MËNYRA E PARË: ZBULIMI I OBJEKTIVIT OPTIMAL PËRMES RRUGËS NGJITËSE

Fillon duke i vendosur vetes një objektiv normal, për shembull, do jem më i miri në punën time dhe, pasi të jesh bindur për rëndësinë e këtij synimi, në vijim pyete veten: “Ja, e arrita këtë, po tani çfarë?” Pas objektivit apo synimit të dytë, vijo ta pyesësh veten sërish: “E arrita edhe këtë objektiv, po tani çfarë?” E kështu me radhë...

Kështu do fashiten para teje objektivat flakëkashtë, duke të dhënë mundësi të depërtosh në horizontet e paanë drejt lumturisë, përmes gjetjes së Objektivit Optimal...

Shiko se çfarë kërkon dhe çfarë të ofrohet dhe në fund gjej se cili objektivi i kënaq ambiciet e tua... Pikërisht ky objektivi optimal është ai të cilit duhet t’i shërbejnë të gjitha objektivat e tua...

Gjithsesi, në kuadrin e gjetjes së objektivit optimal, të ftoj t’ia vësh veshin kësaj oferte dhe ta klasifikosh atë. Të siguroj se ke për të gjetur se ajo është oferta e vetme e mundshme për të qenë Objektivi Optimal...

E kam fjalën për ofertën e Zotit të gjithësisë:

“Hyni në të (Xhenet) me paqe e siguri. Kjo është Dita e amëshimit! Aty do të kenë çfarë të duan - e prej Nesh (do të kenë) edhe më shumë (se ajo që ata duan)” (Kaf, 34-35)

MËNYRA E DYTË: ZBULIMI I OBJEKTIVIT OPTIMAL PËRMES RRUGËS ZBRITËSE

Mendoje veten brenda sekuencave dramatike të faktit se doktori pas një sëmundjeje të befasishme që të ra, të verifikon dhe të ndërgjegjëson se të mbeten vetëm rreth dy muaj jetë... Pas kësaj, mendo: nga planet e shumta që kishe, cilët janë ato plane që do t’i anulosh dhe cilët janë ato plane të cilave do t’u japësh përparësi...

Tani mendo se doktori të tha se ke vetëm një javë jetë... Tani se ke vetëm dy ditë jetë... E së fundi, se ke vetëm pak momente jetë...

Këtu qëndron edhe thelbi i thënies së urtë profetike: **“Shpeshтони, përkujtimin e rrënuesit të kënaqësive!”** (Transmetuar nga Ahmed)

Sigurisht që Profeti ynë fisnik (Paqja qoftë mbi të!), nuk na urdhëron që ta kujtojmë vdekjen për të rënë në demoralizim, por na e bën këtë apel, me qëllim që në këtë mënyrë të zbulojmë objektivin optimal, e më tej jetën tonë ta drejtojmë në këtë kahje... Madje, një kujtesë e tillë na kumtohet përmes udhëzimit profetik në çdo namaz që falim, nën jehonën: **“Kur të ngrihesh të falësh namazin, fale si të jetë namazi i lamtumirës (ndjarjes nga kjo botë)!”** (Ibën Maxhe)

- Në fakt ti, unë dhe njerëzit mbarë, bëjmë pjesë tek speciet humane, të cilat i takojnë tri ekzistencave:

Një: Modelimi i parë që përfshin tri etapa

Etapa e parë: Mosekzistenca, gjë në lidhje me të cilën Allahu i Lartësuar thotë:

“Vallë, a nuk ka kaluar një periudhë kohore, kur njeriu nuk ka qenë qenie e denjë për t’u përmendur?” (Insan, 1)

Etapa e dytë: Ekzistenca në botën e “kodeve gjenetike të paraardhësve”, para ardhjes konkrete në këtë botë, gjë në lidhje me të cilën Allahu i Lartësuar thotë:

“Kur Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri të dëshmojnë përkundër vetes së tyre, u tha: ‘A nuk jam Unë Zoti juaj?’ Ata u përgjigjën: ‘Po, dëshmojmë se Ti je’” (Araf, 172)

Etapa e tretë: Ekzistenca në barkun e nënës, gjë në lidhje me të cilën Allahu i Lartësuar thotë:

“Allahu ju ka nxjerrë nga barku i nënave tuaja e ju nuk dinit asgjë dhe ju dha të dëgjuarit, të parët dhe zemrat, që të jeni falënderues.” (Nahl, 78)

Dy: Ekzistenca e Dynjasë, që përfshin dy etapa

Etapa e parë: Jeta e zgjimit – dhe – **Etapa e dytë:** Jeta e gjumit;

Tre: Ekzistenca e Amëshimit, që përfshin gjithashtu dy etapa

Etapa e parë: Jeta e Varrit – dhe – **Etapa e dytë:** Jeta e pasosur.

Etapa jetike më e shkurtër e ekzistencës së njeriut, është jeta e kësaj bote, mesatarja e së cilës është gjashtëdhjetë vite. Kurse jeta më e gjatë e tyre është ajo e Amëshimit, që në fakt, është jetë e pambarim.

Megjithëse "udhëtimi dynja" është kaq i shkurtër, shpërblimi për të është infinitiv.

Përjetimet e kësaj bote, sado e sido qofshin dhe sado zgjatshin e u jetofshin, po të viheshin përballë atyre të Amëshimit të përjetshëm, nuk kanë asnjë vlerë.

Faktit se jeta e kësaj bote është shumë e shkurtër, kur i bashkëngjitet edhe fakti tjetër se ajo përbëhet nga malore dhe tatëpjeta të shumta, sjellin tek njeriu reflektimin kritik kundrejt vektorit "drejt Lumturisë".

U kuptua tani se përse tek Zoti, kjo dynja nuk ka vlerë as sa krahu i një mushkonje; gjë në lidhje me të cilën Profeti (Paqja qoftë mbi të!), thotë:

"Nëse dynjaja do kishte tek Allahu vlerë sa një flatër mushkonje, qafiri (jobesimtari) nuk do të pinte prej saj as edhe një gllënjë ujë." (Tirmidhiu)

Që të reflektosh mbi çmimin e dynjasë të ftoj të marrësh një krah mushkonje dhe të dalësh ta shesësh?! Pas këtij realiteti, të ftoj që, sado të mëdha të jenë hallet dhe problemet e tua të kësaj bote, të mos i ekzagjerosh ato, por t'i shohësh në dimensionet e tyre reale, pra në ato të krahut të një mushkonje.

"Drejt lumturisë", frazë e mrekullueshme dhe shumë e ëmbël, që bart dy fjalët më të ndritura, që bart orientimin që thith brenda tij mbarë jetën e njeriut...

Realiteti i parë i vektorit "drejt", të frazës "Drejt Lumturisë", është se vuajtjet dhe gëzimet në udhëtimin jetë janë shumë të shkurtra, madje shumë më të shkurtra se vetë jeta. Kjo na fton që veten tonë ta programojmë mbi logjikën: "Kur të ndihesh i lodhur dhe i dërmuar, dije se gjithçka do të përfundojë shumë shpejt."

Njëqind vite më parë, asnjë nga njerëzit që të rrethojnë, që sot janë bashkë me ty, nuk ekzistonin. Njëqind vite më pas, asnjë nga njerëzit që janë me ne bashkë, nuk do të ekzistojë. Teksa qielli, malet dhe stolitë pa garanci të tokës do të ngelen po ato dhe prej saj do të ndryshojë vetëm komponenti i saj "pjesë ndërrimi" e quajtur "njeri".

"Drejt lumturisë", frazë e mrekullueshme dhe shumë e ëmbël, që bart dy fjalët më të ndritura, që bart orientimin që thith brenda tij mbarë jetën e njeriut...

Realiteti i dytë i frazës "Drejt lumturisë" gjendet tek nocioni apo kuptimi i fjalës "lumturi", që na fton të mendojmë mbi realitetin e lumturisë, se ku gjendet lumturia e plotë, se cila është rruga për tek lumturia optimale?

Po të pyesësh edhe njeriun më të thjeshtë rreth kësaj pyetjeje, ai pa hezitimin më të vogël do të thotë se në këtë botë askush nuk mund të jetojë i lumtur përgjithmonë, edhe pse çdo lëvizje që njeriu bën në këtë botë, e bën me qëllim që të fitojë lumturinë. Madje edhe vlerën e parave njeriu e mat nga lumturia dhe gëzimi që i falin, gjë që përbën standardin matës edhe për dashurinë, fëmijët, karrierën etj., që të gjitha i konsiderojmë me vlerë dhe

i duam vetëm ngaqë mendojmë dhe ndjejmë se ato na bëjnë të lumtur.

Por lumturia e plotë dhe perfekte nuk ekziston në këtë botë. Atë nuk e gjeti edhe pse me gjak dhe dhunë ekstreme, as Faraoni dhe as faraonët pas tij, as Enveri dhe as enverët pas tij...

Lumturia e plotë dhe perfekte ekziston vetëm në Xhenetin e Amshimit. Kjo botë nuk është gjë tjetër veçse një testim, me anë të të cilit përzgjidhen njerëzit që e meritojnë Lumturinë Optimale, Parajsën, vijueshmëri e lumturisë së limituar të kësaj bote.

"Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë..." (Mulk, 2)

- Ejani të imagjinojmë së bashku fundin e udhëtimit "drejt lumturisë", me qëllim që t'i vendosim me bindje këmbët, në fillimet e vërteta të udhës drejt saj!

Jemi në udhëtim e sipër për të mbërritur në Xhenet. Kaluam testin e peshimit të veprave dhe përpara nesh shtrihet panorama gjigande e Urës Madhështore të Siratit... Allahu na ndihmon dhe arrijmë ta kalojmë edhe Urën e Siratit.

A e dini se çfarë na pret paskëtaj? Përpara nesh shpалoset gjigande dhe brilante, Dera e Xhenetit.

Kur e pyetën një njohës të Zotit se kur do të ndihet njeriu i qetë Ditën e Kiametit, ai u përgjigj: "Kur ta ketë lënë Siratin pas shpine".

Para se të hysh në Xhenet, vetë Zoti i Lartëmadhëruar do t'u flasë njerëzve, në mesin e të cilëve ti gjendesh, do ta dëgjosh zërin e Zotit që thotë:

"O banorët e Xhenetit, nga Unë keni katër gjëra: do të jetoni përjetësisht dhe nuk do të vdisni, do të jeni të shëndetshëm dhe nuk do të sëmureni, do të jeni të rinj dhe nuk do të plakeni dhe do të jeni të lumtur dhe nuk do të hidhëroheni".

- Le të futemi me tërë qenien tonë në sekuencat brilante të kësaj panorame!

A e sheh sa e madhe është dera e Xhenetit? A i sheh ngjyrat e saj të bukura? A po e këqyr tubimin madhështor që po drejtohet të hyjë në të, në kreun e të cilit ke profetin Muhamed (Paqja qoftë mbi të!), Ebu Bekrin, Umerin, Uthmanin dhe Aliun (Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë!), pranë e pranë me babanë e profetëve, Ibrahimin, me Musain dhe Isain (Paqja qoftë mbi ta!).

Ja, profeti Muhamed (Paqja qoftë mbi të!), i avitet portës së Xhenetit.

Ti që ke pasur mundësi të shohësh ndonjë prej festimeve përrallore të kësaj bote, ç'mund të thuash për festën e kësaj dite?

"Ndërsa ata që i janë frikësuar Zotit të tyre, do të çohen grupe-grupe në Xhenet. Kur t'i afrohen atij, dyert e tij do të hapen e rojtarët e tij do t'u thonë atyre: 'Shpëtimi qoftë mbi ju! Ju keni qenë njerëz të mirë, andaj hyni në të dhe qëndroni përgjithmonë!'" (Zumer, 73)

O vëlla mysliman, që në dynja u ofrove ndihmë jeti-

mëve, shpërblimi i kësaj vepre është që tani të qëndrosh pranë Muhamedit (Paqja qoftë mbi të!).

O motër myslimane, që pasi dëgjove hadithin profetik: **“Njeriu që do jetë më pranë meje, është ai që ka pasur moralin më të lartë”**, u pasurove në dynja me moralet më të larta; shpërblimi i kësaj vepre është që tani të qëndrosh pranë Muhamedit (Paqja qoftë mbi të!). Mendo, o motra ime besimtare sesi në ato momente të mrekullueshme do ta gjesh veten të rrethuar nga gratë më të lavdishme dhe më të ndershme, gratë e Profetit (Paqja qoftë mbi të!), të sahabëve dhe nga mbarë gratë e tjera të devotshme.

Ja, tani të gjitha vështrimet janë drejtuar tek profeti Muhamed (Paqja qoftë mbi të!), i cili ka arritur tek porta e Xhenetit. Ai troket dhe nga brenda dëgohet zëri i engjëllit rojtar: “Kush është?” Profeti (a.s.), përgjigjet: **“Muhamedi, biri i Allahut”**. Engjëlli nga brenda përgjigjet: “Ekskluzivisht ty më ka urdhëruar Zoti që të ta hap këtë portë”.

Teksa hapet kjo portë gjigande, e stolisur prej pllakash madhështore prej floriri e prej vargu margaritarësh të kuq, del në pah distanca supergjigande e portave të çelura të saj e megjithatë, besimtarët hynë në të duke u ngjeshur sup më sup.

Atë ditë, ti sheh melekët dhe vetë Xhibrilin (paqja qoftë mbi të!) dhe teksa po hyn në portën e Xhenetit, vetë melekët të urojnë mirëseardhjen.

Vallë, çfarë do të bësh me të hyrë në xhenet?

Një herë Kajsi, një shoku ynë nga Iraku, na e drejtoi pikërisht këtë pyetje... Pasi të gjithë ne u përgjigjëm, iu drejtua atij të na jepte përgjigjen e tij dhe ai me përmallim, tha: “Ndërsa unë, me lejen e Allahut të Madhëruar, me t’u akomoduar në Xhenet, do i kërkoj Zotit tim të më mundësojë të shoh në “teknologjinë 3D (tredimensionale) hyjnore”, historinë e mbarë njerëzimit, nga njeriu i parë e deri tek i fundit...”

Allahu i Lartësuar në një thënie të shenjtë thotë: **“Kam përgatitur për robërit e Mi të ndershëm, gjëra që syri nuk i ka parë, veshi nuk i ka dëgjuar dhe as në mendje kujt nuk i kanë shkuar”**.

Nëse drejtori i një banke të thotë se do të të japë një shpërblim, menjëherë mendja të shkon tek milionat. Nëse vetë presidenti i shtetit është ai që të premton një shpërblim të madh, menjëherë mendja të shkon tek qindra milionat.

Por çfarë mendon për shpërblimin e Zotit të gjithësisë, i cili po na thotë: **“Kam përgatitur për robërit e Mi të ndershëm, gjëra që syri nuk i ka parë, veshi nuk i ka dëgjuar dhe as në mendje kujt s’i kanë shkuar.”**

Vallë, sa vende të bukura kemi parë? Sa vende kemi vizituar? Sa gjëra të bukura kemi dëgjuar? Secili prej nesh e di se sfera e gjërave që kemi dëgjuar është më e madhe dhe më e gjerë se e atyre që kemi parë. Mbi sa gjëra të bukura kemi fantazuar? Padyshim që sfera e imagjinatës dhe fantazisë është akoma më e madhe.

Të gjitha këto nuk kanë aspak vlerë para asaj që ka përgatitur Allahu i Madhëruar për besimtarët në Xhenet.

Nëse e vëmë re me kujdes, hadithi i mësipërm, fillon me foljen “kam përgatitur”, koha e shkuar, veta e parë. Koha e shkuar e foljes tregon se Xheneti tanimë është i përgatitur dhe është në pritje të besimtarëve për ta populluar, teksa veta e parë e foljes “kam”, tregon se Xhenetin e ka përgatitur vetë Zoti i Lartmadhëruar dhe nuk i ka urdhëruar melekët që ta përgatisin.

Ja, tani arrite tek çifligu yt, dhe po mbetesh gojëhapur... Tani që po e sheh, është edhe më e mrekullueshme, edhe pse paraprakisht ti kishe dëgjuar dhe besuar

mbi mrekullinë e Xhenetit, nisur nga fjalët e të Dërguarit të Zotit (Paqja qoftë mbi të!): **“Në të (Xhenet) një tullë (e ndërtesave) është prej ari, një tullë prej argjendi dhe llaçi i tyre është misku më i mirë.**

Guralecat e tij (Xhenetit) janë perla dhe margaritarë. Dhëu i tij është (për nga aroma si) Ze’aferani (parfumi) aromëmirë”.

Në dynja kishe dëgjuar thënien e Profetit (Paqja qoftë mbi të!), mbi bano-rin e Xhenetit se si:

“...lëshohet (ky person) duke ecur lehtë në Xhenet, derisa lartohet para tij një pallat luksoz prej diamanti të ndriçueshëm. Menjëherë lëshohet përdhë duke e vendosur ballin në tokë. I thuhet:

‘Ngrije kokën! Çfarë ke?’ Thotë: ‘Pashë Zotin tim (sepse për vegimin e ndritshëm që pa kujton se është nuri i Zotit të vet)’. I thuhet: **‘Ngrije kokën! Është një shtëpi prej shtëpive tuaja’... Ecën përpara, derisa hapet para tij një pallat luksoz, që është i tëri një diamant i ngrënë përbrenda (dhe në brendi të tij janë ambientet e mrekullueshme të këtij pallati të mahnitshëm). Tavanet, dyert, kanatet dhe bravat (e këtij pallati) janë po prej diamanti. E pret (këtë person teksa hyn në këtë pallat) një brendi prej xhevahiri të gjelbër. Secilën brendi të stolisur e pason një tjetër me tjetër ngjyrë... I thuhet (këtij personi): **“Vështro jash-të rreth e rrotull! Ky është çifligu yt. I duhet (vështrimi të) syrit tënd 100 vjet që ta kaplojë atë.”** (Ibn Ebi Dunja, Tabaraniu dhe Hakimi)**

“Ngado që të hedhësh sytë, do të shohësh (aty në Xhenet) lumni dhe një mbretëri të madhe.” (Insan, 20)





Shiko kurthin

dhe jo ushqimën

Ali Riza Temel

Ashtu sikurse thotë edhe Mevlana, njeriun e rrethojnë mijëra kurthe. Ne jemi si zogjtë, të uritur dhe lakmues. Ambicia jonë për kallirin e grurit bëhet pengesë për të parë kurthin që ndodhet menjëherë para tij, që do të thotë se për atë kalli gruri flijojmë edhe veten tonë. Për të zënë miun, në kurth, vihet djath. Lakmia e miut për djath bën që ai të flijojë veten e vet. Ushqimi në majë të grepit është një kurth. Në vend që ta fitojmë bukën duke u munduar pak, sa e sa dëmtime pësojmë për shkak të përtacisë dhe ambicies që shfaqim duke u përpjekur të fitojmë pa mundime.

Edhe pema e ndaluar ishte një kurth, një provë. Aty nuk bëhej fjalë të qëndrohej i uritur dhe i etur. Mirëpo, Iblisi e zbukuroi kurthin: **“Por djalli e cyti: ‘O Adem, a do të të tregoj pemën e përjetësisë dhe të një mbretërimi që nuk zhduket?’ Kështu, ata të dy, (Ademi dhe Havaja), hëngrën nga ajo pemë...”** (Taha, 120 – 121)

Rënia në kurthin e shejtanit i bëri ata të dilnin nga

xheneti. Shejtani vazhdon të ngrejë kurthe. Puna e tij është të mashtrojë, kurse e jona është të mos mashtrohem. Ne, në një farë mënyre, jetojmë në një fushë të minuar që kanë krijuar nefsi dhe shejtani. Gjynahet janë si minat, që janë shtruar në rrugën për në xhenet. E rëndësishme është se përmes detektorëve Kuran dhe Sunet, vërehen këto mina edhe pa shkelur mbi to dhe në mënyrë të shëndetshme mbërrihet në bregun e shpëtimit. Shejtani i zbukuron gjynahet dhe përmes të gjitha mënyrave bindëse të propagandës, njerëzit i nxit për gjynah. Pasi ta ketë bërë gjynahun, veçohet në një qoshe dhe thotë: **“Vërtet, Allahu ju bëri një premtim të vërtetë. Edhe unë ju premtova, por ju mashtrova. Unë nuk kam pasur kurrfarë pushteti mbi ju. Unë thjesht ju thirra e ju m’u përgjigjët. Prandaj, mos më qortoni mua, por qortoni veten! Unë nuk jam shpëtimtari juaj e as ju nuk jeni shpëtimtarët e mi...”** (Ibrahim, 22)

Shkaku kryesor pse njeriu bie në kurth është ambicia. Ambicia bën syrin të verbër. Dëshirës së tepruar

i themi ambicie. Në jetë secili ka dëshirat e veta. Kjo gjë është më se e natyrshme. Shpresat dhe dëshirat e njeriut bëjnë që ai të qëndrojë në këmbë në jetë. Jeta, pasuria, interesimi për dituri, posti, karriera dhe dëshirat e nxisin njeriun të punojë. Lumturia dhe suksesi i njeriut janë të varura nga matura dhe racionimi i këtyre dëshirave. Ambiciet që kthehen në furtunë, zjarr e stuhi, bëjnë që të shkatërrohet edhe individi edhe shoqëritë.

Filozofi francez, Voltaire (Volteri) shprehet: *“Ambicia ngjan me erën që fryn velat e anijes. E tepërta e fundos anijen, e pakëta e mban atë në vendin e saj. Racionimi i saj është i mirë.”*

Ambiciet që dalin jashtë kontrollit të imanit dhe arsyes janë porsi uji që vërshon dhe thyen edhe argjinaturat. Nëse potencialin tonë nuk e shpenzojmë për dëshirat tona të këqija, por për të arritur synimet tona të mira, shpëtojmë nga kurthet dhe mbërrim tek lumturia e përjetshme.

Ata që harxhojnë jetën e tyre për kënaqësi të çastit të kësaj bote, në fund do të arrijnë në një pendim të thellë dhe do të përballen me një shkatërrim të dhimbshëm. Mevlana, njerëzit e tillë, i përngjason me një gjahtar budalla, që nuk e sheh zogun në ajër, por vrapon pas hijes së tij në tokë. Ashtu si kurse kurthet, po ashtu edhe ushqimet që vendosen në kurthe janë të llojllojshme. Veçanërisht në ditët e sotme, këto kurthe dhe ushqime janë shumë tërheqëse dhe joshëse. Xheneti është i rrethuar me gjëra që nefs i pëlqen, kurse xhehenemi me gjëra që nefs i pëlqen.

Ibn Mukaffa ka thënë: *“Allahu i sprovon ibadetet e njeriut me mundime, kurse haramet me kënaqësinë ndaj tyre.”*

I ndjeri Gazaliu përngjason gjynahet me mjaltin e helmuar. Ata që lakmojnë mjaltin dhe nuk mendojnë për helmin që ka brenda, japin jetën e tyre vetëm për një të shijuar të çastit të mjaltit. Sa domethë-

nëse është gjendja e mizave që japin jetën e tyre kur mbesin brenda në mjaltë apo pekmez dhe nuk arrijnë të dalin më prej aty.

Nëse arsyeja është para ambicies, atëherë nuk bihet në kurthe. Rruga më e sigurt është të shikosh fundin e punës, prapaskenën dhe të hedhësh hapat sipas saj, duke mos neglizhuar vëmendjen. Të flijosh lumturinë e vërtetë për një kënaqësi të çastit, nuk është punë e të zgjuarit. Në vend të kënaqësive që nuk janë të qëndrueshme, të jesh pas veprave dhe synimeve që janë të vazhdueshme, begatia e të cilave vazhdon deri në pafundësi, që nuk kthehen në dhimbje, bëjnë që jeta të bëhet më me vlerë dhe më me kuptim.

Mevlana ka thënë: *“Dëshirat e këqija janë si qentë që flenë. Po u gjuajtën me ndonjë gur, hidhen menjëherë. Në këtë trup flejnë me qindra qen.”* Nëse këta qen nuk lidhen me litarin e mendjes dhe imanit, nuk mund të zaptohen. Sulmojnë edhe të zotin, edhe të tjerët.

Lum ata që kontrollojnë epshet dhe dëshirat e tyre të këqija; ata janë njerëz vërtetë të lirë. Sa e trishtueshme është për ata që duken si pronarë, por që në fakt janë skllavë të dëshirave të tyre të përkohshme. Pikërisht ata janë skllavë të vërtetë! Skllavi është i lidhur me zinxhirë, lufton për liri, përpiqet të shpëtojë sa më parë nga robëria e tij, por ata që janë skllavë të dëshirave të tyre, luftojnë që të vazhdojnë robërinë në atë mënyrë. Nuk e kuptojnë se janë të lidhur me zinxhirët e epshit të tyre.

Qenia e vetme para së cilës njeriu duhet të përulet, është Allahu. Ata që nuk bëhen rob të Krijuesit, bëhen skllavë të krijesave.

Sa bukur e ka thënë Mevlana: *“U bëfsha shërbëtor i atij që nuk ia shet veten askujt tjetër përveç Allahut, i Cili është i zoti i bujarisë.”* T'u bëhesh shërbëtor njerëzve të tillë, do të thotë të bëhesh rob e shërbëtor i Allahut. **“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga be-**

simtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit... (Teube, 111)

Të gjitha tregtitë që nuk të bëjnë myshteri të Allahut dhe çmimi i të cilave nuk është xheneti, janë të dëmshme. Ai që nuk fiton xhenetin, ka humbur gjithçka. Të fitosh pëlqimin e Allahut, padyshim që është më e vyer sesa të fitosh xhenetin, por sidoqoftë, edhe çmimi i këtij pëlqimi është xheneti. Ata që nuk mendojnë këtë fitesë përfundimtare, humbasin shpërblimet e qëndrueshme, duke u vënë syrin përfitimeve të përkohshme. Për fitime të mëdha dhe të qëndrueshme, duhet të mbash qëndrim ndaj joshjes së haramëve dhe të tregohet durim dhe maturi. Nëse tregon dobësi, sikurse miu që lakmon djathin apo zogu që i ka vënë syrin grurit, mbetesh pa djathë, pa grurë, pa jetë e pa xhenet. Fundin e sa e sa lakmitarëve po e vërejmë në këtë botë!

Kemi qenë dëshmitarë të fundeve të dhimshme të atyre që tentojnë të merren me ryshfete, të atyre që boshatisin bankat, të atyre që shesin fisnikërinë dhe nderin e tyre në këmbim të një gruaje apo një posti.

Rrethi i atyre që janë hallall është aq i gjerë, sa të përballojë lehtësisht nevojat dhe dëshirat e njeriut. Të ndaluarave u referohet vetëm në raste të domosdoshme dhe ajo gjë nuk e tejkalon masën e domosdoshmërisë.

Barku i njeriut ngopet, por syri kurrë. *I skamuri do shumë gjëra, por lakmitari do gjithçka.* Skllavi i bëhet shërbëtor zotërisë së vet, kurse lakmitari bëhet skllav i gjithçkaje që kërkon të ketë. Besimtari është

robi dhe shërbëtori vetëm i Allahut. Nuk është e lejuar rukuja dhe sexhdeja ndaj askujt tjetër përveç Allahut.

Muhamed Ikbali ka thënë: *“Nëse sexhdeja që bën në namaz nuk të detyron të heqësh dorë së bëri sexhde të tjerëve, atëherë hiq dorë nga ajo sexhde.”*

H. Pejgamberit (a.s.), i ofruan para, grua dhe pushet që të hiqte dorë nga davaja e tij. Këto ishin vetëm kurthe. Mirëpo, Pejgamberi ynë i dashur (a.s.), i cili nuk kishte synim tjetër përveç kënaqësisë së Zotit, i refuzoi ato menjëherë. Sikur t’i kishte pranuar këto oferta, do të fshihej nga historia si një njeri i thjeshtë, as që do të bëhej mbreti i zemrave të njerëzve e as do të arrinte në *makam-i mahmud*.

Për të mos rënë në kurthe, duhet të kesh mend, zgjuarsi dhe një besim të fortë. Ata që nuk kanë syrin e zemrës të drejtuar nga e amëshueshmja, jetojnë të drejtuar nga kënaqësitë dhe interesat e përkohshme dhe për të pasur këto, mund të lënë mënjanë të gjitha vlerat njerëzore dhe morale. E shesin ahiretin, për të pasur dynjanë. Ata që i janë përkushtuar amëshimit, nuk bëhen robër të së përkohshmes, por i vihen pas të përhershmes.

Lutemi që Allahu i Madhëruar të na largojë nga kurthet që na rrethojnë, pasi pa qenë mbrojtja e Tij nuk mund të sigurohemi nga kurthet. As Profeti Jusuf madje, nuk ka qenë i sigurt nga nefsi dhe i ka kërkuar mbrojtje Zotit. ***“Nëse Ti nuk e largon prej meje dredhinë e tyre, unë do të prirem drejt atyre dhe do të bëhem nga ata që nuk (i) dinë (ligjet e Tua).”*** (Jusuf, 33)



A. Jasin Demirxhi

La Tahzen

Mos u dëshpëro

*Shembulli yt le të jetë
Rasulallahu (a.s.), sepse ai
është prijësi, i cili shpie në
lumturi çdokënd që i bindet.
Është udhërrëfyesi, që çon në
shpëtim dhe sukses.*

La Tahzen

Mos u dëshpëro

*Ai që i hedh sytë haramit,
në zemër mbjell veç hidhërim
dhe shqetësim. I lumtur është
ai që i frikësohet Allahut dhe i
ruan sytë prej haramit.*



E fshehta e shprehjes “La ilahe il-lallah”

Formula e Teuhidit është shprehja më e rëndësishme, e cila ndan besimin nga mohimi, njerëzit e lumtur nga të mjerët... Në të njëjtën kohë, **“La ilahe il-lallah”** është një themel, ku janë ndërtuar të gjitha punët e mira e të sinqerta. Ashtu siç është e dënuar të shkatërrohet një ndërtesë pa themel, ashtu edhe një punë, qoftë edhe shumë e rëndësishme, por që nuk është ndërtuar mbi atë themel, është e dënuar të shkatërrohet ose, siç shprehet edhe Kurani, **“hebaen mensura”**, pra të kthehet në pluhur që e merr era.

“La ilahe il-lallah”, do të thotë: **“Përveç Allahut nuk ka zot tjetër”**.

Po çfarë kuptimi tjetër ka kjo shprehje?

Të thuash **“Përveç Allahut nuk ka zot tjetër”**, do të thotë:

Një ditë, herët a vonë, drejtësia dhe e vërteta, do të vijnë në mënyrë absolute...

Do të thotë mëshirë, do të thotë falje...

“Përveç Allahut nuk ka zot tjetër”, do të thotë:

Që lotët të mos rrjedhin kot, durimi, e mira dhe e keqja të mos ngelen pa shpërblim dhe vrasja e gjynahu të mos ngelen pa dënim...

“Përveç Allahut nuk ka zot tjetër”, do të thotë:

Të eliminohen shqetësimet dhe të garantohet se e drejta do t'i jepet të zotit. Do të thotë që zemrat të arrijnë kënaqësinë, nefset (egot) qetësinë dhe shpirtërat paqen...

“Përveç Allahut nuk ka zot tjetër”, do të thotë:

Që këtë botë nuk e drejton koprraci, por Bujari, më Bujari...

Të marrë atë që ka dhënë, nuk është në natyrën e Bujarisë. Allahu Teala, i Cili na ka falur jetën, nuk na e merr atë me anë të vdekjes. Vdekja kurrë nuk është marrja e jetës që na është falur. Përkundrazi, vdekja është një falje e një jete të re e të bukur për ata që thonë ashtu siç duhet **“La ilahe il-lallah”**.

“Përveç Allahut nuk ka zot tjetër”, do të thotë:

Në gjithësi nuk ka asnjë të metë dhe në mesin e krijesave, nuk ka asgjë të kotë...

Do të thotë se në çdo gjë ka një urtësi... Do të thotë se pas çdo ndodhie ka një urtësi... Do të thotë se në çdo krijesë ka një urtësi... Do të thotë se pas çdo dhimbjeje, hidhërimi, sëmundjeje, dëshpërimi, dobësie e fuqie, ka gjithmonë një urtësi.

“Përveç Allahut nuk ka zot tjetër”, do të thotë:

Që të gjitha hidhërimet, hallet, vështirësitë, të metat dhe gabimet tona të shkrihen në mëshirën e pafundme të Rrahmanit...

“Përveç Allahut nuk ka zot tjetër”, do të thotë:

E gjithë fuqia dhe forca është në dorë të Tij... Do të thotë se njohuria e pafundme e të gjitha diturive është tek Ai... Do të thotë se të gjitha dëshirat dhe kërkesat tona janë në dorën e Tij...

“Përveç Allahut nuk ka zot tjetër”, do të thotë:

Nuk ka ikje prej Tij, përkundrazi, ikjet janë për tek Ai...

Do të thotë se Ai është vendstrehimi i të gjithë robërve...

Do të thotë se Ai është dera e vetme e lutjes dhe përgjërimit për vështirësitë, hallet dhe hidhërimet tona...

Shkurt, thënia me sinqeritet e **“La ilahe il-lallah”**, në veçanti për besimtarin, të cilit i është ngushtuar shpirti, do të thotë:

Shoqërim me Atë... Do të thotë shpëtim... Do të thotë garanci paqeje dhe lumturie në të dyja botët...



Shpallja kuranore dhe synimi i saj

Ma. Luan Ahmeti

Kurani është emri i librit dërguar profetit të fundit, Muhamedit (s.a.s.), përmes shpalljes hyjnore. Kuptimi gjuhësor i fjalës Kuran është lexoj, lexoj vazhdimisht, mësoj përmendsh. Kurse në kuptimin terminologjik, Kurani shpreh revelatën hyjnore, zbritur në gjuhën arabe Muhamedit (a.s.), i ruajtur dhe i përcjellë gjer tek ne brez pas brezi

Allahu është zotëruesi i dijes, vullnetit (irades) dhe fuqisë. Me fuqinë e Tij (xh.sh.), të pafundme bën çfarë dëshiron. Kur dëshiron të lajmërojë robërit e Tij (xh.sh.), me ndonjë urdhër, këshillë apo udhëzim, me anë të një lajmëtari qiellor (meleku), ia shpjegon të gjitha ato një të dërguari në formë njeriu (profeti). Kjo nuk është as e vështirë, as e pamundur për Krijuesin e gjithësisë.

Në lidhje me kumtimin (teblig) e vahjit, në Kuranin e shenjtë thuhet kështu:

“Atë e solli në zemrën tënde shpirti besnik (Xhib-rili), për të qenë ti prej atyre që tërheqin vërejtjen. (Të shpallëm) Me gjuhë të kulluar arabe.”¹ Pra, siç

kupohet qartë nga ajeti, Kurani është fjala e Allahut, si nga kuptimi, përmbajtja dhe forma, i cili i është zbritur Muhamedit (a.s.), përmes xhibrilit.

Shkrimi i Kuranit është urdhëruar nga vetë i Dërguari i Allahut (s.a.s.), gjatë periudhës 23- vjeçare, në të cilën zbriste në formën e ajeteve ose sureve. Profeti (s.a.s.), ua mësonte vargjet kuranore sahabëve dhe, nëse shihej e nevojshme, i korrigjonte ata. Vargjet që zbrisnin, mësoheshin menjëherë nga një numër i madh sahabësh. Për të kryer faljen e namazit, çdo myslimani i duhej të këndonte përmendsh një pjesë nga Kurani. Gjatë kohës që Profeti (s.a.s.), ishte gjallë, kishte me qindra hafizë që e kishin mësuar Kuranin të tërën përmendsh. Menjëherë pas ndërrimit jetë të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), në kohën e Ebu Bekrit (r.a), vargjet kuranore të shkruara do të mblidheshin dhe do t’u jepej forma e Kuranit, siç është sot. Kështu që, nuk u la asnjë mundësi që Kurani të harrohej apo të humbiste.

Kurani është i vetmi libër hyjnor i trashëguar si amanet i shenjtë brez pas brezi, deri në ditët e sotme, i cili zotëron një garanci të dyfishtë, shkrimi dhe mësimi

1. Shuara, 193-195

përmendsh. Një veçori të tillë në mes librave të tjerë të shenjtë nuk e ka asnjë përveç Kuranit. Pra, Kurani që kemi sot në dorë, është vazhdimi i pashkëputur i kopjes origjinale, e cila u urdhërua të shkruhej nga vetë i Dërguari i Allahut (s.a.s.). Kurse Tavrati (Torah) dhe Inxhilët (Biblat) e sotëm nuk kanë arritur ta ruajnë origjinalitetin e kopjeve të tyre të para.

Përsa i përket **"kiraat-it"** dhe **"ta'lim-it"** - dy metoda të veçanta këto për leximin e Kuranit - mund të thuhet padyshim se që nga koha e Profetit (s.a.s.) e deri sot, janë ruajtur dhe zbatuar me kujdes pa asnjë ndryshim. Çdo mësues (muallim), kur e gradon nxënësin e tij në lidhje me këndimin e Kuranit, në fillim i tregon nxënësit se çdo gjë ia ka mësuar të njëjtë, pa asnjë ndryshim, sikurse e ka marrë nga mësuesi i tij. Më pas, i tregon atij zinxhirin nga nxënësi tek mësuesi brez pas brezi, duke u kthyer mbrapa deri tek Pejgamberi (s.a.s.).

Doktori dhe shkencëtari i njohur francez Prof. Dr. Maurice Bucaille, i cili ka tërhequr vëmendje të madhe me veprën "Studime mbi librat e shenjtë hyjnorë nën dritën e përvojës shkencore moderne", tregon në librin tjetër të tij, botuar me titullin "Tevrati, Kurani dhe Shkenca" se ruajtja e Kuranit në formën origjinale ka rëndësi të madhe nga ana fetare dhe se nuk duhet të nënvlerësohet. Duhet të sqarojmë se gjatë punimeve të tij, shkrimtari ka parë epërsinë që gëzon Kurani kundrejt librave të tjerë të shenjtë dhe, duke pranuar Islamin, është bërë mysliman.

Kurani nuk mjaftohet vetëm me dhënien e njohurive dhe urdhëresave. Duke i persëritur herë pas here temat e rëndësishme, mundohet ta bindë lexuesin dhe ta bëjë atë zotërues të imanit (besimit). Kurani i shenjtë përbëhet nga 114 sure, nga të cilat më e gjata është 286 ajete, kurse më e shkurtra 3 ajete. Në lidhje me numrin e ajeteve të Kuranit, për shkak të mënyrave të ndryshme që janë përdorur në numërimin e tyre, ka mendime të ndryshme, por mendimi i përgjithshëm është se Kurani përbëhet nga 6666 ajete.

Dijetarët kanë rënë në një mendim se vargjet e para, që kanë filluar të zbresin nga Kurani i Shenjtë, janë 5 vargjet e para të sures Alak. Në ajetet kuranore dhe në hadithet e transmetuara gjejmë argumente se këto

vargje filluan të zbrisnin në pjesën e fundit të natës, pak para kohës së fexhrit (sabahut), d.m.th. në kohën e syfyrit, në muajin e Ramazanit dhe pikërisht në natën e Kadrit. Argument për këtë mund të përmendim këto dy ajete: **"Pasha natën kur ajo ja beh me errësirë, pasha agimin kur ai shkrep."** (Tekvir, 17-18.)

Këto janë 5 ajetet e para, që atë natë filluan t'i zbresin të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), në shpellën Hira:

"Lexo, me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë).

Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës).

Lexo, se Zoti yt është më bujari.

Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë.

I mësoi njeriut atë që nuk e dinte".



Sikurse shihet, shpallja e parë urdhëron që të lexohet dhe mësohet, urdhëron që njeriu të pajiset me dituri. Pajisja me dituri numërohet pot-huajse e barabartë dhe po aq e rëndësishme sa vetë krijimi i njeriut. Këtë fakt Kurani e paraqet si një domosdoshmëri e krijimit njerëzor dhe si një kusht bazë e të qenit **"insan"** (njeri).

Në të vërtetë, Kurani herë pas here përdor edhe termin **"beshër"**, por në mes të termit **"beshër"** dhe atij **"insan"** ka shumë ndryshime dhe që të dy janë përdorur për të shprehur qëllime të ndryshme. Përfundimi që del nga ajetet, të cilët flasin për këtë temë është se: beshër do të thotë një specie e veçantë, që mbart mbi vete cilësi të veçanta në mes të gjallesave të tjera. Kurse insan është gjendja e përparuar e krijesës "njeri", që lind në formën e thjeshtë humane dhe, duke mësuar, pajiset me dituri dhe fiton një përbërje kulturore. Kjo çështje sqarohet gjithashtu në ajetet 30-32, të sures Bakara, si dhe në ajetet e para të sures Rahman.

Së fundi, mund të thuhet se: **synimi kryesor i shpalljes hyjnore, e cila u ka ardhur të gjithë pejgamberëve dhe në veçanti vahji kuranor, që i ka zbritur Pejgamberit të fundit Muhamedit (s.a.s.), është ndriçimi i mendjes së njeriut me anë të dritës së shpalljes dhe t'i japë kësaj krijese formën njerëzore ashtu siç e meriton.**





SMUETORJA POPULLORE
E
PERLIMTARES

SPITALI TURK
K. MARUBI 1900 - 1912

FOTOJA E MUJAJIT



Një Ajet

*Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!*

“Dorëshpuarit janë vëllezërit e djallit, ndërsa djalli është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij.” (Isra, 27)

Jetojmë në një botë të mbushur me kontradikta. Në njërin kontinent njerëzit derdhen lot nga vuajtjet dhe mundimet, kurse në kontinentin tjetër argëtohen në mënyrë të shfrenuar. Në njërin anë njerëzit vdesin nga uria dhe varfëria, kurse në anën tjetër shpenzojnë dhe konsumojnë në mënyrë të shfrenuar.

Sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Ushqimit, në botë vdesin afërsisht 10 milion njerëz nga uria dhe nga ushqimi i pamjaftueshëm, kurse 1 miliard të tjerë jetojnë nën rrezikun e vazhdueshëm të urisë. Megjithë këtë gjendje, vitin që kaloi u hodhën në plehra 1 miliard e 300 milion ton ushqime. 40% e ushqimeve të hedhura janë të përdorshme. Sëmundja e shpenzimit të shfrenuar nuk është një dukuri vetëm e vendeve perëndimore, por ka prekur në masë edhe vendet myslimane. Myslimanët janë bërë të pandjeshëm përballë konsumimit pa kriter dhe hedhjes në plehra të ushqimit, i cili është akoma në gjendje për t'u përdorur. Kur situata vlerësohet sipas kriterëve islame, nuk mund të gjendet paradoks më i madh. Si mund të harrohen kaq lehtë urdhëresat hyjnore, që e ndalojnë shpenzimin e tepërt.

Botëkuptimi modern ka bërë të mundur që ta harrojmë cilësimin e ushqimit si mirësi, duke hapur rrugën për ta perceptuar atë si send i rëndomtë. Deri pak kohë më parë, një gjysmë buke perceptohej si një mirësi që mund të ushqejë një njeri. Shkelja e thërmijave të bukës vlerësohej njëllë si shkelja e fletëve të Kuranit. Kjo ndodhte, sepse të parët tanë e dinin shumë mirë hadithin: “Nëse dikujt i bie buka në tokë, le ta marrë, ta fshijë dhe ta hajë. Të mos ia lërë atë shejtanit.” (Muslim, Eshribe, 136)

Vlerësimi që i kanë bërë gjyshërit tanë ushqimit, sot e ka humbur vlerën. Nuk është nevoja të shkohet shumë larg. Gjyshërit dhe baballarët tanë e dinë shumë mirë çfarë është varfëria dhe uria. Ata kanë përvoja shumë të hidhura në këtë aspekt. Atëherë, si është e mundur që të harrohen ato sikur të mos kishin ndodhur asnjëherë. Sikur ne nuk jemi nipërit e atyre që e kanë përjetuar atë uri dhe varfëri. Ne sillemi sikur ajo që u ka ndodhur gjyshërve tanë, nuk ka për të ndodhur kurrë më.

Ne e ndiejmë veten shumë të sigurt nga varfëria, uria dhe kriza që ka prekur shumë vende të botës. Jemi bërë të pandjeshëm ndaj dramës që kanë përjetuar gjyshërit tanë dhe për dramën që po përjetojnë shumë vende të botës sot. Ndërsa gjyshërit tanë u sprovuan me varfëri, ne po sprovohemi me pasuri.

Konsumi sot është kthyer në modë. Përmes reklamave shumë tërheqëse, shumë artikuj jo të domosdoshëm po na paraqiten si artikuj jetësorë. Po përjetohet një konkurrencë e madhe në blerjen e modelit të fundit të makinës, telefonit etj.

Fatkeqësisht edhe myslimanët janë bërë klientë të këtij modeli ekonomik. Rritja e shpenzimeve të panevojshme dhe hedhja në plehra e ushqimeve, tregon gjendjen e sëmurë shpirtërore të myslimanëve.

Duket qartë që, përkundrejt ajeteve dhe haditheve, ne nuk e kemi marrë aspak seriozisht situatën. Kjo është një çështje shumë e rëndësishme, sepse ka lidhje direkte me dashurinë e Allahut. Në lidhje me këtë, Kurani shprehet qartë se njerëzit që shpenzojnë, do të jenë të privuar nga dashuria e Allahut. Ky është një qortim i rëndë për një besimtar që ka për qëllim fitimin e dashurisë së Krijuesit. Megjithë vërejtjet e ajeteve, nëse një besimtar nuk përpiket të ndalojë nga shpenzimet e tepërta, atëherë kjo është mungesë respekti ndaj Allahut.

Ajeti i mësipërm e shpreh qartë faktin se ata që zhyten në shpenzime të panevojshme janë vëllezërit e djallit. Ajeti i mësipërm është shumë domethënës për të kuptuar sa vepër e keqe dhe e shëmtuar është tek Allahu shpenzimi, sepse midis atij që shpenzon dhe djallit krijohet një afritet. Madje, këta të dy konsiderohen si vëllezërit, kur dihet që shejtani është simbol i mëkatit dhe mosbindjes, është shembull i së keqes. Për të shprehur gradën e lartë të së keqes, arabët krijojnë lidhje me djallin. Për rrjedhojë, shpenzimi i tepërt, është në një kuptim luajtja e rolit të shejtanit.

Në fund të ajetit shejtani cilësohet si mosmirënjohës. Edhe shpenzuesi konsiderohet mosmirënjohës ndaj mirësive të Allahut, duke i shpërdoruar ato pa kriter. Shpenzuesi tregohet mosmirënjohës, jo vetëm karshi Allahut, por tregohet i papërgjegjshëm ndaj natyrës dhe brezave të ardhshëm. Myslimanit i ka hije të sillet ndaj shpenzimeve ashtu siç e përkufizon Allahu në Kuran: **“Kur shpenzojnë, ata (myslimanët) nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen së mesmes.”** (El-Furkan, 67)

Një Hadith

*Transmetohet nga Ebu Hurejra (r.a.)
se Resulullahi (s.a.v.s.) është lutur:*



“O Zot! Më mundëso të përfitoj dobi nga mësimet e Tua. O Zot, më mëso dituri dobiprurëse dhe më shto diturinë!” (Tirmidhiu, Deauat, 129)

Një nga veçoritë, që e dallon njeriun nga qeniet e tjera, është edhe aftësia për të mësuar, ndërtuar dhe organizuar jetën sipas mësimave të përftuara. Të mësuarit është një proces mendor. Allahu në Kuran i jep një rëndësi të veçantë diturisë dhe mësimi të saj, duke e shprehur qartë epërsinë e dijetarëve ndaj njerëzve të tjerë. **“A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?!”** (Zumer, 9) **“Allahut i frikësohen vetëm dijetarët...”** (El-Fatir, 28) Allahu përsëri duke urdhëruar: **“Pyetini dijetarët për atë që nuk dini.”** (Nahl, 43), i nxit besimtarët të këshillohen me ekspertët dhe profesionistët e çështjes. Dituria është mjeti më i rëndësishëm për të arritur tek e drejta dhe e vërteta. Prandaj Allahu urdhëron: **“Mos shko pas diçkaje, për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjitha këto do të merren në përgjegjësi.”** (Isra, 36)

Dituria është tërësia sistematike e njohurive të fituara nga njeriu, në lidhje me qenien e tij dhe me ekzistencën në përgjithësi. Burimi i këtyre njohurive është mendja, shqisat dhe zbulesa hyjnore. Ne arrijmë në një nivel më të lartë, përmes njohurive të fituara nga bashkëpunimi i arsyes dhe shqisave. Arrijmë në një sërë konkluzionesh mbi qenien, përmes procesit të të menduarit, gjykitimit dhe krahasimit. Kjo ka qenë forma kryesore e fitimit të diturisë gjatë gjithë historisë së njerëzimit. Përveç këtyre njohurive të fituara, të mësuara ekziston edhe një lloj tjetër i njohurive me burim hyjnor, të cilat arrijnë tek ne përmes profetëve. Ne nuk kemi mundësi të testojmë apo vërtetojmë saktësinë ose vërtetësinë e këtyre njohurive. Prandaj, këto njohuri janë pjesë e besimit. Në këtë rast, besimtarit i takon besimi në këto njohuri dhe përpjekja për të kuptuar urtësinë e tyre. Islami i shikon të dy burimet e diturisë si rrugë për të njohur Krijuesin.

Hadithi i mësipërm nxjerr në pah rëndësinë e qëllimit në mësimin e diturisë. Profeti ynë i dashur i kërkon Allahut në këtë lutje dituri dobiprurëse dhe shtim të saj. Lutja për shtimin e diturisë urdhërohet qartë në Kuran. Përsëri Pejgamberi (a.s.), na informon se dijetari që lë trashëgimi dituri të dobishme, vazhdon të fitojë shpërblim edhe pas vdekjes. Dituri e dobishme është dituria që e çon njeriun në njohjen e vetvetes, në njohjen e shkakut dhe qëllimit të ekzistencës dhe në fund, në njohjen e Krijuesit të gjithësisë. Kjo lloj diturie i siguron në të njëjtën kohë dobi shpirtërore dhe materiale, së pari njeriut, shoqërisë mjedisit dhe së fundi, gjithë krijesave. Këtu nuk ka rëndësi fusha e shkencës, rëndësi paraqet qëllimi i fitimit të njohurive. Sipas hadithit, e rëndësishme është çfarë dobie dhe kontributi i sjell dituria personit dhe njerëzimit në tërësi. Allahu i qorton ata që këshillojnë të tjerët për mirë, por nuk veprojnë vetë sipas asaj që këshillojnë. Personi që këshillon dhe inkurajon të tjerët për mirë, por harron veten, është krahasuar me pishtarin, i cili ndriçon të tjerët, por djeg veten. Përsëri Pejgamberi (a.s.), i dënon ata që përpiqen të fitojnë dituri vetëm për të përfituar nga të mirat e kësaj bote. Sa bukur e shpjegon poeti i famshëm Junus Emre qëllimin e diturisë: “Dituria është të dish, është të kuptosh veten. Nëse ti nuk kupton dot veten, ç’të duhet leximi? Leximi ka kuptim kur njeriu njeh Krijuesin e vet, nëse leximi nuk ka kuptim, mbetet punë e kotë.” Pra, është shumë e rëndësishme që njeriu të njohë veten dhe Krijuesin. Ai që pretendon se ka dituri pa njohur më parë veten dhe Zotin, bie në nivelin e kafshës, e cila mban në shpinë barrën e librave.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Nxitja për kërkimin e diturisë së dobishme.
2. Nxitja për shtimin e diturisë.
3. Lutja vazhdimisht Allahut për shtimin e diturisë.
4. Kuptimi dhe nxjerrja e urtësive nga njohuritë.



Një djalosh, shembull për të gjitha kohërat:

MUHAMMEDUL - EMIN

(sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem)

NEVOJA E NJERIUT PËR TË MARRË SHEMBULL

Në çdo fazë të jetës njeriu ndjen nevojën e një udhërrëfyesi, që mund ta udhëheqë, ndjen nevojën e një shembulli, që mund ta marrë si model. Njeriu e mëson fenë, gjuhën, sjelljet dhe zakonet që përbëjnë personalitetin e tij, përmes njerëzve udhërrëfyes dhe shëmbëlltyrave që ka zgjedhur t'u referohet.

Fjala vjen, një fëmijë mëson atë gjuhë që flet e ëma. Shumë sjellje dhe lëvizje i mëson duke imituar prindërit. Me kalimin e viteve, me zhvillimin e perceptimit dhe aftësive, merr mësim të ndryshme nga shumë njerëz.

Edukimi dhe arsimimi i njeriut përbëhet nga imitimi që u bën shembujve pozitivë apo negativë, nëpërmjet aftësisë së imitimit, që gjendet në natyrën njerëzore. Ndaj dhe veçoritë e atyreve që ka zgjedhur njeriu si shembuj për vete, janë shumë të rëndësishme.

Udhërrëfyesit e vërtetë të njerëzimit janë profetët. Për ata që nuk kanë arritur profetët, dijetarët, *arifët* dhe *evlija-të*, si trashëgimtarët e Profetit, të cilët ndjekin në mënyrën më të bukur të mundshme profetët, janë shëmbëlltyrat që kanë përhapur në kohë modelin e udhëzimit profetik dhe sjelljen ideale. Të kesh ata udhëheqës, krijohen kushtet për lumturinë dhe shpëtimin e përhershëm.

Ndërsa, ata që lënë mënjane pejgamberët dhe miqtë e Zotit dhe zgjedhin të tjerë si udhëheqës, nuk do të shpëtojnë pa u përballur me shkujdesjen, devijimin dhe kryengritjen, pasi jeta e atyre që ndjekin udhëtarët e rrugës së gabuar dhe dëshirave të nefsit, përfundon me një falimentim shkatërrues.

A nuk është një nga problemet më të mëdha për nje-

riun e sotëm pikërisht kjo gjë? Duke marrë si shembull disa të famshëm, që bëjnë një jetë të mjerë shpirtërore, të rinjtë tanë hedhin në rrezik lumturinë e përhershme. Sa në zhgënjim të keq që janë!

Mevlana –kuddise sir-ruhu-, çudinë se si njeriu zgjedh modelet e gabuara, e shpreh me këtë shembull:

"Nuk ka gjë për t'u habitur nga ikja e qengjit prej ujkut. Ujku është armiku i qengjit. Ajo që është për t'u habitur, është dashuria e qengjit ndaj ujkut dhe vajtja pas tij."

Shoqëria njerëzore thuhet se ngjan me një pyll, që mban në vete kafshë të ndryshme, nga ato më të butat, gjer tek ato më të egrat. Njerëzit aty janë ose dinakë si dhelpra, ose grabitqarë si hijena, ose ambiciozë si milingona, e cila mbledh ushqimin e vet, ose helmues si gjarpri. Njeri të pickon duke të ledhatuar, tjetri të pi gjakun si shushunjë dhe tjetri përballë të qesh e mbrapa të bën gropën.

Sa humbje e madhe është për ata të rinj, që ndjekin nga pas ata njerëz grabitqarë dhe asgjësues të shoqërisë, me natyrë ujku dhe jo udhëzues, që kanë një zemër të butë, të ëmbël dhe të dashur!

Shembulli më i përsosur, që mund të përmbushë me meritë nevojën dhe prirjen për imitim të njeriut, është padyshim Muhamedi (s.a.s.). Suksesi që vjen kur marrim shembull Hazreti Muhamedin (s.a.s.), pa dyshim është i lidhur me dashurinë e vërtetë që kemi për të, duke u lidhur shpirtërisht me personalitetin e tij të pashembullt.

SHEMBULLI I VETËM, LIDERI I VETËM, HZ. MUHAMEDI (A.S.)


Njeriu i vetëm në botë, të cilit i është analizuar e gjithë jeta deri në detajet më të vogla, është Hz. Muhamed

Mustafai (a.s.). Thuajse të gjitha veprat, fjalët dhe ndjenjat e tij janë regjistruar dhe transmetuar në histori. Mund të thuhet që të gjitha veprat islame, që janë shkruar që prej 1400 viteve, janë shkruar për të shpjeguar një libër dhe një njeri- Kuranin Famëlartë dhe Hz. Pejgamerin (a.s.).

Allahu i Madhëruar e ka krijuar Pejgamberin e dashur (a.s.), si një mrekulli arti, që manifestohet tek njeriu. Atë e ka bërë mëshirë për mbarë botën dhe model për t'u marrë shembull nga e gjithë njerëzia. Në këtë këndvështrim, jeta e të Dërguarit të Allahut do të jetë shembull i pashoq për të gjithë brezat që do të vijnë deri në Kijamet.

Jeta e Pejgamberit tonë të dashur (s.a.s.), është si një pasqyrë e pastër dhe e dëlirë. Është detyrë e çdo myslimani që, duke parë veten në këtë pasqyrë, të zbukurojë sjelljen dhe të rregullojë shtrembërimet e tij.

Allahu i Madhëruar ia ka filluar jetën Pejgamberit tonë të dashur (a.s.), nga shtresa më e ulët e shoqërisë, në kuptimin e pamundësive, nga "fëmijëria prej jetimi". Pastaj e kaloi atë në të gjitha shkallët dhe, në kuptimin e fuqisë dhe pushtetit, e ngjiti në pikën më të lartë dhe e bëri të Dërguar të Tij dhe lider. Ndaj dhe në çfarëdolloj shkalle sociale qoftë një njeri, tek jeta e Profetit (a.s.), mund të gjejë shembuj të përkryer për veten e vet.



*Shembulli më i përsosur,
që mund të përmbushë me meritë
nevojën dhe prirjen për imitim të njeriut,
është padyshim Muhamedi (a.s.).
Suksesi që ujen kur marrim shembull
Hazreti Muhamedin (a.s.),
pa dyshim është i lidhur me dashurinë
e vërtetë që kemi për të, duke u lidhur
shpirtërisht me personalitetin e tij
të pashembullt.*

Në një ajet kuranor, Allahu i Madhëruar thotë:

“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”
(Ahزاب, 21)

I Dërguari i Allahut (a.s.), është shembull si jetimi i Abdullahut dhe Amines për të pafuqishmit dhe jetimët.

Një djalosh i rritur, duke analizuar rininë e pastër të Profetit (a.s.), mund të përpilojë hartën e duhur të jetës së vet.

Një tregtar, që bën kujdes për fitimin hallall, mund të marrë për shembull jetën tregtare që bënte ai personalitet fisnik me karvan në rrugën nga Siria në Busra.

Një besimtar, që dëshiron të formojë një vatër të përshtirshme, mund të marrë shembull familjen e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe kështu arrin në lumturinë e të dy botëve.

Prania e Pejgamberit tonë të dashur (a.s.), tek Xhebraili, i cili i solli shpalljen hyjnore, është shembulli më i mirë për nxënësit. Mësimi që u bënte sahabëve, është shembull për mësuesit.

Për një njeri ideal, që përpiket të përmbushë kauzën e vet, për të kumtuar të vërtetën, jeta në Mekë e Pejgamberit tonë (a.s.), ka plot mësim.

Uhudi është shembull për ata që humbasin, kurse

triumfi i Mekës është për ata që fitojnë.

Nëse njeriu shpëton pa u bërë rob i materies dhe dëshiron të bëjë një jetë shpirtërore, duhet të kujdeset për Bilalët, Jasirët dhe Thevbanët. Duke qenë shpirtërisht bashkë me ata sahabë besnikë, duhet t'i dhurojmë delikatesë, finesë dhe butësi zemrës sonë.

Për katërmbëdhjetë shekuj me radhë, Resulullahu (a.s.), ishte trëndafili që nuk vyshkej në zemrat e ymetit. Myslimanët e kanë bërë të gjallë gjithnjë me emrat e tyre, me artin dhe shkencën. Ata kishin kuptuar se Islami kuptohet kur jeta e tij merret shembull në çdo aspekt dhe kështu kishin gjetur lumturinë e vërtetë.

Kumtuesit e Islamit, të cilët kanë provuar shijen e tij shpirtërore, kanë mësuar nga Resulullahu (a.s.), **“të bëhen shkak për udhëzimin e tjetrit”**; fakihët mësuan **“nxjerrjen e gjykimeve nga Kurani dhe hadithet”**; mufessirët **“kuptimin e Kuranit”**, mutasavvufët **“edukimin me edukatën hyjnore”**, mendimtarët **“të vërtetën e gjësë”**, poetët **“vëmendjen ndaj argumenteve verbale dhe joverbale të qenies”** dhe muzikantët **“tingujt e estetikës”**.

Myslimanët kanë gjetur tek njeriu përkryerjen e gjithësisë dhe tek Resulullahu (a.s.), përkryerjen e njeriut. Ata kanë kërkuar të vërtetën tek Pejgamberi (a.s.) dhe përmes tij i janë qasur enigmës së krijimit.

Këtë nuk duhet ta harrojmë kurrë: njerëzit më të errët të Periudhës së Injorancës, duke gjurmuar të Dërguarin e Allahut (a.s.), u bënë personalitete yje, që udhëhoqën njerëzimin. Atëherë edhe ne, në rrugëtimin e jetës sonë, le të pranojmë si udhërrëfyes Pejgamberin (a.s.) dhe njerëzit e veçantë që e ndjekin atë, që të meritojmë lumturinë e përgjeshme.

ÇFARË RINIE JETOI RESULLAHU (A.S.)?

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) edhe në vitet e rinisë ka qëndruar larg të këqijave të Periudhës së Injorancës. Edhe para se të ishte Pejgamber, ai ishte njeriu më i ndershëm i shoqërisë, nga aspekti i personalitetit dhe humanizmit, kurse nga aspekti i edukatës ishte më i miri. Aq sa, për arsye se Allahu i kishte mbledhur tek ai të gjitha vetitë

dhe virtytet më të bukura njerëzore, ai kishte merituar epitetin **“el-Emin”** (i besueshmi).¹ **“Emin”** tashmë ishte bërë emri i dytë i tij, madje kishte kaluar edhe emrin e vërtetë të tij.

Një ditë Resulullahu (a.s.), u pyet:

- O Resulullah! A i keni bërë ndonjëherë adhurim dikujt tjetër përveç Allahut?

- Jo –tha ai.

- A keni pirë ndonjëherë alkool? –e pyetën.

- Jo! Edhe kur nuk e dija se ç'është imani dhe Kurani, e dija se ajo çfarë bënin ata ishte e ndaluar. (Dijarbekri, I, 254 - 255)

Ummu Ejmeni (r.a.) e shpjegoi kështu:

Mushrikët kurejshitë mbledheshin një herë në vit përreth idhullit Buvane dhe bënin një ceremoni, që zgjas-

te deri në darkë, duke prerë kurbanë, duke prerë flokët dhe hynin në itikaf. Edhe Ebu Talibi ishte përgatitur për këtë festë. Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), tregoi se nuk do të merrte pjesë, u mërzitën xhaxhallarët dhe hallat e tij.

- Kemi frikë se mos do të kapë ndonjë e keqe, me këtë neglizhencë që tregon ndaj perëndive tona.” -i thanë hallat dhe këmbëngulën aq shumë, saqë Pejgamberi ynë (s.a.s.), u detyrua të shkonte bashkë me ta.

Ndërkohë, kishte humbur nga sytë e të gjithëve. Pastaj, me një fytyrë të zverdhur nga frika, erdhi sërish pranë nesh.

- Çfarë ndodhi? – e pyetën me kureshtje hallat e tij.

- Kam frikë se mos u takova me xhinët – tha ai.

- Zoti nuk e bën të mundur që shejtani të të takojë ty! Ti ke çdo veti të bukur. Pa na thuaj, vërtet ç'ndodhi? – i thanë.

Atëherë Resulullahu (a.s.), u tha:

- Sa më shumë që i afrohesha idhullit, një burrë i gjatë, i veshur me të bardha më shfaqej dhe më thoshte: “O Muhammed! Kthehu, mos e prek atë!”

Pas kësaj, nuk mori më pjesë në festat dhe ceremonitë e tyre, megjithëse akoma nuk i ishte dhënë Nuri i Qenies,

1. Ibn Hisham, I, 191; Ibn Sa'd, I, 121.



misioni profetik. (Ibn Sa'd, I, 158)

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), kaloi një rini mjaft të pastër dhe të ndershme. Allahu i Madhëruar e ruajti atë nga imoraliteti dhe amoraliteti.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë kështu:

“Unë kam tentuar dy herë të bëj një zakon të njerëzve të Periudhës së Injorancës. Mirëpo, Allahu i Madhëruar më ruajti që të mos i bëj.”

Një natë, në zonën mbi Mekë po kullosnim kopetë e dhenve me disa të rinj kurejshitë. Shokut tim i thashë:

- Nëse do kujdeseshe për kopenë time, do të shkoja të merrja pjesë në kuvendet e të rinjve mekas.

- Patjetër, ashtu bëj – më tha.

Pas kësaj, u nisa të shkoja. Kur iu afrova Mekës, fillova të dëgjoja zëra të defit, kavallit dhe të fishkëllimave.

- Ç'është kjo? – pyeta.

- Filan burrë po martohet me filan grua, – më thanë.

Menjëherë u ula dhe nisa të shikoj nga ajo anë. Ndërkohë, Allahu i Madhëruar më dha një gjumë, sa fjeta menjëherë. Ju betohem në Allah, që derisa lindi dielli, nuk u zgjova më. Menjëherë u ktheva dhe shkova tek shoku im.

- Çfarë bëre? – më pyeti.

- Asgjë nuk bëra. – i thashë dhe i tregova se ç'më ngjau.

Një natë tjetër, u përsërit e njëjta gjë dhe unë sërish mbeta në gjumë... Derisa Allahu më nderoi me profetësi. Përveç këtyre, nuk kam tentuar asnjëherë për ndonjë të keqe tjetër!” (Ibni Is'hak, fq. 58 – 59; Ibni Kethir, el-Bidaje, II, 292)

Që kur ishte dymbëdhjetë vjeç kishte filluar jetën tregtare me xhaxhallarët e vet.² Pastaj, për arsye të simpatisë që kishte ndaj karakterit të Pejgamberit (s.a.s.), si besnik, Hz. Hatixheja i ofroi atij të administronte karvanët e saj. Resulullahu (s.a.s.), ishte njeriu më i besueshëm, bënte një punë të mirë dhe fitonte më shumë.³

Pejgamberi i dashur, me disa njerëz ka bërë edhe ortakëri. Një nga tregtarët e Mekës, **Saib bin Ebis-Saib** (r.a.), thotë kështu:

“Shkova pranë të Dërguarit të Allahut. Sahabët nisën të më lëvdonin dhe të thoshin fjalë të mira për mua. Re-

sulullahu (s.a.s.), tha:

- Unë e njoh atë më mirë sesa e njihni ju.

Ndërkohë, ndërhyra unë dhe u thashë:

- Është e vërtetë, të qofshin falë nëna dhe babai im! Ti ishe ortak i mirë që ishe! As më kundërshtojë e as polemizojë me mua! (Ebu Davud, Edeb, 17/4836; Ibni Maxhe, Tixharat, 63)

Abdullah bin Ebil-Hamsa (r.a.), e shpjegon në këtë mënyrë:

“Bëra një shitblerje me Rasulullahun (s.a.s.), para se ai të ishte profet. I mbeta borxh dhe u shkëputa prej tij duke i premtuar se, nëse do të më priste pak, do t'ia sillja. Mirëpo, kisha harruar se i kisha dhënë fjalën. Kur u kujtova, kishin kaluar tri ditë. Shkova te vendi ku i kisha dhënë fjalën dhe e gjeta aty. As që ma përmendi gabimin që kisha bërë. Vetëm se më tha:

- O djalosh! Më lodhe pak, kam tri ditë që të pres këtu. (Ebu Davud, Edeb, 82/4996)

Resulullahu (s.a.s.), që i ri gjendej gjithnjë pranë të papërkrahurve dhe nevojtarëve. Një ditë kishte ndihmuar një tregtar të shkretë, që kishte ardhur gjer në Mekë, i cili kishte shitur mallrat, por që nuk e kishte marrë shpërbimin. Bashkë me xhaxhallarët e vet, ai mblodhi kuvendin **Hilful-Fudul**. Ky kuvend u bë gjatë tërë jetës së tij strehë për të shtypurit.⁴ I Dërguari i Allahut (s.a.s.), për këtë kuvend ka thënë:

“Në shtëpinë e Abdullah bin Xhud'an-it, bashkë me xhaxhallarët e mi, isha edhe unë në Hilful-Fudul. U gëzova aq shumë nga ai kuvend, sa edhe sikur t'më jepnin devetë e kuqërremta (d.m.th., pasuritë më të mëdha të botës) në vend të atij kuvendi, nuk do gëzohesha aq shumë. Në një marrëveshje të tillë, sikur edhe tani të më ftonin, do të merrja pjesë.” (Ibni Kethir, el-Bidaje, II, 295)

Pejgamberi ynë i dashur (s.a.s.), sillej me kujdes dhe me edukatë ndaj familjes së vet, të afërmve dhe ndaj njerëzve të tjerë. Gjithmonë vepronte me mençuri dhe zgjuarsia.

Rasulullahut (a.s.), kur ishte i ri i pëlqente të reflektonte mbi gjithësinë dhe ngjarjet e ndryshme dhe të bënte meditime të thella. Për këtë, ai qëndronte i vetëm dhe thellohej në mendime.

Përfundimisht, ai (a.s.), e ka jetuar mirë rininë e tij dhe këtë etapë të vyer e ka kaluar me të mira dhe të mbara.

2. Ibn Ishak, Siret, fq. 53.; Ebu Nuajm, Delail, I, 168.; Dijarbakri, Tarihu-Hamis, I, 260.

3. Hakim, III, 200/4834; Halebi, Insanul-Ujun, I, 221, Ajni, Umde, X, 104; Dija - bekri, I, 262.

4. Ibni Kethir, el-Bidaje, II, 295 – 296; Ibni Sa'd, I, 128 – 129.



“PROBLEME NË RRUGËN E JETËS ISLAME”,

një libër me vlerë
në duart e rinisë islame...

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Nuk ka dyshim se kushdo që e ka lexuar qoftë edhe një vepër të vetme nga Shejkh Muhammed El-Gazali, kupton se ka të bëjë me një njeri të ditur, me një dhunti të mrekullueshme në shkrimin e fjalës, thellësisht i angazhuar me problemet e Thirrjes islame dhe zhvillimin e ecurisë së individit dhe shoqërive islame kudo në botë.

Gjatë viteve të fundit të shekullit të kaluar, ai konsiderohej pa dyshim si një ndër korifejtë e Thirrjes islame në botë dhe si i tillë, ai mbeti një edukues i heshtur i rinisë islame, nëpërmjet rreshtave të pafund të librave të tij të shumtë... S'ka dyshim se me dijen, karizmën dhe veçoritë e tij të spikatura në Thirrjen islame, ai u bë frymzues për shumë dijetarë të botës islame, për studentët e teologjisë dhe intelektualët myslimanë në botë.

Librin “Probleme në rrugën e jetës islame” e kam lexuar me shumë dëshirë dhe kënaqësi. Kam ndjerë sikur Imam Gazaliu iri ishte aty pranë meje. Ai më fliste, unë e dëgjoja me vëmendje dhe herë-herë mbaja shënim fjalët e tij të urta dhe udhëzimet prej edukatori plot eksperiencë jete.

Përse ky libër dhe librat e Shejkh Muhamed Gazaliut në përgjithësi janë të vlefshëm për rininë e sotme islame, sidomos në rrugën e zgjimit dhe riperceptimit të rolit që duhet të ketë secili në shoqërinë e tij? Përgjigjja është e thjeshtë. Më lejoni që atë ta jap nëpërmjet ndalimit në disa stacione të marra nga librat e tij të shumtë në krahasim me “Probleme në rrugën e jetës islame”.

SAKTËSIMI I MARRËDHËNIES SË DREJTË ME ZOTIN

Në tërësinë e librave dhe thirrjes së tij, Shejkh Gazali

është përpjekur të edukojë individin mysliman me një akide të shëndoshë, nëpërmjet së cilës të jetë i vetëdijshëm për besimin e tij në Zot të Vetëm. Karakteristikë e shkrimeve të tij është përdorimi i shembujve logjikë dhe atyre personale nga jeta dhe eksperiencë, për të mundësuar mbërritjen e idesë tek lexuesi a bashkëbiseduesi.

Në librin e tij: “Akidetul-myslim”, shkruan se: “Allahu e ka përshkruar Veten e Tij me cilësi të shumta, të cilat është e vështirë të perceptohen në vërtetësinë e tyre sipas mënyrës si ne perceptojmë çështjet tona të zakonshme... Milingona nuk arrin ta kuptojë vërtetësinë e njeriut, pasi kufijtë e botës në të cilën jeton e pengojnë ta arrijë”.¹ Ndërkohë, në librin “Probleme në rrugën e jetës islame”, autori tërheq vëmendjen e lexuesit se: “Mbajtja e fesë së Zotit do të thotë, para së gjithash, themelimi i lidhjeve të pastra mes robit dhe Zotit të tij, larg nga kërkimi i kësaj bote, nga ngopja me dëfrimet dhe nga mbizotërimi i dëshirave të saj”.² Pra, fillimisht ai kërkon nga myslimani të njihet Zoti me gjithë cilësitë e Tij, pastaj të gjendet një rrugë legjitime dhe e shëndoshë për krijimin e një marrëdhënieje solide me Zotin e gjithësisë. Saktësia e kësaj marrëdhënieje është ajo që shenjon më pas edhe saktësinë e udhëzimit të njeriut në rrugën e fesë së tij dhe besimit që ka në zemër.

Në librin e njohur: “Kejfe nefhemul-Islam”, ai kërkon nga myslimanët që: “të zgjohen për të shpëtuar origjinën e besimit dhe gjallërimin e zemrave të vdekura me akiden e saktë, siç ka ardhur në Kuran dhe në Traditën profetike”.³

1. Muhammed El-Gazali, “Akidetul-myslim”, botimi VIII, Damask, 1996, fq. 35.

2. Muhamed El-Gazali, “Probleme në rrugën e jetës islame”, Tiranë, 2012, fq. 14.

3. Muhammed El-Gazali, “Kejfe nefhemul-Islam”, botimi I, Damask, 2000, fq.

ADHURIM DHE DIJE

Në librin e tij: "Hadha dinuna", Shejkh Muhammed El-Gazali shkruan për një titull shumë intrigues dhe me rëndësi për jetën e të riut mysliman: "Liria e mendjes, jo liria e epshit". Aty, ai argumenton domosdoshmërinë e angazhimit të individit mysliman për mirëpërdorimin e mendjes dhe shfrytëzimin e kohës për të arritur suksese në jetë, secili në fushën a specializimin e tij. Shkruan: "Allahu i ka urdhëruar krijesat e Tij të meditojnë në krijimet e Tij dhe ta lëshojnë fijen e mendimit aty e këtu për të medituar rreth argumenteve në univers, si dhe për t'u thelluar në mes të urtësisë së lartë në rreshtat e ajeteve si: "Le të vëzhgojë njeriu se nga është krijuar" – Tarik, 5, ose: "Thuaj: Vëzhgoni se çfarë ka në qiej e në tokë"- Junus, 100..."⁴

Ndërkohë, në lidhje me këtë temë shumë të rëndësishme, në librin "Probleme në rrugën e jetës islame", autori shkruan: "Është e pamundur ngritja e një shoqërie, në qoftë se pjesëtarët e saj janë injorantë ndaj kësaj bote, të pafuqishëm në jetë. Punët e mira kërkohet t'i bëjë sëpata e druvarit, gjilpëra e rrobaqepësit, lapsi i shkrimtarit, ekspertiza e doktorit, provëza e farmacistit. I bën ato polumbari në det, piloti në qiell, shkencëtari në laborator, ekonomisti në planin e tij. Duhet t'i bëjë ato çdo mysliman që është anëtar i mesazhit hyjnor, kur ai merr përsipër çdo gjë duke i përdorur sendet si mjete për të ndihmuar fenë e Zotit dhe për të mbajtur lart fjalën e Tij".⁵

Me fjalë të tjera, ai bën thirrje që të shfrytëzohet koha, mendja dhe arsyeja e shëndoshë, për të përdorur dhuntitë e Zotit, për të ndërtuar jetën me dije, kulturë, shkencë, besim dhe përkushtim ndaj Zotit, pa prishur anët e peshorës. Pra, kemi nevojë që rinia e sotme islame, të mos izolohet nëpër xhami dhe të mjaftohet me pretendimin e adhurimit dhe besimit, larg dijes, kërkimit a hulumtimit në jetë, por të marrë nga xhamia dhe feja në përgjithësi, tharmin e duhur për të jetuar si një individ ndërtues me dashurinë e Zotit dhe frikën e Tij.

KULTURA KOMBËTARE DHE MORALI I FESË

Në librin: "Et-Tariku min huna", ai përshkruan ndjesinë e trishtë se: "Ky ymet e ka harruar misionin e tij, ose e ka harruar atë nga një kohë e largët. Ky është një mision i vendosur nga Zoti për ne, jo pjesë e pretendimeve tona mbi veten tonë..."⁶ Bën thirrje që myslimanët të zgjojnë dhe të respektojnë besimin dhe fenë e tyre, si dhe të mbrojnë kulturën kombëtare, në thelb të së cilës qëndron vetë besimi dhe bota e tij.

Në librin "Probleme në rrugën e jetës islame" thekson: "Kultura kombëtare është pasuri me shumë vlerë përcaktuese për një popull. Nga këtu, kolonizatori u drejtua për të goditur këtë kulturë dhe, të dobësojë institutet e saj, ta zhdukte ose ta paralizonte lëvizjen e saj, duke e lënë atë shterpë..."⁷

Sot, ne si myslimanë shqiptarë, më shumë se asnjëherë tjetër e kemi për detyrë të zgjohejmë nga dekadencia e dekadave të hirta dhe të përpiqemi t'i lexojmë ndryshe ndodhitë e përditshme që bëjnë formatimin e kulturës sonë kombëtare në emër të integritetit dhe zëvendësimit e shpirtit të saj me një shpirt të kamufluar kolonizues. Kjo tendencë formatimi e heshtur nuk është asgjë tjetër veçse një përpjekje e vjetër për të ndryshuar të pandryshueshmen e në mos, për ta plasatur sa më shumë atë. Në këtë kontekst, myslimanët shqiptarë duhet të vetë-ndërgjegjësohen për pasurinë e madhe kulturore dhe traditat e pasura me shpirt besimi që zotërojnë, të cilat nuk duhet të lejojnë të zëvendësohen a të tjetërsohen për asnjë arsye.

MESATARIZMI DHE LARGIMI NGA EKSTREMIZMI

Në librin "Probleme në rrugën e jetës islame", autori porosit: "Mos i ripërtyp dhimbjet e kaluara, por puno për rindërtimin e Islamit. Të jetë kjo pjesa më e madhe e mendimit tënd, sesa hakmarrja jote... Dëgjoni me vëmendje ata që ju njohin me të vërtetat e Islamit... në vend që të mjaftoheni vetëm me një lexim të disa librave".⁸

Është një thirrje për të respektuar dijen dhe edukatorët e saj, të cilët dinë si të krijojnë ekuilibrat e duhur për nxënësit e dijes dhe kërkuesit e saj. Në rast të largimit prej tyre, qoftë edhe me dëshirën e mirë të thellimit në dije dhe përkushtim në mënyrë individuale, mund të ketë edhe rrëshqitje që çojnë në formësimin e shfaqjeve ekstremiste dhe të paekuilibruara në jetë. Kjo ka ndodhur edhe me sahabë të Resulull-Ilahit (a.s.), nga dëshira e mirë e thellimit në përkushtim, sikurse transmetohet në librat e saktë të hadithit.

Islami është feja e mesatarizmit në të gjitha punët, larg ekstremizmit, aq më shumë kur ai shoqërohet me mungesën e edukatorit dhe mungesën e dijes së dobishme. Këtë, Imam Gazaliu i ri, ka ditur ta shpjegojë shumë mirë dhe t'i japë zgjidhje, edhe në këtë libër të përkthyer rishtas në gjuhën shqipe.

Përkthyesit, urime, suksese dhe مبارësi. Kjo vepër e Shejkh Muhammed El-Gazaliut u pasoftë me përkthime të reja dhe të dobishme për rininë islame dhe lexuesin në tërësi.

Shkodër, më 6 nëntor, 2012

133-134.

4. Muhammed El-Gazali, "Hadha dinuna", botimi I, Damask, 1997, fq. 36.

5. Muhamed El-Gazali, "Probleme në rrugën e jetës islame", Tiranë, 2012, fq. 18.

6. Muhammed El-Gazali, "Et-Tariku min huna", botimi II, Damask, 1996, fq. 75.

7. Muhamed El-Gazali, "Probleme në rrugën e jetës islame", Tiranë, 2012, fq. 36.

8. Muhamed El-Gazali, "Probleme në rrugën e jetës islame", Tiranë, 2012, fq. 84.



HUMANIZMI, FEJA E EPOKËS

Xhemil Meriç

*"E besoj me gjithë zemër se humanizmi do të jetë feja e kulluar e së ardhmes, pra, respekti për njeriun në tërësi; jeta do të bartë një vlerë etike, do të shenjtërohet, do të sublimohet. Ligji kryesor i së nesërme, do të jetë nderimi i njeriut. Ky besim nuk do të mbështillet me ndonjëfarë dyshimi, nuk do të jetë i mbyllur për të tjerët si disa sekte a parti. Një shkencë e gjerë dhe e lirë që jeton në botë sipas qejfit, që nuk njeh tjetër udhëheqës përveç mendjes, që nuk ka simbole të fshehta, tempuj, klerikë, kisha... Ja pra, feja e vetme që do t'i japë flatra njeriut!" (E. Renan, *L'avenir de la science*)*

Feja e një epoke që ka humbur besimin. Çdo filozofi që kërkon t'i dëgjohet fjala, është e detyruar të vishet me një kaftan të tillë. Humaniste ishin të gjitha lëvizjet ideore të Evropës, që nga marksizmi deri tek ekzistencializmi. Më shumë këllëf sesa koncept; jo fjalë, por kameleon; sikurse demokracia, sikurse socializmi. Humanizmi është një koncept i ri në gjuhët perëndimore, që është zbuluar pas viteve 1850. Por filoperëndimorët tanë e pëlqyen

menjëherë këtë fjalë. Sipas tyre, Junusët, Mevlanat, Haxhi Veli Bektashët janë humanistë të kulluar. Çfarë është humanizmi, askush s'tenton ta përkufizojë.¹

Kjo fjalë ka dy kuptime të ndryshme: e para, admirim ndaj antikitetit. Për Evropën e shekullit VI, humanizmi është një arratisje, një kërkim i së panjohurës. Një ekzotizëm, nevoja për një dimension të ri. Për njeriun e Mesjetës, që përpiqet të shpëtojë nga tabutë e kishës, është arratisje drejt letërsisë së Epokës së Lashtë. Paganizmi që nuk shkrinte dot individin në shoqëri, ishte liria, rezistenca. T'ia mbathësh nga muri i kishës, duke shpëtuar nga korsa metalike e dogmave, ishte edhe joshëse edhe

1. Sami Frashëri thotë: "Dashuri ndaj njerëzimit" (Kamus-u fransevi). Ky 'izëm', sipas Kemal Tahir, "është një re prej tymi që ka dalë për të mbuluar kolonizimin borgjez, i cili është kolonizimi më i poshtër". Për Ergun Göze: "Është një sistem që shpëput shpirtin e njeriut nga burimet metafizike dhe si pasojë, është një sistem i shkretë që i kushton vëmendje sipërfaqes së njeriut... faza e fundit: njeriu mekanik". (Përse ndodh kjo çoroditje? Pikësëpari, kjo gjë buron nga vetë fjala. Por, sidoqoftë, Kemal Tahir ka ngatërruar humanizmin me humanitarizmin.)

e parrezikshme. Perëndimi po strehohej në të shkuarën e vet; po analizonte trashëgiminë shpirtërore që në krye të herës, po mbliidhte stolitë e çmuara të trashëgimisë së paprekur të tij, të trashëgimisë së abandonuar. Antikiteti ishte edhe vetë ai, edhe tjetri.

Njeriu po krijonte kontakt të afërt me një mendim që Krishtërimi nuk e kishte shtrydhur. Ishte shpëtim nga testamenti, ishte dëshira për të fluturuar me krahët e vet. Nuk ishte një kryengritje e hapur, padyshim, sepse Krishtërimi nuk e kishte prerë kordonin me kulturën greko-latine. Mirëpo, ishte akoma e rrezikshme të kërceje nga frika e dogmave dhe të kaloje në oborret e poezive dhe mendimeve të botës idolatriste. Sidoqoftë, Evropa ishte e detyruar të thyente zinxhirët, të vërtetonte pjekurinë, të shpëtonte dinjitetin që po gërhiste. Kështu, intelektualit perëndimor do ta lërë mënjatë Krishtërimin, i cili ishte shpërfytyruar nga deformimet e ndryshme që kishte pësuar dhe gjithnjë e më shumë do të hyjnizonte veten.

Kuptimi i dytë i humanizmit është feja e njerëzimit. Ndonjë mendje e lirë, që ishte mërzhitur nga absurditetet e Kishës, tha: "Nuk ka perëndi në natyrë, njeriu krijon perëndinë. Shoqëria i ka pasqyruar në kupën e qiellit vlerat e veta, e ka hyjnizuar njeriun."; një tjetër: "Shkenca është e vetmja udhërrëfyese që do të shpëtojë njerëzimin."; as Zoti pra e as i adhuruari.

Feja ishte tëhuajësimi i njeriut, një lloj opiumi. Flamurtarët e mendimit të shekullit të kaluar e himnizuan Prometeun, atë Promete që thoshte: "I urrej të gjitha perënditë!" Mirëpo, perënditë që Prometeu urrente, a nuk ishin vallë idhujt e një epoke të errët, të përgjakshme, të ligë e ephndjellëse?

Për evropianin, humanizmi është një idhull që zë vendin e feve që ka humbur, të besimeve që ka shkatërruar. Humanizmi është një sëmundje e të iluminuarit, por askush nuk mund t'i vërë kufijtë e këtij 'izmi'. Thonë se humanizmi është për të absolutizuar njeriun, për të bërë që njeriu të arrijë në pikën më të lartë që mund të arrijë, pra, për t'u bërë njeriu i vërtetë, njeriu i përsosur. Po kush është shembull për këtë? **Sokrati, Vinçi, Erasmusi, Gëtja?** Njeriu ideal i Niçes ishte mbi-njeriu; pushtetarët e kohëve të vona e kanë vërtetuar se sa e rrezikshme ishte një ëndërr e tillë.

Përsa u përket heronjve të Carlyle-s, ata ishin nga një e vërtetë apo të huaj, që jetuan apo që pretendohet se kanë jetuar në të shkuarën. **Humanizmi na qenkësh hyjnizimi i njeriut. I cilit njeri? Filozofit? Kozmonautit? Masës?** Humanizmi ishte flamuri edhe i kishës, që po kuptonte se po i lëkundej pushteti. Njerëzimin po e ftojnë për vëllazëri duke vënë dorashka të mëndafshhta mbi kthetrat e përgjakura, bijtë e Pierre l'Hermite-ve dhe Ignace de Loyola-ve, të cilët thërrisnin gjithandej duke thënë se

ishin pikërisht ata humanistët e vërtetë.

Një historian katolik thotë: "Humanizmi i krishterë është vepër e përzjerjes mes idealit të fesë së grekëve me Ungjillin. Filozofia greke, qasja latine e së drejtës dhe teologjia judeo-kristiane dalin në të njëjtën pikë. Fenomeni kryesor që shfaqet në hartë është vlera e njeriut." (Grouset)

Po Islami? Nëse humanizmi është admirimi që ndihet ndaj artit idolatrist, bota islame ka jetuar pa haber nga ky admirim. Islami, që lindi në shkretëtirë, ishte i mbyllur ndaj joshjes së çmendur dhe mëkatave të poezisë greke. Pasi, nuk mund të dëgjojnë këngët e sirenavë ata që nuk mund të lundrojnë në detet e gjera. Islami sikur pati marrë mendimin nga Greqia dhe Roma, pati shtuar qenien e elementeve ushqyese, e pati lënë mbrapa procesin e shtrydhjes. Le të mos harrojmë se Evropës së zhytur në errësirë, ishin myslimanët ata që ia prezantuan gjenium më të madh të epokës së antikitetit, Aristotelin, që do të thotë se një nga burimet kryesore të humanizmit perëndimor është Islami. Ç'e do se Islami s'është interesuar

as për Homerin e as për Virgjilin. Për Xhahidhin (772 – 870), bota fillon me poetët e *Shtatë Poemave*. Përse Islami duhet t'i kthehej artit grek dhe latin? Nuk bëhej fjalë për ndonjë gjë të përbashkët, as gjuhë e as shije.

Si është ndikimi i humanistëve të Rilindjes mbi humanizmin bashkëkohor? Thënë ndryshe, vëmendja e një Fojerbahu, Renani, Marksi, mos është bërë transmetuesja e kumtit të Rilindjes, që i jep flatra fatit mrekullor dhe vlerës së pashembullt të njeriut? Sikur mos të ishin ata, mos vallë Comte nuk do të krijonte Fenë e Njerëzimit? Nuk e dimë.

Ne nuk arritëm të bëhemi humanistë, ngaqë nuk e përjetuam Rilindjen? Pikësëpari, historia e Rilindjes, më shumë se një e vërtetë, është një mit italian. Në mendim nuk ka një rilindje, një rikërcim. Në Islam nuk ka as kishë e as ndonjë ndërmjetësues mes Zotit dhe njeriut. Mendimi islam kundrejt cilës trysni duhet të rezistojë, kujt do t'ia vërtetonte pavarësinë e vet?

Nëse humanizmi është respekt ndaj dinjitetit të njeriut, nëse është t'i bësh nderim të veçantë njeriut, brenda natyrës, atëherë Islami është i vetmi humanizëm. Nëse "Humanités" është edukatë, qytetari, kontrolli i egos, respekt ndaj së shenjtës, atëherë Islami, veçanërisht mistika islame, është fiks "Humanités". Vetëm në Islam njeriu është *krijesa më e nderuar*. Nga njëra anë, është dhë dhe nga tjetra është i shenjtë. Qenia e mrekullueshme që kornizohet me bejten e shquar të Fejzi Hindiut:

"Më madhështor se qielli, më i rëndomtë se dheu. Nëse je i varur nga zullumi i asgjësë, s'je tjetër veçse dhë; nëse je manifestues i nurit hyjnor, Arsh je!"



LIGJI KOZMIK

Islami e ka ndërtuar sistemin e vet të besimit, si në planin teorik, ashtu edhe në planin praktik mbi parimin e nënshtrimit të plotë ndaj një Zoti të vetëm. Këtë parim e pasqyron në mënyrë të barabartë në sistemin e besimit, adhurimit dhe në sistemin ligjor. Në këtë mënyrë, **“La ilahe illallah”** (nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, që meriton të adhurohet), shpreh kuptimin praktik të shehadetit. Kurse **“Muhammeden Resulullah”** shpreh marrjen e sitemit nga Muhamedi (a.s.), dhe jetësimim e shehadetit në jetën tonë.

Dëshmia **“La ilahe illallah Muhammeden Resulullah”**, shpreh në formë të plotë programin e jetës në Islam. Kjo dëshmi vendos parimin e robërimit vetëm ndaj Allahut, duke penguar në mënyrë kategorike robërimin e njëri-tjetrit. Shprehja **“La ilahe illallah”** synon pikërisht realizimin e këtij parimi. Kurse shprehja **“Muhammeden Resulullah”** kërkon që mënyra e realizimit të këtij parimi të merret prej të Dërguarit të Allahut, Muhamedit (a.s.).

Allahu ka vendosur një harmoni dhe rregull për çdo gjë që ka krijuar. Përse Allahu ka përcaktuar legjislacionin dhe mënyrën e jetesës, që duhet të ndjekim në këtë botë? Përse duhet ta përcaktojë Allahu orbitën tonë, rrethin e veprimit tonë. Ta trajtojmë këtë me disa pyetje.

1. SI ËSHTË KRIJUAR UNIVERSI DHE CILI ËSHTË LIGJI I TIJ?

“Është Ai, i Cili krijoi qiejt, Tokën dhe gjithçka që gjendet midis tyre për gjashtë ditë e pastaj u ngrit mbi Fron. Ai është i Gjithëmëshirshmi dhe pyet për Të ata që dinë.” (Furkan, 59) **“Allahu është Ai, i Cili krijoi natën dhe ditën, Diellin dhe Hënën; e të gjitha këto lundrojnë në gjithësi.”** (Enbija, 33)

Sunduesi i qiejve dhe i Tokës, i Cili nuk ka bir e nuk ka ortak në pushtet; i Cili ka krijuar çdo gjë dhe e ka rregulluar si duhet! (Furkan, 2)

Mund t'i shtojmë ajetet që trajtojnë universin dhe ligjet e tij. Siç kuptohet lehtë nga ajetet, çdo gjë në univers ka një funksion dhe qëllim të cilin ia ka përcaktuar Allahu. Toka, duke u rrotulluar rreth diellit, formon vitin, kurse duke u rrotulluar rreth vetes, formon ditë-natën, pemët japin fruta... pra çdo gjë në univers e zbaton me përsosmëri detyrën e përcaktuar nga Allahu. Ky ligj i vendosur nga Allahu, siguron harmoni midis gjithë njësive dhe rregullon çdo lëvizje në sistem. Në këtë mënyrë, sigurohet ekulibri i ekosistemit universal. Ngaqë universi u bindet këtyre ligjeve, nuk çekulibrohet, nuk del jashtë rregullit të vendosur.



2. KRIJIMI I NJERIUT. ÇFARË ËSHTË DHE SI ËSHTË?

Edhe njeriu është një pjesë përbërëse e universit, e krijuar prej Allahut. Nga pikëpamja e ndërtimit fizik dhe biologjik, njeriu është i detyruar t'u bindet ligjeve të vendosura nga Allahu. Që në fillim, Allahu e ka sjellë në ekzistencë njeriun. Njeriu ndjen uri, etje; ha dhe pi. Njeriu kryen frymëmarrje sa herë dhe në formën që Allahu i ka përcaktuar. Të gjitha organet funksionojnë sipas programit të vendosur nga Krijuesi. Këto sisteme janë jashtë kontrollit të njeriut, pra nuk varen nga vullneti i njeriut. Në këtë prizëm edhe njeriu si çdo qenie në univers, u është nënshtruar ligjeve të vendosura nga Allahu.

3. ÇFARË ËSHTË SHERIATI DHE CILAT JANË FUNKSIONET E TIJ?

Allahu thekson në ajetin e 14-të sures Rahman krijimin e njeriut prej balte. **“Ai krijoi njeriun prej baltës së thatë, ashtu si vorba.”** Siç e përmendëm më sipër, funksionimi fiziologjik i njeriut i nënshtrohet ligjit të Allahut në mënyrë të pavullnetshme. Për të siguruar një harmoni, ekulibër dhe koordinim midis anës së vullnetshme të njeriut dhe anës së pavullnetshme të tij, Allahu ka vendosur një sistem ligjor, “shariatin”. Për të mos dëmtuar këtë ekulibër dhe harmoni është i domosdoshëm zbatimi dhe respektimi i këtij sistemi ligjor.

Për të arritur një kompromis midis pjesës së padukshme të personalitetit dhe pjesës së dukshme

të tij, është patjetër i domosdoshëm respektimi i sheriatit.

4. PËRSE LIGJVËNËSI DUHET TË JETË ALLAHU?

Njerëzit nuk mund t'i kuptojnë të tëra ligjet që rrethojnë universin, që sigurojnë funksionimin normal dhe vazhdimësinë e tij. Madje, njeriu nuk është në gjendje të kuptojë plotësisht as vetveten e tij. Prandaj është e pamundur për njeriun të vendosë një sistem të efektshëm me të cilin të sigurojë ekulibrin dhe harmoninë midis vetes dhe botës që e rrethon. Nëse përpiqet të bëjë një gjë të tillë, patjetër që do të cenojë harmoninë dhe ekulibrin. Në fakt, njerëzit janë përpjekur për të krijuar një sistem, por në përgjithësi sistemet e ndërtuara prej tyre janë bërë shkak i shumë fatkeqësive të njeriut.

5. PËRSE ALLAHU NUK I KA DHËNË MUNDËSI NJERIUT TA KRIJOJË VETË SISTEMIN LIGJOR?

Njerëzit janë përpjekur të krijojnë sistem ligjor alternativ ndaj sheriatit të Allahut, por nuk kanë pasur sukses. Këto ideologji, jo vetëm që nuk u kanë dhënë zgjidhje problemeve të njeriut, por ia kanë shtuar më tepër problemet atij. Allahu në mënyrë të përmbledhur e shpreh kështu nismën e njerëzve për të krijuar një sistem konkurent të sheriatit. **“Sikur e Vërteta të ishte sipas dëshirave të tyre, atëherë do të shkatërroheshin qiejt dhe Toka dhe gjithçka që gjendet në to. Ne u kemi dërguar atyre Këshillën (Kur'anin), por ata shmangen nga ajo.”** (Mu'minun, 71)

Marrëdhëniet Kuran - Njeri

Semra Kyryn Çekmegil

Shpallja hyjnore cakton peygamberin, të gjitha ndodhitë në univers, rrjedhën, kuptimin dhe rëndësinë esenciale të përmbajtjes së këtyre ekzistencave. Allahu Teala ka krijuar të gjitha krijesat dhe u ka dhënë atyre edhe nga një detyrë. Çdo krijesë e bën punën e saj pa asnjë mangësi. Secila prej tyre e vazhdon jetën duke ndihmuar dhe plotësuar tjetrën, brenda një sistemi e rregulli.

Toka ka nevojë për farën, fara për ujin, çdo krijesë ka nevojë për tjetrën, ndërsa njeriu ka nevojë për të gjitha këto. Sikur pemët të ishin lapsa dhe detrat bojë, nuk do të mjaftonin për të treguar këtë krijim e ekzistencë. Ai që guxon ta bëjë këtë, nuk ia del dot mbanë.

Përse? Për kë janë krijuar të gjitha këto krijesa? Kush e njuh dhe kush mund ta shpjegojë këtë krijim mahnitës? Çfarë është kjo ekzistencë? Njeriu është ai i zgjedhuri ndërmjet të gjitha këtyre krijesave. Çdo gjë është në shërbimin e tij, çdo gjë ka marrë kuptim nga ai, është vepra artistike e pashoqe e Allahut Teala, i krijuar në formën më të mirë. Atij i janë mësuar emrat e gjërave dhe i është dhënë urtësia.

Ata që ua mësojnë njerëzve parimet që i bëjnë të vlefshëm, janë peygamberët e zgjedhur ndërmjet të gjithë njerëzve të krijuar.

Të gjitha pyetjet i gjejnë përgjigjet duke pranuar peygamberët. Allahu Teala na ka njoftuar nëpërmjet peygamberëve për shpirtrat, për krijesat në qiej dhe për botën e ditur e atë të paditur. Njeriu është mëkëmbës në tokë, për shkak se është krijuar me aftësitë, si mendja, konceptimi, vullneti dhe zbulimi marramendës i gjërave e i ambjentit që e rrethon.

Kur njeriu, që është zgjedhur ndërmjet të gjitha krijesave të tjera, t'u besojë peygamberëve që janë zgjedhur ndërmjet njerëzve, atëherë e njuh Krijuesin e tij, e kupton se sa e vlerëson Ai, e mëson se me çfarë punësh lartësohet vlera e njerëzisë dhe e koncepton se do të humbë vlerë, nëse lë pas dore disa gjëra të tjera...

Kur njeriu që është krijuar në formën më të mirë, t'i refuzojë peygamberët, e humb privilegjin dhe te Krijuesi bie në një shkallë aq të ulët, saqë nuk mund të krahasohet me asnjë kri-



jesë, sepse natyrshmëria e njeriut është "Ahseni Takvim". Për fat të keq, më vonë ai e mbuloi natyrshmërinë me dëshirat e pasionet vetjake dhe e neglizhoi të vërtetën e krijimit të çdo gjëje e synimin e krijimit.

Me këtë gjendje, edhe nëse standardi i jetesës së njeriut është në shkallën më të lartë, edhe nëse bën jetën më të mirë e më të rehatshme, në të vërtetë ai është prej të mashtruarve dhe prej të humburve. Njerëz të tillë kanë harruar se do të kthehen në botën tjetër. Siç nuk ka mundësi foshnja të vendosë për të ardhur në këtë botë, edhe te vdekja nuk mund të bëjë ndonjë ndërhyrje. Kjo është një e vërtetë që nuk mund ta mohojë askush. Allahu i Madhëruar në Kuranin Fisnik, e shpreh kështu gjendjen e këtyre njerëzve, të cilët i kanë neglizhuar argumentet e tij:

"(Allahu do t'u thotë): Tashmë na vini veç e veç, ashtu siç ju krijuam herën e parë, duke lënë pas vetes ato që ju patëm dhuruar. Ne nuk po i shohim me ju ndërmjetësuesit tuaj, për të cilët pretendonit se ishin ortakët e Allahut. Mi-dis jush janë shkëputur të gjitha lidhjet dhe ajo tek e cila shpresonit, ju ka lënë në baltë." (el-En'am 94)

"O njeri! Dëgjoje zërin e natyrshmërisë tënde dhe atë që të thërret për te ajo. Kjo thirrje është për njerëzit e mençur. Njeriu, i cili është krijuar nga asgjëja!"

Edhe pse ke fuqi për të bërë shumë gjëra me vullnetin tënd, pra-pëseprapë nuk mund t'i largosh shumë fatkeqësi që nuk i dëshiron, ashtu siç nuk mund të arrish çdo gjë që dëshiron.

"O njeri! Ç'të mashtroi ty që nuk i besove Zotit tënd bujar, i Cili të krijoi ty, të dha përmasa të rregullta, të harmonizoi dhe të ka mbrujtur në çfarëdo forme që ka dashur?!" (el-Infitar 6-8)

Tani le të mendojmë! A nuk arrihet qetësia shpirtërore dhe siguria, nëse do të përfetohej Kurani dhe zbatoheshin urdhrat e tij? Sado që të ketë zullumqarë dhe injorantë që i mbyllin veshët ndaj thirrjes së Allahut të Madhëruar, ata nuk do të guxojnë të bëjnë ligësira, për shkak se e dinë se do të ndëshkohen.

Të gjithë i dimë ato gjëra që bëjnë ata, të cilët luftojnë pa mëshirë për t'i arritur shpresat dhe dëshirat e tyre të përkohshme në këtë botë, në vend që të luftojnë që të zbatohet dhe të mbisundojë Kurani Fisnik... Sot

në Palestinë, ku lufta është më e nxehtë, padrejtësitë që u bëhen myslimanëve, a nuk u bëhen në emër të drejtësisë, lirisë dhe demokracisë?

Ai që nuk ka frikë nga Allahu, mendon vetëm për interesat e kësaj bote të përkohshme. Për këtë arsye, i del kundër çdo gjëje që mund të jetë pengesë për interesat dhe pasionet e tij. Sigurisht se këtë do ta bëjë me mbështetësit që ka pranë. Kurani Fisnik e konkretizon këtë me shembullin e Faraonit, Hamanit, Karunit dhe Bel'amit.

Faraonin e mbante në këmbë Hamani, që ishte fuqia ushtarake, Karuni, që ishte fuqia ekonomike dhe Bel'ami, që jepte fetva sipas interesave të tij.

Botën që po prishet, po shkatërrohet dhe po mbytet çdo ditë e më shumë në ndjenja kafshërore, që po e drejtojnë njerëz të paaftë e po e kthejnë në një kaos,

mund ta shpëtojë vetëm shoqëria që ndërton Kurani Fisnik. Ata të cilët i besojnë një ndërtimi të tillë, duhet ta lexojnë Kuranin sikur t'u ishte shpallur atyre, ta përsosin moralin me dispozitat e tij dhe të paguajnë çfarëdo çmimi në atë rrugë.

Pra, duhet të punojnë si sahabët e nderuar dhe i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i cili siç i premtoi njerëzisë siguri, drejtësi dhe xhenet.

Allahu Teala në Kuranin Fisnik, thotë:

"Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t'i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe frikën do t'ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos më shoqërojnë asgjë (në adhurim). Sa për ata që, pas kësaj, mohojnë (besimin), pikërisht ata janë mëkatarët." (en-Nur 55)

O njeri, që të ka mëshiruar Allahu! O njeri, që je ngritur në miraxh duke i bërë sexhde Allahut Teala me plot bindje! Kthehu në natyrshmërinë tënde! Kërko mbrojtje nga Zoti, që të arrish krenarinë, nderin, virtytin dhe lumturinë e përhershme! Kjo rrugë nuk është qorrsoak, por një rrugë që të shpie në përjetësi.





Nijeti i singertë

Shejkh Muhamed El-Gazali

Zemra e bindur tek Allahu dhe e prehur tek Ai meriton suksesin dhe udhëzimin në rrugën e drejtë. Allahu i Madhëruar thotë: **“Kush beson në Allahun, Ai ia udhëzon zemrën...”**¹, ndërsa zemra bosh, pa Zotin e saj, e mbushur me epshe, rrëshqet në jetë e shkapërderdhur dhe këtë e vërteton edhe fjala e Allahut: **“Ata të cilët nuk i besojnë ajetet e Allahut, Ai nuk i udhëzon...”**²

Njerëzit e thjeshtë e dinë se nijeti i singertë e shpëton të zotin prej telasheve të ndryshme dhe se, nijetin jo të pastër e shoqëron bredhja dhe hallakatja. Allahu u ka premtuar besimtarëve të devotshëm se do t’u bëjë dritë me të cilën të ndriçojnë udhën, prandaj kush preket prej rrezeve të këtij nuri drite, gjithmonë është në rrugën e drejtë dhe i mbrojtur prej rrëshqitjeve të frikshme **“dhe kujt Allahu nuk i bën dritë, ai asnjëherë nuk do të ketë dritë.”**³

Pejgamberi (a.s) e ka bërë të qartë se besimtari i mirë ndriçohet nga brendësia e tij, ku thotë: **“Devotshmëria**

është këtu”, duke bërë me shenjë nga kraharori i tij, d.m.th. se devotshmëria nuk është fjalë goje apo lojë aktrimi dhe as pretendim pa fund, por ajo është zemër e bindur, e drejtuar tek Allahu dhe e kapur për Të.

Një pjesë e njerëzve dinë të bëjnë mirë imitimin e veprave të mira dhe perfeksionimin e mënyrës së kryerjes së tyre, por ata janë të privuar prej kuptimit dhe ndikimeve të tyre të mira. Shkak për këtë është ashpërsia e zemrës dhe zënia e saj me punë të tjera.

Largohesha shpejt prej atyre njerëzve që në zemra kishin ashpërsi dhe në moralin e tyre kishte vrazhdësi edhe nëse dinin të bënin mirë disa farze, detyra, sepse zbukurimi i jashtëm nuk i bën dobi pastërtisë së brendshme dhe ndriçimit të saj.

Duke medituar, ndjej se disa politikanë dhe udhëheqës adhurojnë vetën e tyre, edhe pse shfaqen si adhures të Zotit.

Ebu Xhehli mund të ishte kthyer me popullin e tij, pa e zhytur atë në humbjen e madhe të Bedrit, sepse kjo betejë nuk kishte kuptim, pasi kaloi karvani të cilin

1. Tegabun, 11.
2. Nahl, 104.
3. Nur, 40.



kishin dalë ta shpëtonin. Animi i Ebu Xhehlit për t'u shfaqur si udhëheqës dhe mburrja për t'u dukur, e bëri atë të thoshte se nuk largohemi pa pirë verë, pa therë devetë dhe pa kënduar e kërcyer valltaret. Ishte kjo arrogancë, që e shtyu atë dhe popullin e tij drejt humbjes.

Pa dyshim që shumë prej cytjeve egoiste pushojnë pas rrugëve ogurzeza dhe vendimeve të përgjakshme! Sikur çdo njeri të përpiqej për rregullimin e brendësisë së tij dhe pastrimin e saj prej sëmundjeve të fshehta, apo prej shirkut të fshehtë siç ka ardhur në disa transmetime, do të kishin shpëtuar njerëzit dhe toka prej tragjedive të mëdha.

Dihet mirë në fushën e fesë se Allahu shikon ndër-gjegjen, brendësinë dhe jo pamjen e jashtme; dhe se vendi i robit përcaktohet dhe varet prej pjesës së fshehtë, dëlirësisë së zemrës dhe sinqeritetit të marrëdhënieve të tij me Zotin ***"Apo, atij që Allahu ia ka hapur kraharorin me Islam dhe ai është në dritë prej Zotit të tij? Mjerë për ata që i kanë zemrat e ashpra në përmendjen e Allahut. Të tillët janë në humbje të qartë."***⁴

Meditova ajetet e mëposhtme për këtë ajet dhe gjeta se ato bënin thirrje për butësinë drithëruese, ndjenjat mëshironjëse dhe njeriun që lëviz me frikën e Allahut, larg prej ndikimeve dhe dashurisë së nxitimit ***"Allahu zbriti fjalën më të bukur, libër të përputhshëm harmonizues, rrëqethen lëkurat e atyre që i frikësohen Zotit, pastaj lëkurat dhe zemrat e tyre zbuten nga***

përmendja e Allahut."⁵

M'u kujtuan dy njerëz, të cilët dolën në një duel. Njëri ishte i mprehtë dhe me mendje filozofi, por ishte egoist, lakmitar, ndërsa tjetri nuk ishte aq i zoti, por i qeshur dhe tolerant!

Thashë: do të humbë mprehtësia dhe filozofia me ngushtimin e zemrës dhe vrazhdësinë; dhe do të triumfojë modestia me fytyrën e qeshur dhe shtrirjen e dorës, tolerancën!!

Në betejën e besimit me mohimin vërej se disa klerikë janë sakrifikues dhe se disa dijetarë janë egoistë, kështu që, dëshpërohem prej përfundimit të keq dhe e di se rezultati do të sillet përreth të vërtetës.!

Feja është gjëja e vetme, e cila qëndron më larg se askush tjetër nga vrazhdësia, ashpërsia, mendjemadhësia dhe lakmia. Këto cilësi, sa herë që vihen në kupën e peshores, e fundosin atë. Kur mendoj në jetën e Pejgamberit (a.s.), shikoj trupëzimin e modestisë dhe bamirësisë, të mëshirës dhe drejtësisë dhe dashurinë e çdo gjëje. Me të vërtetë ***"Atij i vjen rëndë për gjendjen tuaj dhe kujdeset për ju. Për besimtarët është i butë, i mëshirshëm."*** Atëherë, a e marrim shembullin e mirë prej njeriut të plotë, për të cilin është thënë: ***"Me mëshirën prej Allahut u bëre i butë ndaj tyre. E sikur të kishe qenë i ashpër dhe zemërvrazhdë, do të ishin larguar prej teje?"***⁶

Përshtati në shqip:
Lavdrim Hamja

4. Zumer, 22.

5. Zumer, 23.

6. Ali Imran, 159.

QYTETËRIMI ISLAM

Prof. dr. Zija Kazëxhë

Historia ka dëshmuar se aty ku ka njerëz, pak apo shumë ka edhe elementë qytetëruar. Zhvillimet civile, që lindin si rezultat i të jetuarit në mënyrë kolektive, vazhdojnë të jenë që nga dita kur njeriu nisi të jetojë mbi faqen dheut. Ndaj dhe nuk dihet saktësisht sa qytetërime të ndryshme nga njëri-tjetri kanë ardhur. Toynbee tregon se 16 qytetërime kanë vdekur dhe pesë të tjerë janë në prag të zhdukjes nga qytetërimi perëndimor.¹ Sot vërehen dy zona qytetërimi, njëra prej të cilave është qytetërimi perëndimor, i cili është nën ndikimin e Krishtërit, Hebraizmit dhe të sistemeve të tjera. Kurse tjetri është qytetërimi islam, i cili vazhdon ndikimin në zonat ku është përhapur feja islame.

Gjatë lindjes dhe zhvillimit të tij, qytetërimi islam është takuar me katër qytetërime apo kultura:

1. Bizanti (Greqia)
2. Irani
3. India
4. Kina

Në sajë të qytetërimit islam, i cili u zhvillua në një kohë të shkurtër, myslimanët morën një zonë që nga Ngushtica e Gjibraltarit deri tek Muri Kinez. Ata u sollën mirë me popullin aty. Pas

një periudhe të shkurtër, myslimanët krijuan qytetërimin më të madh, në shkencë të ndryshme si ato ekzakto, art, ekonomi, mjekësi, letërsi, filozofi etj. Qytetërimi islam nuk mbeti vetëm me futjen nën sundim të disa zonave të rëndësishme të Azisë, Afrikës dhe Europës, njëkohësisht ka luajtur një rol të madh për të zhvilluar qytetërimin perëndimor, i cili njihet si qytetërimi i Europës së sotme. Qytetërimi islam, që ende sot ruan ekzistencën e tij, megjithëse duket sikur ka humbur funksionin aktiv, ka ushtruar një ndikim të madh mbi qytetërimin perëndimor. Kjo gjë është më se e natyrshme. Një anëtar i një feje, e cila nxit për dituri duke vlerësuar meditimin dhe angazhimin për shkencë, si më të rëndësishme edhe se adhurimet vullnetare (nafillet); që vlerëson edhe gjumin e dijetarit/shkencëtarit dhe që vlerëson më shumë bojën e dijetarit, sesa gjakun e shehidit, natyrisht do të interesohet për shkencë. Kjo përpjekje do të ndihmojë të zhvillohet qytetërimi dhe mjetet e tij. Në sajë të këtij zhvillimi, bota islame, krahasuar me Perëndimin, u ngjiti në një nivel më të lartë të qytetërimit. Kur bota perëndimore u përball me diturinë, shkencën natyrore, mendjen dhe teknikën e qytetërimit islam, e pa veten shumë të pafuqishme dhe të dobët. Për të plotësuar mungesën dhe për të jetuar si njerëz, zgjodhën rrugën për të përfutur nga myslimanët.

Kur perëndimorët hodhën themelet e qytetërimit të tyre, ata përdorën elementë të qytetërimit islam. Ndërkohë, pa kuptuar kishin mbetur nën ndikimin e tij.

1. Ibrahim Kafesoğlu, *Türk Milli Kültürü*, Ankara 1977, fq. 9.

VEÇORITË E PËRBASHKËTA TË QYTETËRIMEVE

Kur vërehet me kujdes në hapësirën e përhapjes së komunitetit të ndonjërit nga qytetërimet, me gjithë shumicën e kombeve, ndryshimit të gjakut, llojit, ngjyrës dhe gjuhës që përmbanin ato, vërehet se qytetërimet kanë disa pika të përbashkëta. Këto pika të përbashkëta përbëjnë bazën, shpirtin dhe esencën e qytetërimit. Fjala vjen, nëse një njeri i thjeshtë i Stambollit ikën në Merakesh, Mezo-potami, Kajro, Mekë, Damask, Baku, Tahrani, Kabul, Lahor, Kalkuta apo Semerkand, nuk e ndjen veten plotësisht të huaj. Të paktën nuk e ndjen veten në një tjetër atmosferë apo rreth, sa ndihet në Sofje apo Athinë, të cilat i ka shumë më afër. E ndjen veten brenda atyre imazheve, formave, lëvizjeve dhe sjelljeve që është mësuar t'i shohë.

Mënyra e veshjes, jetesës, traditat dhe situatat në ato zona, u ngjajnë atyre çfarë është mësuar ai. I njëjti fes, e njëjta xhelabije, gratë vishen njëlloj, xhamitë e njëjta, adhurimet e njëjta, i njëjti ezan, të njëjtat rituale, të njëjtat lutje etj.

Kjo ngjashmëri nuk mbetet vetëm në aspektin e jashtëm, por edhe në botën e brendshme të tyre, gjendjen shpirtërore dhe në mentalitet.²

Edhe në grupet e tjera të qytetërimeve mund të vërehen situata të ngjashme. Pikat e përbashkëta mes popujve që janë pjesë e një grupi të një qytetërimi të caktuar, materiale apo shpirtërore qofshin, dëshmojnë veçorinë e atij qytetërimi.

Ajo çfarë i dallon popujt e ndryshëm nga aspekti kulturor, më shumë se mjetet dhe veglat që përdorin, janë tërësia e vlerave intelektuale dhe shpirtërore që ndodhet pas mjeteve dhe veglave.

Qytetërimi islam është emri i një qytetërimi të përbashkët, në të cilin bëjnë pjesë popujt të ndryshëm, që pranojnë besimin islam. Arabët, persët dhe turqit kanë dhënë kontribut të vyer në themelimin dhe zhvillimin e këtij qytetërimi. Ashtu sikurse shprehet edhe W. Barthold, emri qytetërimi islam apo qytetërimi arab i përket qytetërimit lindor të Mesjetës. Myslimanët që sollën këtë qytetërim, nuk ishin vetëm arabët, por thuajse tërë popujt e Azisë së Vogël dhe Afrikës, të cilët i bashkon Islami si fe zyrtare dhe gjuha arabe si gjuha e letërsisë dhe shkencës.³ Ky unitet pati sjellë një qytetërim të atillë, të cilit qytetërimi perëndimor i sotëm i është borxhli. R.V.C. Bodley (1546-1613), e rrëfen këtë të vërtetë në këtë mënyrë: "I jemi borxhlinj

Islamit për Rilindjen". Krahas këtyre, sot jemi dëshmitarë që dita-ditës disa zhvillime të ndryshme po arrihen duke u frymëzuar nga studimet që po bëhen sot lidhur me institucionet osmane.

Pjesa e historisë së qytetërimit botëror, mes shekujve VII - XIII është Qytetërimi islam. Një nga të vërtetat e pamohueshme të historisë, është se mes shekujve VII - XIII populli islam ishte populli më i qytetëruar dhe i përparuar i Azisë së Vogël edhe i Europës. Në ato kohë, Bagdadi dhe Kordova ishin qytetet më të pasura të botës, në të cilat gjallëronte tregtia dhe zhvilloheshin artet e ndryshme. Këto qytete ishin njëkohësisht qendra aktivitetesh të dendura kulturore dhe burim energjie për qytetërimin. Shkenca dhe letërsia, që u zhvillua në një mënyrë marramendëse, tërhiqte vëmendjen e çdo dijetari apo artisti në botë.

Nëse një qytetërim përkufizohet sipas nivelit të përparimit material, përmes pasurisë intelektuale që ka dhuruar dhe nga vlerat shpirtërore dhe të veprave kre-ative, atëherë që me shfaqjen e Islamit, këto pesë shekuj në fjalë duhen pranuar si një nga periudhat më të ndritura të historisë botërore.

Ky zhvillim marramendës veçanërisht i aspektit shpirtëror të botës islame, me fuqinë reformatore të Islamit, aftësinë e aksionit shpirtëror dhe krahas këtyre, bashkë me aftësitë artistike dhe të menduarit e ndritur të popujve arabë dhe joarabë, që kanë kryesuar në këtë qytetërim, mund të shpjegohen me vlerën që Islami i ka dhënë shkencës.⁴ Ne nuk e ndjejmë të nevojshme t'u referohemi ajeteve dhe haditheve për këtë temë. Kontributin e Islamit është e pamundur ta kufizojmë vetëm në planin material apo atë shpirtëror, pasi është një sistem që zbatohet në çdo fushë të jetës, si në atë materiale, ashtu dhe në atë shpirtërore. Në sajë të kësaj veçorie, bota islame është marrë me çdo kategori të shkencave. Sipas botëkuptimit islam, shkenca dhe adhurimi janë dy elementë të pandashëm nga njëri-tjetri. Ndaj dhe mysli-manët, që nga shekujt e parë të Islamit, nisën të studionin shkenca të ndryshme. Këto studime filluan në një farë mënyre me përkthime, pastaj me zhvillimin e tyre, nisën të dalin veprat e para autoriale. Në këto studime, krahas shkencave fetare, si Kurani, Suneti, Fikhu dhe Kelami, të cilat nuk nevojiteshin për përkthim, shkencat, si historia, gjeografia, astronomia, mjekësia, filozofia, matematika, arkitektura, ekonomia, sociologjia etj., ishin shkenca që hynin në interesin e tyre. Kështu që, zhvillimi i shumë

2. Ahmet Ağaoğlu, *Üç Medeniyet*, İstanbul, 1972, fq. 4-5.

3. M. Fuad Köprülü-W. Barthold, *İslam Medeniyeti Tarihi*, Ankara 1973, fq. 3.

4. Haydar Bammât, *İslam'ın Çehresi*, përkth turq. Osman Fehmi Giritli, İstanbul 1975, fq. 93-94.

shkencave, që pak ishin harruar dhe pak ishin braktisur, u realizuan përmes myslimanëve. Ndaj dhe mund të themi që qytetërimi i sotëm është ndërtuar mbi themelet e studimeve të myslimanëve. Mjafton të përmendim vetëm disa emra për ta provuar këtë: Ali b. Rabban et-Taberi, Razi, Ibn Xhulxhul, Ibn Xhezzar, Ibn Sina, el-Mes'udi, el-Biruni, Ibn Hazm, Ibn Rushd, el-Gazzali, Ebu'l-Fida, Ibnu'n- Nefis, Abdulaziz es-Sivasi, Geredeli Murad, Haxhi Paşa, Mukbilzade Mu'min, Sabunxhuoglu Sherafeddin Ali, Ak Shemseddin, Ali Kushçu, Mirim Çelebi, Ibn Kemal, Ebu Suud Efendi dhe shumë shkencëtarë e dijetarë të tjerë, kanë ndriçuar tërë botën me studimet që kanë bërë.⁵

Këto studime të shkencëtarëve myslimanë dalëngadalë kanë filluar të pohohen edhe nga Perëndimi. Për të shpjeguar se si bota perëndimore mban një zili dhe inat ndaj botës islame, Montgomery Watt thotë kështu:

*"Në këtë kohë kur myslimanët bashkëjetonin me të krishterët dhe arabët me evropianët, do të ishte shumë me vend bërja e një studimi lidhur me ndikimin e Islamit në Europë. Panorama që kanë skicuar në mendje shkrimtarët e Mesjetës dihet tashmë që është tërësisht një produkt shpifës ndaj Islamit. Tani, gjatë shekullit të kaluar, në sajë të hulumtimeve të bëra nga studiuesit, kjo gjë po merr përmasa më të kthjellëta dhe objektive në syrin e perëndimorëve. Por syri i verbër i evropianëve përbën pengesë për të vërejtur borxhin që i kanë kulturës islame. Nganjëherë e shpërfillim vlerën dhe fuqinë e ndikimit që i ka bërë Islami trashëgimisë që na vjen nga e shkuara dhe nganjëherë bëjmë sikur nuk e shohim. Për të krijuar marrëdhënie më të mira me myslimanët dhe arabët, duhet të rrëfejme të gjitha borxhet që kemi. Mbajtja fshehtë dhe mohimi i tyre është tregues i një mendjelehtësie false."*⁶

Një konstatim të përafërt bën edhe Sigrid Hunke:

"Do ishte vallë tepër herët të korrigjonim padrejtësinë që i kemi bërë një populli, të cilit, nga fanatizmi fetar, i kemi mohuar të drejtën për një vlerësim objektiv e të barabartë, të cilit ia kemi hedhur sistematikisht poshtë arritjet e mëdha, të cilit ia kemi maskuar apo fshehur kontributin thelbësor që ka dhënë në qytetërimin tonë? Natyra e marrëdhënieve mes Perëndimit dhe botës arabe, që prej shpalljes së Islamit deri në ditët tona, tregon në një mënyrë tipike se deri në ç'shallë mund të ndikojnë ndjenjat e pasionet në mënyrën e shkrimit të historisë. Kjo ishte diçka e kuptueshme në kohën kur të gjitha ndikimet e tjera heterodokse konsideroheshin të padëshiruara, sepse mbaheshin të rrezikshme. Por kjo pikëpamje,

*që padyshim vlente për Mesjetën, s'duhet të ketë më vend në ditët tona. Mirëpo, është e sigurt që një lloj mospëlqimi me prejardhje fetare, shpesh i pandërgjegjshëm, por i rrënjësor thellësisht brenda nesh, na kufizon horizontin e na armiqëson me disa njerëz, të cilëve propaganda u ka dhënë imazhin e personave të dhunshëm, idhujtarëve e magjistarëve."*⁷

Kështu siç shihet, bota perëndimore për arsye të fanatizmit fetar, bën sikur nuk i sheh zhvillimet në botën islame dhe nganjëherë sikur i nënvleftëson këto zhvillime. Lidhur me këtë çështje, sërish dëshiroj të shkëpus edhe këtë nga Watt-i:

"Pyetja e parë e rëndësishme që duhet bërë kur trajtojmë suksesin e myslimanëve në shkencë dhe filozofi, është: Cili është kontributi i myslimanëve në shkencat që kanë zbuluar grekët, sa kanë transmetuar nga këto shkenca dhe sa nuk kanë transmetuar dhe sa prej tyre ia kanë adresuar vetes?" Shumë shkencëtarë evropianë e trajtojnë këtë çështje me një paragjykim ndaj myslimanëve. Madje, një pjesë e tyre që lëvdon myslimanët, i lëvdon padashur.

Për shembull, Carra de Vaux, autorja e temës "Astronomia dhe Matematika", e veprës The Legacy of Islam (Oxford University Press, London 1931), e ka parë të arsyeshme të fillojë trajtimin e temës duke shpërfillur myslimanët:

"Është e kotë të gjejmë tek myslimanët fuqinë mendore, aftësinë dhe vullnetin e fantazisë shkencore dhe mendimin origjinal sikurse vërejmë tek grekët. Studentët e grekëve, para së gjithash, janë arabët myslimanë. Shkenca e arabëve është vazhdimi i shkencës së grekëve. Arabët e kanë mbrojtur dhe zgjeruar dhe e kanë përsosur në disa aspekte."

Megjithatë, Carra de Vaux, detyrohet më pas të rrëfëhet në këtë mënyrë:

*"Vërtet myslimanët arabë arritën suksese të mëdha në shkencë. Ata na e mësuan zeron, megjithëse nuk e zbuluan vetë. Myslimanët u bënë themeluesit e aritmetikës praktike. Hodhën themelet e gjeometrisë aritmetike. U bënë po ashtu, themelues edhe të planit dhe trigonometrisë së hapësirës. Sikur të themi të vërtetën, këto shkenca nuk njiheshin më parë nga grekët. Myslimanët edhe në astronomi kanë bërë vështirësi mjaft të vrya."*⁸

Pas periudhës së përkthimit (koha e el-Me'munit, shek. IX), në botën islame u zgjua një interes i paparë ndaj shkencave. Si rezultat i këtij 'oreksi', dolën në pah mjaft zhvillime të rëndësishme. Ndaj dhe në vitet në vazhdim, myslimanët kryesuan në prodhimin e shkencës dhe të

Do ishte vallë tepër herët të korrigjonim padrejtësinë që i kemi bërë një populli, të cilit, nga fanatizmi fetar, i kemi mohuar të drejtën për një vlerësim objektiv e të barabartë, të cilit ia kemi hedhur sistematikisht poshtë arritjet e mëdha, të cilit ia kemi maskuar apo fshehur kontributin thelbësor që ka dhënë në qytetërimin tonë?...

5. Bu konuda daha geniş bilgi için bk. Ziya Kazıcı, İslam Kültür ve Medeniyeti, İstanbul 1996, fq. 185-186.

6. Montgomery Watt, İslam'ın Avrupa'ya Tesiri, Hulusi Yavuz, İstanbul 1986, fq. 11

7. Sigrid Hunke, Dielli i Allahut shkëlqen mbi Perëndimin, përkth. O. Ademovi, Tiranë, 2007, fq. 8 – 9.

8. Watt, İslam'ın Avrupa'ya Tesiri, fq. 39.

dijes. Me kontributin e tyre në shkencë apo me akademitë shkencore, qendrat e observimit dhe medresetë që u ndërtuan në Azi të Mesme, Spanjë dhe Afrikën Veriore, myslimanët përgatitën periudhën që quhet Rilindje. Në shekujt në vazhdim, institucionet në fjalë janë bërë modele që janë kopjuar nga europianët.

Sipas historianit të shkencës, George Sarton, çdo 50-vjeçar mes viteve 750 – 1100, meriton të përmendet si epoka e atyre shkencëtarëve të mëdhenj myslimanë që kanë kontribuar për shkencë dhe kanë vënë emër për kontributin e tyre. Sipas tij, koha mes 750 – 800 duhet përmendur si “Epoka e Xhabirit”, 800 – 850 si “Epoka e Harizmit”, 850 – 900 si “Epoka e Razit”, 900 – 950 si “Epoka e Mes’udit”, 950 – 1000 si “Epoka e Ebul-Vefasë”, 1000 – 1050 si “Epoka Birunit dhe Ibn Sinasë”, 1050 – 1100 si “Epoka e Ibnul Hajthemit dhe Omer Hajjamit”. Sërish sipas Sartonit, periudha gjer në 1300-ën, pesëdhjetvjeçarët e shkencës tashmë u duhen adresuar emrave të shkencëtarëve me prejardhje europiane. Por edhe gjatë kësaj periudhe duhen përmendur emrat e Ibn Rushdit, Nasiruddin Tusiut dhe Ibnun-Nefsit.

Briffault-i, në veprën “Making of Humanity”, thotë kështu: *“Fenomeni që e quajmë shkencë, u soll nga arabët në Europë dhe ka lindur si shkak i metodave eksperimentale, vëzhgimore dhe matëse. Shkencë është dhurata më e rëndësishme që i ka dhënë qytetërimi islam botës.”*⁹ Megjithatë, duhet të nënvizojmë edhe këtë: shkencëtarët myslimanë, megjithëse u përkisnin racave dhe kombeve të ndryshme, veprat i shkruanin arabisht. Ndaj dhe shpeshherë, në vend të qytetërimit islam është përdorur nocioni *qytetërimi arab*.

Si sot, ashtu edhe në kohët e mëparshme, anëkend botës janë bërë dhe po bëhen studime serioze, që nxjerrin në pah produktin e qytetërimit islam. Një pjesë e këtyre studimeve trajtojnë vetëm një fushë të caktuar, kurse pjesa tjetër trajton në tërësi qytetërimin islam. Natyrisht, ne s’mund t’i analizojmë të gjithë këto punime. Për të krijuar një ide, po përmendim vetëm njërin prej tyre, se si është trajtuar një fushë e caktuar.

Qytetërimi islam, në kohën e lulëzimit të tij, shekulli i 10-të, kishte depërtuar në të gjithë botën islame, nga Himalajat deri në Pirenej, nga Deti i Zi deri në Ishullin e Edenit. Mbi tokat e Bagdadit, Sirisë dhe Irakut po krijoheshin traditat e shtetit botëror të Lindjes së vjetër. Ky qytet, që është pika kyçe e të gjitha rrugëve tregtare të Azisë së Vogël, ishte bërë një qendër e takimit të të gjitha lëvizjeve

ndërkombëtare.

Marramendja që të jepte madhështia e sarajit në Bagdad, magjepste popujt e tërë, pasi kishte mbledhur thesaret në të dy anët e botës. Bagdadi, qyteti i Harun er-Rashidit, u zhvillua si qyteti më i madh dhe më madhështor i shtetit. Në kohën e ndritur, në Bagdad jetonin dy milion banorë. Sarajet i jepnin qytetit një paraqitje madhështore. Ato rrethoheshin nga vilat, komplekset e këndshme dhe kopshtet me kafshë e shpendë. Pikërisht prej këtu, buronin frymëzimet e pasura fantastike, frymëzime, të cilat i jepnin mendjes artistike gjithnjë detyra të reja.

Faktori më i fuqishëm, që nga gjeneza e punimeve madhështore mjaft të dobishme, ishte sfera intelektuale, e cila ishte nën drejtimin e vullnetit të kalifëve, që dinin t’i dilnin për zot produktit intelektual të të huajve. Në sajë të përkthimit në mënyrë sistematike dhe graduale, u përfshinë të gjitha degët. Gjithashtu, u zhvillua mjaft edhe veprimtaria e qëmtimit të veprave të huaja. Kjo veprimtari

kaloi një etapë zhvillimore edhe më të madhe në kohën e abasive. Myslmanët morën veprat origjinale me shkrim dore, kundrejt kapitaleve të mëdha ose nëpërmjet rrugëve diplomatike. Veprat, të cilave u jepnin më shumë rëndësi, ishin ato të grekëve. I kushtuan vëmendje edhe literaturës perse dhe sanskrite. Gjetën njerëz të përshtatshëm për t’u marrë me veprat e mjekësisë, matematikës, astronomisë dhe gjeografisë.

Më pas, u zhvilluan filozofia dhe shkencat e natyrës. Kultura islame e shpëtoi nga shkatërrimi (asgjësimi) thesarin kulturor të Greqisë së Lashtë. Myslmanët mblodhën dhe ruajtën prej shekujsh me radhë diturinë e lashtë helene. Përkthimet e bëra nga arabët

edhe sot e kësaj dite, përbëjnë një rëndësi të madhe nga aspekti i kritikës tekstuale dhe për të plotësuar disa boshllëqe që janë krijuar në letërsinë e lashtë. Kësisoj, brenda një kohe relativisht të shkurtër, u zgjerua vizioni dhe botëkuptimi. Autorët myslimanë nuk u mjaftuan vetëm me përkthimin e diturisë së huaj. Përkundrazi, ata sollën një dije të re, origjinale. Qytetërimi islam, i cili ishte përhapur në tre kontinente, thajse të pakufij, dha provat e pakrahshueshme të aftësisë njerëzore për njohjen që ekzistonte në shtetin e madh islam. Bagdadi, Xhundishapuri, Kajroja, Kajravani dhe Fezi ishin qendra mjaft të rëndësishme të kulturës islame. Në këtë periudhë, niveli kulturor i arritur në Bagdad, është arritur edhe në Spanjë, e cila ishte marrë nga arabët në vitin 711, ku bënte pjesë një popullatë heterogjene. Pas një shekulli, ashtu si në Lindje, po u jepej një shtysë në zhvillimin e kulturës islame për ta prezantuar si triumf kombëtar edhe brigjeve të Kadalkuvirit, paralel me Eufratin dhe Tigrin.

9. Për më shumë njohuri shih. Ahmet Yüksel Özemre, 21. Yüzyılda Türkiye’de Bilimin Geleceği, Çerçeve (1996), 17., fq. 35-37.



Nuredin Nazarko

Që kur lind, njeriu është shumë plak për të vdekur

Jeta është një mrekulli dhe si e tillë i shfaqet qenies njerëzore. Çdo qenie njerëzore është ekzistencë unike, e përsëritshme dhe e pangjashme me askënd, para dhe pas saj dhe si rrjedhim, çdo qenie njerëzore ka historinë e vet të të jetuarit mbi sipërfaqen e lëmshit të dheut, përderisa lind, jeton dhe vdes mbi këtë sipërfaqe. Historia e gjithësecilës qenie mbi sipërfaqen e lëmshit të dheut, natyrshëm është e lidhur me historinë e shkeljes së këtij trualli nga qenia e parë njerëzore, përderisa në origjinën e hershme jemi pasardhës pikërisht të kësaj qenieje. Natyrshëm që përballë mrekullisë së jetës, qenia njerëzore nisur nga pakuptueshmëria e kësaj mrekullie, shtron pyetjen se si u shfaq qenia e parë mbi lëmshin e dheut apo pse pikërisht këtu dhe jo në ndonjë cep tjetër të universit, pyetje që për shumë qenie njerëzore vazhdojnë të mbeten mister. Pavarësisht misteriozitetit të mbërritjes apo shfaqjes së qenies së parë njerëzore mbi sipërfaqen e tokës, njeriu jeton mbi tokë dhe nën qiell dhe ky është një fakt, për të cilin askush nuk mund të perfrazojë të kundërtën. Për filozofinë ekzistencialiste, qenia njerëzore është “e hedhur”, “e flakur” në botë, pra në ekzistencë. Flakja, nisur nga kuptimi që buron prej saj, është një proces më radikal, më i pamëshirshëm, pasi atë që flaket, e ke përbuzur, nënçmuar dhe urreyer më së pari dhe, pasi e ke flakur, nuk kujdesesh aspak për të, madje mbetet e harruar prejse ishte e padëshiruar, e pavlefshme. Ndërmjet disa kuptimeve shohim se “i hedhur” nënkupton, të sjellurit e diçkaje nga një vend tjetër, pra kjo diçka nuk i përket vendit ku vendoset, por në origjinën e saj, i përket vendit prej nga u soll. Sjellja në një vend tjetër, nuk do të thotë harresë, mospërkujdesje, por hedhje për një qëllim të caktuar, që pritet të realizohet nga i hedhuri. Pra fakti i pandryshueshëm që njeriu është hedhur në ekzistencë, do të thotë se qenia njerëzore nuk

i përket kësaj toke, edhe pse jeton në të, por i përket jetës prej nga ku mori statusin “i hedhur” dhe jo “i flakur”. Kësisoj, “hedhja” është origjina e historisë së qenies njerëzore mbi tokë, që, edhe pse e huaj për të, qysh në çastin e hedhjes do të ishte mikpritësja e tij, vendndërtimi i qëllimit të hedhjes. Hedhja apo zbritja (*si koncept religjioz*) dhe vendosja e njeriut mbi tokë dhe nën qiell, është një ngjarje dramatike për qenien njerëzore, pasi shkapet lidhjen direkte me vendin e tij të origjinës, i cili pas kësaj ngjarjeje mbetet kujtesë e pashlyeshme për të hedhurin e parë, për të zbriturin e parë. I hedhuri apo i zbrituri, edhe pse tashmë do të jetojë në këtë tokë mikpritëse, nuk mund ta shlyejë nga kujtesa, banesën e tij të parëhershme, rifitimin e së cilës dhe rikthimin në të do t’i duhet ta ndërtojë pikërisht mbi atë vend që nuk i përket atij dhe as ai nuk i përket aspak këtij vendi. Meqenëse as i hedhuri apo i zbrituri nuk i përket vendit ku u hodh, ku zbriti, por dhe as vendi ku u hodh nuk i përket të hedhurit, atëherë kalimi prej këtu atje, është bashkekzistenca e pashmangshme e të hedhurit me vendin e hedhjes dhe, përderisa flasim për kalim, bashkekzistenca nuk mund të jetë e përvetshme, pra do të jetë e përkohshme. Përkohësinë e bashkekzistencës sonë me vendin mikpritës e shkakton një ngjarje tejet e rëndësishme, vdekja. Kësisoj, shënohen tri ngjarje të rëndësishme të qenies njerëzore, në raport me bashkekzistencën, lindja-jeta-vdekja. Njeriu lind, jeton dhe vdes i vetëm, pra ekziston si i tillë. Natyrisht që ky përcaktim nuk përjashton marrëdhëniet e njeriut me botën, por i mëshon faktit që ekzistenca dhe përgjegjësia për të jetuarit e saj, është personale, përderisa është e përsëritshme. Duke qenë e papërsëritshme, do të thotë se qenia njerëzore lind, jeton dhe vdes vetëm një herë mbi tokë dhe nën qiell. Kështu, rrugën e kthimit në vendin prej nga

ku u hodh në ekzistencë qenia njerëzore, do ta përshkojmë vetëm njëherë dhe kthimi ynë nuk mund të ndodhë, në qoftë se ekzistenca jonë nuk pushon në krahët e vdekjes. Ekzistenca, në kuptimin heideggerian, do të thotë të jetosh me përgjegjshmëri, të durosh në vuajtje dhe kënaqësi, të durosh në të mirë e në të keq, durim i cili kulmon me durimin në vdekje dhe gjatë gjithë përkohësisë, njeriu duhet të jetë i përgatitur. Pra njeriu, qysh kur lind, është një qenie për të vdekur, sepse pa këtë ngjarje që quhet vdekje ne nuk do të mund të riktheheshim në banimin tonë të parëhershëm. Gjatë rritjes dhe zhvillimit fizik dhe mendor njeriu bëhet i vetëdijshëm që një ditë ai do të vdesë. Qysh në çastin që embrioni njerëzor fillon të jetojë, vdekja qëndron përballë nesh dhe jemi ne që ecim drejt saj, sepse përkohësia jonë rrjedh. Ne jemi të sigurt që një ditë do të vdesim, por nuk mund ta dimë kur, pra ne nuk mund të dimë çastin në të cilin ekzistenca jonë përfundon, çastin në të cilin ne do të shkelim situatën kufi, sikundërse e përcakton Jaspersi vdekjen. Meqënëse ky çast është krejt i panjohur për ne se kur ndodh, do të thotë se ne mund ta takojmë në çdo çast të jetës sonë, në çdo çast të përkohësisë sonë, edhe pse duket sikur nuk do të mbërrijë ndonjëherë. Siguria për vdekjen dhe mosnjohja kur, shkakton gjendjen e ankthit, ankth nga vdekja, sepse ankthi është gjendja në të cilën unë e di që do të ndodhë, por nuk e di se kur dhe jam gjithmonë në pritje të ndodhjes. Natyrisht kjo është një gjendje së cilës nuk mund t'i shpëtojmë, dhe në sajë të kësaj gjendjeje mbajmë ndezur mosharresën e takimit me vdekjen. Përderisa ekzistenca përfundon me vdekjen dhe kjo ekzistencë e përfunduar nuk mund të ekzistojë dhe njëherë tjetër, ne nuk mund të kemi një përvojë mbi vdekjen, sepse askush nuk mund ta përshkruajë më pas atë që ka përjetuar. Vdekja është një përjetim dhe ajo vetëm përjetohet dhe nuk mund të kthehet kurrë në përvojë, pasi që nuk është një rast që mund të merret në studim, pra nuk mund të eksperimentojmë me vdekjen. Pamundësia e eksperimentimit me vdekjen, na fakton se vdekja nuk është thjesht dhe vetëm pushim i funksioneve biologjike të trupit njerëzor, pasi, që trupi të jetojë, ka nevojë për ngrohtësi. Këtë ngrohtësi të domosdoshme për të jetuar biologjikisht, trupi e merr prej shpirtit, për eidosin e të cilit nuk kemi të zbuluar asnjë dituri. Simbioza trup-shpirt është një mrekulli, të cilën nuk mund ta shpjegojmë racionalisht. Në qoftë se bashkimin trup-shpirt nuk mund ta shpjegojmë dot racionalisht, atëherë dhe ndarjen, shkëputjen e njërit prej tjetrit nuk mund ta shpjegojmë dot racionalisht, thjesht na duhet ta pranojmë këtë ngjarje që ndodh me ne dhe që nuk mund ta shmanjim. Ne mund të shohim vuajtjet, përpëlitjet dhe regëtimet e fundit të atij që vdes, por kurrë nuk mund të vëzhgojmë sesi shpirti shkëputet prej trupit, pasi që shikimi ynë ndaj ngjarjeve metafizike, është jofunksional. Qetësimi i trupit pas regëtimave të fundit, na bën të vetëdijshëm që tjetri vdiq, pra dha shpirt. Pyetja që na shqetëson më shumë është se çfarë ndodh me njeriun pas vdekjes? Thamë se ekzistenca përfundon me vdekjen dhe kjo ekzistencë e përfunduar nuk mund të ekzistojë dhe njëherë tjetër. Nisur nga ky fakt, ne nuk mund të ekzistojmë dy herë, për-

ndryshe ajo çfarë përjetohet gjatë dhe pas vdekjes do të kthehej në përvojë dhe për qenien njerëzore në pritje të vdekjes, nuk do të ishte më një mister se çfarë ndodh gjatë dhe pas vdekjes. Ekzistenca jonë përfundon me vdekjen, por kjo nuk do të thotë që ne nuk jemi më. Vdekja është fundi i ekzistencës, (*fundi përgjegjshmërisë*), por jo fundi i të qenit tonë (*nuk ka më durim deri në vdekje*). Ne nuk ekzistojmë pasi vdesim, por vazhdojmë të jemi, sepse ekzistenca njerëzore në kuptimin heideggerian të saj, është veçori e të qëndruarit tonë mbi tokë dhe nën qiell. Pra, vdekja është kufiri mes ekzistojmë dhe jemi dhe kufi nuk do të thotë që gjithçka pushon së qeni aty, por prezenca e kufirit do të thotë që përtej tij zë fill e manifestohet gjithësa deri në shkeljen e tij qëndronte e fshehur dhe e pazbulueshme. Duke qenë një kufi mes ekzistoj dhe jam, vdekja shndërrohet në domosdoshmëri për trajektoren e lëvizjes së qenies njerëzore nga përkohësia në përjetësi, pasi që moskthimi në ekzistencë (*përkohësi*), do të thotë qenie në përjetësi. Në qoftë se ne thamë që njeriu është qenie për të vdekur, dhe vdekja porta e kalimit në përjetësi, atëherë fare mirë mund të themi se njeriu është qenie për përjetësinë. Tashmë mund të shtrojmë një pyetje tjetër, pyetje që shndërrohet në dilemën e madhe të shumë qenieve njerëzore. A është përjetësia, përjetësi në asgjë?

Po ç'mund të thuhet mbi asgjënë? Që është hedhur poshtë nga shkenca dhe është lënë mënjanë, përpikmërisht si e pavlefshme? Po pse, duke e lënë mënjanë në këtë mënyrë, mos vallë bëjmë të kundërtën, e pranojmë atë? E më tej, a mund të flasim vallë për pranimin, kur ky pranim nënkupton të pranojmë asgjënë? Apo mos vallë, shprehja jonë, tashmë e pështjelluar, shthuret në një zënkë boshe mbi fjalët. Për këtë arsye kundrejt saj, shkenca lipset të ripohojë sot gjithë seriozitetin dhe kthjelltësinë e saj mendore, duke këmbëngulur që ajo merret me qeniet dhe vetëm me qeniet. Se tek e fundit, asgjëja ç'mund të jetë tjetër për të, përveç një fyerje dhe një fantazmë? E nëse shkenca ka të drejtë, atëherë diçka është vërtetë e sigurt: se ajo nuk dëshiron të dijë asgjë për asgjënë. Aq më tepër që ky është dhe koncepti shkencërisht rigoroz i asgjësë. Ne e njohim atë, d.m.th. asgjënë, në kuptimin se nuk duam të dimë asgjë për të.¹ Po përse shkenca nuk dëshiron të dijë asgjë për asgjënë? Pikërisht se shkenca studion qeniet si realitet lëndor, të cilat mund t'i laboratorizojë, asgjëja i shpëton realitetit lëndor dhe si e tillë nuk mund të rrokët nga përvoja shqisore dhe eksperimentale, tek e cila bazohet shkenca moderne, e cila është e prirur të mos pranojë tjetër realitet përveç atij lëndor. E në qoftë se ne pranojmë asgjënë, do të thotë që ne pranojmë se "asgjëja është origjina e mohimit dhe jo anasjelltas"², d.m.th. se pa praninë e asgjësë (*praninë e të pranishmit*), nuk do të kishim se çfarë të mohonim, sepse "Qenia e kulluar dhe Asgjëja e kulluar, janë e njëjta gjë."³ Atëherë, çfarë mund të jetë mohimi i përjetësisë, përveçse pranim i saj?

1. Heidegger, M. (2003) *Leksione dhe konferenca*. faq.74 Tiranë: Plejad.

2. Po aty, faq. 86

3. Hegel, G.F. *Shkenca e logjikës*, Vëllimi I, pjesa e III, cituar sipas Heidegger, M. (2003) *Leksione dhe konferenca*. faq.90 Tiranë: Plejad.

Neslihan Nur Turk

Respekti është si një Kandil



Në pjatën e një *njeriu të Zotit* ndodheshin tre ullinj. I pari tha:

- Sa i shëmtuar që jam. Kush më ha mua! Kam një fytyrë të zezë katran. E mbi të gjitha jam edhe i athët dhe bërthamën e kam shumë të madhe.

Ulliri i dytë tha:

- Eh, për çfarë shqetësohesh edhe ti! Unë nuk kam as tul e as bërthamë normale. As piruni nuk ngulet tek unë, jam një gjë e thatë.

Ulliri i tretë tha:

- Unë i kam edhe fytyrën edhe bërthamën të bukura. Kam shije të mirë, jam krijuar i veçantë. Kam një respekt të plotë për veten time, sepse ai që më krijoi është Allahu. Mos më shihni ashtu, thoni "Mashallah!"

Ndërkohë, vjen *njeriu i Zotit*, u hedh një sy ullinjve me një vështrim të thellë. Duke buzëqeshur zgjat dorën tek ulliri i tretë. Tha "bismil-lah" dhe e hëngri me kënaqësi, sepse ulliri i tretë kishte një tërheqje të ndritshme, si pasojë e respektit që kishte ndaj Krijuesit.

E njëjta tërheqje ndodhet tek të gjithë ata njerëz që e dinë se ai që i veshi shpirtin e tyre me trup është Allahu, tek ata që kanë reshtur së ankuari për vetullën, syrin, hundën dhe, tek ata njerëz që e kanë flijuar veten e tyre për evoluimin shpirtëror. Këta njerëz, ngaqë gjithnjë buzëqeshin me mirënjohje, dita – ditës zbukurohen edhe më shumë. Ata, për arsye të respektit që kanë, janë gjithnjë në sexhde fizikisht dhe shpirtërisht përpara Zotit të tyre. Bindja e tyre ndaj Allahut dhe të qenit të kënaqur për përcaktimin e Tij, i bën më të respektuar nga krijesat e tjera.

Një krijesë që nuk është mirënjohëse për krijuesin e saj, nuk pret t'i vijë respekti. Respekti është si kandili, ndriçimi i tij duhet ushqyer gjithnjë me një mirënjohje të vërtetë!

Në rrugë ishin dy njerëz. I pari tha:

- Aman, kujdes! Shpohesh!

I shijonte shumë jeta. Kaloi duke bërë kujdes se mos shpohej nga gjembat në rrugë.

Njeriu i dytë që po vinte pas tij, tha:

- Allahu ta paska mbushur të jashtmen me gjemba. Kushedi sa i rëndësishëm duhet të jetë ushqimi yt i brendshëm. Duke marrë përsipër gjakosjen, e kapi gjembin në dorë. Pa i kushtuar vëmendje dhimbjes, e hapi. Gështenja i buzëqeshi në duar me respekt njeriut të dytë. Kushedi që kur gështenja po priste njeriun që e meritonte.

Sepse njeriu i dytë kishte një tërheqje të ndritshme që vinte nga respekti për të brendshmen. Ai nuk i kushtonte rëndësi shtresës së jashtme të mbushur me gjemba. Për arsye se njihte të brendshmen dhe nuk përbënte rëndësi për të e jashtmeja. Kështu arriti aty ku fshehej shija dhe shërimi. Urtësia është si një gështenjë e fshehur në shtresën e jashtme të saj. Fshihet nga njerëzit egoistë, të vrazhdë, të parespektshëm dhe i hapet atyre që sakrifikojnë.

Për të arritur në thelb, duhet shumë mund. Njerëzit që mundohen meritojnë respekt. Respekti është si një kandil. Ndrichimin e tij duhet ta ushqesh gjithnjë me një durim të madh.

Në një shkrepse kishte disa fije. E para thotë:

- U mërzita duke djegur kokën për hir të tjerëve. Ç'profesion që është ky i yni! Ose na duhet të rrimë brenda një kutije kaq të ngushtë, ose sa të dalim na duhet të digjemi. Mjaft, u mërzita! Ç'detyrë qenka kjo!

Fija e dytë:

- Po, le të protestojmë! U konsumuam kot gjer sot. Le të kërkojmë të drejtën tonë tashmë! Na flijojnë sa na marrin në dorë. Mjafton, le të na dëgjohet zëri tashmë!

Edhe fjetet e tjera i mbështeten, duke duartrokatur e fishkëlluar. Vetëm njëra prej tyre nuk entuziazmohej, sikur ishte zhytur në mendime. Në fund fija e tretë dha një vendim të tillë:

- Ç'kuptim mund të kishte ekzistenca ime në këtë botë, nëse do të isha një fije shkrepseje që nuk do të flijojë kokën time për qëllimin e krijimit tim? Përderisa sobat, oxhaqet, qirinjtë, kandilët kanë nevojë për sakrificën time, si mund të bëhem unë egoiste? Allahu im! Unë jam e kënaqur me detyrën që më është dhënë. Nëse nuk e bëj detyrën time, sa e sa vende do të ishin të errëta, sa e sa oxhaqe do të ishin të fikur, sa e sa vatra do ishin të ftohta. Ngaqë e di shumë mirë këtë, zemra ime gufon me dëshirën për t'u bërë shkak për mirë.

Ndërkohë, një dorë zgjatet dhe merr kutinë. Në mesin e të gjithë këtyre fijeve, zgjedh të tretën. Fija pranoi me kënaqësinë më të madhe të digjej. U gëzuan të gjithë drunjtë që u ndezën, të gjithë vatrën që u ngrohën. Falënderuan Allahun për atë fije shkrepseje që flijoi kokën e saj për të shërbyer, sepse fija e tretë kishte një tërheqje të ndritshme, që vinte nga vetëdija dhe përgjegjësjë e qëllimit të ekzistencës.

Vetëdija e Resulullahut (a.s.), që bënte dua për mirë për popullin e Taifit është pikërisht qendra e kësaj tërheqjeje dhe është një thesar i paçmueshëm! Rruga e atij që është dhënë pas rehatisë së vet, nuk kalon tek pëlqimi përmes brengës. Ai që nuk kalon kështu përmes brengës, nuk mund ta ketë duanë të brendshme, sytë të përbotur, mendjen me mendime. Si mund të jetojë njeriu pa marrë përsipër të flijojë veten e vet për kauzën e tij? Kur njeriu nuk është egoist, por sakrifikes, i zgjerohet bota e mendimeve, i hapet horizonti. Ndaj dhe ka begati në punë. Njeriu, në vend që ta angazhojë mendjen për interesa të vogla, duhet ta bëjë atë të funksionojë në rrugë të Allahut, me dashuri, vullnet dhe besim. Të pasurit e vërtetë janë ata që mund ta bëjnë një gjë të tillë dhe një pasuri e tillë e mendjes u dhurohet pak njerëzve.

Ata që e kanë mendjen të zënë me meditime, me një entuziazëm të madh janë gjithnjë të gatshëm. Respekti

është si kandili, ndrichimin e tij duhet ta ushqejmë gjithnjë me mendime të duhura.

Respektohet ai që do krijesat, ngaqë do Krijuesin e tyre, ai që sheh urtësinë përtej sipërfaqes, që kupton qëllimin e krijimit dhe që përpiket të jetë një krijesë e mirë e Krijuesit. Ai që është mirënjohës, që është durimtar, që është i arsyeshëm meriton respekt, sepse respekti është një ndjenjë e veçantë që ndihet ndaj atyre që kanë vlera, që janë të ngritur dhe të dobishëm. Po, respekti është si një kandil. Ashtu sikurse edhe njeriu i respektuar... Ndrishmëria që reflektohet nga shikimet e tij, nga shpirti i tij, nga fjalët e tij dhe nga sjelljet e tij, ndriçojnë sa e sa errësira.

Respekti është si një zinxhir. Çdo njeri nëse bën atë çfarë duhet të bëjë, me vetëdijen e një hallke të këtij zinxhiri, zinxhiri rritet, bëhet stoli, bëhet i çmuar. Mirëpo, njeriu harron se është një hallkë e atij zinxhiri, në vend që të merret me shërimin e sëmundjes së vet, nëse rri duke u marrë me fajësimin e të tjerëve, atëherë i njëjti zinxhir i lidhet për duar, për gojë, për shpirt dhe bëhet një prangë e rëndë dhe e ndryshkur për të.

Nuk i shkojnë prangat një besimtari. Besimtari duke ushqyer shpirtin me besim vjen në një formë të mirë. Dashuron, gëzohet me bisedën me atë që e meriton. Dashurohet, dhe e di që kjo vjen si një dhuratë nga Allahu. Respekton, gëzohet t'i dhurojë respektin atij që meriton. Bëhet i respektuar, bëhet i thjeshtë përballë atij që respekton.

Ashtu sikurse çdokush kërkon të dashurin, besimtari më shumë përmend Zotin e vet. Fjalët që zgjedh, fjalitë që formon, e bën një nga hallkat më të bukura të zinxhirit të të respektuarve. I jep mundësinë që të garojë në të mirë, të flasë të vërtetën, i shton vlerë vlerës së tij, shton njerëzit që i sillen përreth me dashuri. Natyrisht, njeriu e respekton atë që e do. Për sa kohë që e respekton, i shtohet dashuria.

Besojmë se, lartësia e vërtetë është afrimiteti me Zotin. Atëherë ne, kur nuk e bëjmë të mangët respektin ndaj Zotit padyshim atëherë ne bëhemi njerëzit që Zoti u dhuron respekt.

Njerëzit që bëjnë kujdes gjuhën nga gafleti dhe që përmendin Zotin gjithnjë, atëherë edhe Ai i sheh me respekt. Respekti është si një kandil, ndrichimin e tij gjithnjë duhet ushqyer me dhikër, ditë e natë.

Gjithmonë ka diçka që duhet kujtuar, duhet ta themi: ashtu sikurse njeriu është një qenie që dobësohet, fuqizohet, gjallohet dhe vdes, ashtu i ka edhe të gjitha ndjenjat... Ndrichimi i kandilit të respektit venit, nëse i kushton rëndësi, nëse i jepet ajo çfarë meriton dhe nëse shpërfillet. Vetëm besnikëria, qendrueshmëria dhe sinqeriteti ia shton ndrichimin. Respekti është si një kandil, që duhet ushqyer me dashuri.



Përse “NJË YMET I VETËM” ka mbetur thjesht një sllogan emocional?

Asgar Ali Enginer

Prej katërmëdhjetë shekujsh dëgjojmë slloganin një Zot, një Pejgamber, një Kuran dhe domosdoshmërinë e krijimit të një bashkësie të vetme islame. Nga ana tjetër, është interesant fakti se dijetarët vazhdimisht citojnë hadithin: “Ymeti im do të ndahet në 72 grupe. Nga këto, vetëm një grup është i shpëtuar.” Në këtë mënyrë, biem në kundërshtim me vetveten. Në njërën anë dëshirojmë bashkimin, nga ana tjetër e ndajmë ymetin në 72 grupe kontradikore me njëra- tjetrën.

Në fund të shekullit të dytë hixhri, Abdulkadir El-Bagdadi shkroi veprën e famshme “El Fark Bejn el-Firak” (Dallimet midis sektëve), ku trajton 100 sekte të ndryshme të njohura deri atëherë midis myslimanëve. Ne duhet të kuptojmë se me sllogane emocionale nuk mund të sjellin bashkim dhe, sa më shumë sllogane të tilla të hedhim, aq më shumë do të përçahemi. Në fakt, divergjencat politike, sociale, ekonomike dhe kulturore midis myslimanëve filluan të nxjerrin krye jo shumë kohë pas vdekjes së Muhamedit (a.s.).

Çlirimet, ndryshe nga ç’mendohej, e bënë situatën më komplekse duke sjellë fuqi, pasuri dhe ndikim të huaj, i cili i acaroi më tepër mosmarrëveshjet, ndonëse sekteve

iu desh ca kohë për fituar një strukturë dhe diferencë teologjike. Për të kuptuar dhe analizuar këto diferenca, duhet shkuar përtej teologjisë, duke u përpjekur për t’i gjetur më thellë shkaqet.

Së pari, duhet të kuptojmë që mesazhi islam solli ndryshime rrënjësore, më tepër nga se mund ta përfytyrojmë, në shoqërinë arabe të asaj kohe. Mesazhi islam ndryshoi pa kthim mbrapa themelet fetare, morale, shoqërore dhe politike. Por ndryshimi ndodhi aq shpejt, sa që arabët nuk e përvetësuan siç duhet. Ajo që e bënte gjendjen akoma më tragjike, ishte mosprania në mesin e myslimanëve të udhëheqësit të tyre të dashur dhe të respektuar, Muhamedit (a.s.).

Myslimanët për arsye të ndryshme, por më tepër në emër të konsolidimit dhe përhapjes së revolucionit rrënjësor islamik, ndoqën një politikë më tepër të hapur zgjerimi, sesa një politikë të mbyllur. Mesazhi kryesor i Kuranit është morali dhe sjellja e drejtësisë dhe barazisë në shoqëri. Kurani shpesh flet për imantin e shoqëruar me vepra të mira, për besimin tek profetët dhe ditën e gjykimit.

Së dyti, Kurani solli një vizion të ri barazie dhe drejtësie

shoqërore, duke e vënë theksin mbi dinjitetin njerëzor dhe lirinë e ndërgjegjes. Ai gjithashtu krijoi një rrugë të mesme të re, që i dha individit dhe shoqërisë liri ndërgjegje dhe dinjitet të panjohur tek arabët deri atëherë. Arabët ishin tepër të lidhur me traditën dhe thellësisht të zhytur në kulturën fisnore përkatëse.

Në vend të kulturës fisnore, Islami solli një kulturë të re, tepër humane dhe universale. Por nuk ishte e lehtë për njeriun ta shkëpuste veten prej traditave paraislamike apo siç u quajt nga myslimanët, periudha *xhahilije* (periudha e injoracës), sepse ndikimi saj ishte aq i thellë, saqë thjesht pranimi i Islamit nuk mund të sillte ndryshimin e nevojshëm për një transformimin shoqëror total.

Kurani solli një stil të ri ligjërimi nga pikëpamja morale dhe artistike në gjuhën arabe. Poetët e famshëm arabë mbetën të mahnitur nga kjo gjuhë.

Ata e gjetën veten të paafte për të sjellë një gjuhë të ngjashme me atë të Kuranit. Ky ligjërim nuk ishte i mbushur vetëm me bukuri stilistike, por qëndronte lart edhe nga ana morale, sepse qëllimi i Kuranit ishte krijimi i një njeriu dhe shoqërie të re. Ikbali e shpreh në këtë mënyrë: " Nëse jeni besimtarë, krijoni një botë të re dhe mos jetoni më në botën e vjetër."

Ky njeri i ri nuk do të mjaftohej vetëm me pranimin e të gjitha vlerave të Kuranit, si tevhidin, dinjitetin e njeriut, lirinë, diversitetin, të vërtetën, mëshirën, barazinë, drejtësinë dhe trimërinë, por sahabët ia kushtuan veten kultivimit të kulturës së re dhe fuqizimit të vizionit të ri islam.

Ndërsa vlerat e huaja, të cilat për nga natyra ishin autoritare dhe feudale, e dëmtuan gjithë procesin. Pushtimet e përkeqësuan akoma më tepër procesin. Çlirimet devijuan nga qëllimi kryesor për të shpalosur vizionin etiko-moral të Kuranit, duke pasur si qëllim kryesor zgjerimin, fuqizimin dhe pasurimin e shtetit. Procesi për krijimin e një shoqërie vizionare u përball që në fillimet e tij me pengesa serioze. Shoqëria islame filloi të polarizohej. Një pjesë ishte e angazhuar vetëm me të mirat materiale tokësore, një pjesë tjetër luftonte vetëm për pushtet, kurse një pjesë tjetër merrej vetëm me anën shpirtërore, duke preferuar një jetë askete të veprimtarive jetësore.


Dinastia umejade, e cila për nga natyra ishte represive dhe autoritare, kur erdhi në pushtet u mbështet më shumë në modelin romak se sa në vlerat dhe vizionin islam. Pushteti i umejadëve tregoi simpati për kulturën paraislamike të arabëve dhe bëri përpjekje për të ringjallur poezinë dhe kulturën paraislamike. Libri Kitabul Agani (libri i këngëve), i cili u shkrua duke marrë për bazë poezinë paraislamike, u bë jashtëzakonisht popullor në mesin e myslimanëve. Dikush mund të kundërshtojë, duke argumentuar në të drejtën e çdo populli, në rastin tonë të arabëve për të ringjallur trashëgiminë e tyre të pasur. Ky argument mund të jetë pjesërisht i vërtetë. Gjithë ajo perandori arabe e fqishme dëshironte të shkonte në gjurmët e trashëgimisë kulturore nacionale, prej së cilës e ndjenin veten krenarë. Por, kur bëhet fjalë për shoqërinë islame, jemi të detyruar t'i qasemi në një këndvështrim tjetër dukurisë.

Përpjekja për të ringjallur kulturën paraislamike ishte tragjike për shoqërinë islame, sepse qëllimi i kësaj nisme ishte prirja për pushtet dhe kënaqësi, pa marrë parasysh modelin shoqëror që dëshironte të krijonte shoqëria islame.

E dyta dhe më e dëmshme, ishte shndërrimi i ligjëritit dhe stilit paraislamik në modë, madje edhe fjalët e kuptimet kuranore u përpoqën t'i kuptonin sipas kuptimeve në poezinë paraislamike.

Në fakt, Kurani krijoi një gjuhë të re shumë të pasur me kuptime. Ai ishte ligjërim moral dhe revolucionar, i mbushur me vlera të reja për të ndërtuar një shoqëri të re dhe Kurani e përdori këtë ligjërim për të përmbushur këtë qëllim. Unë mendoj se ishte një fatkeqësi përdorimi i poezisë paraislamike si kriter për të kuptuar kuptimet e Kuranit. Ndoshta ky ndikim deri diku ishte i paevitueshëm, por pasojat që solli e dëmtuan seriozisht vizionin e synuar nga Kurani.

Çështja e tretë e rëndësishme ishte natyra e furishme e debateve midis dijetarëve, që filloi të përhapej së tepërmi me dobësimin e themeleve morale islame. Debadet teologjike mbi vullnetin e lirë apo jo të njeriut kishin arritur kulmin. Klasa drejtuese kishte përfitime të mëdha nga këto debate. Nëse fati i njeriut ishte i paracaktuar, atëherë edhe regjimi i dinastisë umejade ishte i paracaktuar dhe i paprekshëm, thënë ndryshe, ishte



caktimi i Allahut.

Siç e shprehëm, Kurani thekson lirinë e ndërgjegjes, madje edhe shejtanit iu dha liria dhe e drejta e zgjedhjes për t'u përlur apo jo në shenjë respekti para Ademit. Njeriu filloi të konsiderohej si lodër përballë përcaktimit hyjnor. Dijetarët u polarizuan sipas preferencave politike. Ata që nuk donin të sfidonin pushtetin umejade, e pranuan si regjim politik dhe qëndruan larg veprimtarive politike, kurse një grup si pjesë e klasës politike në fuqi, rendi pas përfitimeve.

Kishte edhe dijetarë me integritet moral, që guxonin të ngrinin zërin dhe refuzonin të bëheshin pjesë e klasës politike në fuqi, duke ia kushtuar veten kultivimit dhe promovimit të vlerave dhe vizionit islam. Por fatkeqësisht dijetarë të tillë ishin të paktë në numër.

Çështja e katërt, Abasitë ndërmorën një nismë të fshehtë për të sfiduar pushtetin e umejadëve, të ndihmuar edhe nga Irani, i cili e ndjente veten të mënjanuar, si nga ana politike, ashtu edhe nga ana kulturore përballë epërsisë dhe hegjemonisë arabe. Persianët e pranuan Islamin, por kurrë nuk u bënë pjesë e procesit kulturor dhe politik. Persianët pranuan të ndihmojnë Abasitë, në këmbim të një roli më të rëndësishëm në procesin politik, dhe Ebu Myslim Horasani organizoi një mbështetje ushtarake për Abasitë kundër pushtetit Umejade.

Irani zotronte një trashëgimi të pasur politiko-kulturore. Ata i konsideronin arabët barbarë, nomadë dhe të pa kulturë. Kur Abasitë erdhën nuk pushtet, nuk kishin ndërmend ta ndanin atë me joarabët. Prandaj, gjëja e parë që bënë kur erdhën në pushtet, ishte eliminimi i Ebu Myslim Harasanit. Por Abasitë u treguan të zgjuar, duke u ofruar poste kyçe shumë intelektualëve persianë. Kjo bëhej për të dhënë përshtypjen e bashkëqeverisjes. Persianët nuk dominuan dot në arenën politike, por patën ndikim të madh në rrafshin kulturor. Ky ndikim dha përfundime të rëndësishme në fushën morale dhe sociale. Mënyra e qasjes ndaj Islamit pësoi ndryshime intelektuale dhe sociale. Lëvizja Mutezile nën mbrojtjen e Abasive fitoi një dinamikë të re, duke sjellë polemika të ashpra mbi krijimin e Kuranit. Këto debate të furishme sollën përçarje akoma më të madhe në mesin e myslimanëve. Ndërsa umejadët nxitën në mënyrë të vetëdijshme debatet mbi

vullnetin e lirë të njeriut, Abasitë nxitën debatet mbi krijimin e Kuranit.

Të dyja çështjet mund të kenë ose jo rëndësi filozofike dhe intelektuale, por këto debate larguan vëmendjen nga çështjet politike, sociale dhe ekonomike. Debatet teologjike sollën një polarizim të tejskajshëm. Në të njëjtën kohë, Abasitë mbështetën përkthimin në arabisht të filozofisë greke, persiane dhe indiane. *Bejtul Hikme* (shëpia e dijes) u bë qendër e intelektualëve dhe shkencëtarëve. Arabët u bënë prijës në matematikë, biologji, kimi, teknologji dhe në disa shkenca të tjera. Në fakt, ky ishte një kontribut i madh intelektual i myslimanëve, dhuruar gjithë njerëzimit. Kjo ishte një dallgë intelektuale entuziaste, e paparë. Por në të njëjtën kohë, kjo solli përçarje më të thella në mesin e ymetit Islam, duke sjellë lindjen e sekteve të reja. Më të njohurit ishin

Ismailitë dhe Kermatilerët, që njihen ndryshe si batini. Këta pretendonin se mesazhi i vërtetë i Kuranit ishte i fshehur, kurse kuptimi i parë i jashtëm i tij, është për masën e gjerë të popullsisë.

Sekti Ismailije u nda në disa nënsekte të tjera. Kermatët ishin një nëndegë ekstreme e Ismailitëve. Përmes interpretimit ezotorik të Kuranit, pretendonin se ishin të përjashtuar nga detyrimet fetare. Kermatët arritën të krijojnë një shtet në Bahrein, i cili zgjati 30 vjet. Një ndër shkaqet e dënimit me vdekje të Mensur Hallaxhit ishte edhe akuza si anëtar i sektit të Kermatëve dhe komplotit për të rrëzuar regjimin

Abasit.

Në të njëjtën kohë, Kermatët ishin rivalë të regjimit Fati-mi në Egjipt. Tahir Kermati rrëmbeu haxherul esved (gurin e zi) nga Qabja dhe e mbajti për 30 vjet në Siri, ku krijoi regjimin e tij. Vetëm pas përpjekjesh të mëdha arritën ta bindnin për të kthyer gurin e zi në Qabe.

Në të njëjtën kohë, ekzistonte një ndasi dhe polarizim i madh midis sunive. Dijetarët reaguesh kundër vërshimit të filozofisë së huaj në botën islame dhe për të mbrojtur Islamin, zhvilluan shkencën e kelamit, përmes së cilës u përpoqën të hidhnin poshtë pretendimet e filozofëve. Është i njohur debati midis Gazaliut dhe Ibn Rushdit. Shumë dijetarë të tjerë u vunë kundër filozofisë, duke krijuar grupe të mëdha ndjekësish, siç është rasti i Imam Eshariut.

*Ne nuk po jemi të aftë
në kapërcimin e divergjencave
për të arritur bashkimin e ymetit.
Duhet të zhvillojmë strategji
të mirëfillta, larg ndikimeve
emocionale për të shpalosur
imazhin dinjitoz dhe paqësor
të Islamit.*

Të gjitha këto dhe krijimi i shteteve të vogla provinciale, përshpejtuan rënien e regjimit Abasit. Mund të merreshin masa për parandalimin e mosmarrëveshjeve dhe polarizimit të tejskashëm në botën islame. Dijetarët tradicionalë reaguesh kundër rrymave filozofike. Të njëjtën gjë bënë edhe disa filozofë. Nga ana tjetër, ishin Kermatët të cilët e përjashtonin veten nga detyrimet fetare.

Ismailitë, të cilët themeluan shtetin Fatimi në Egjipt, u treguan më të kujdesshëm në ruajtjen e ekulibrave midis batinive dhe zahirive (ezotorike dhe ekzotorike). Në fakt ishin Fatimitë ata që i bindën Kermatitë për kthimin e gurit të zi.

Një tjetër mosmarrëveshje ishte ajo midis mistikëve dhe filozofëve. Mistikët e vendosnin theksin mbi shpirtin, kurse filozofët mendonin se e vërteta mund të arrihej vetëm përmes mendimit. Në këtë mënyrë, humbi koncepti kuranor "Rruga e mesme". Kurani shpalos një model gjithëpërfshirës dhe të pashoq, duke përfshirë të gjitha elementët e rëndësishëm të jetës, si shpirti, mendja, morali dhe materia.


Kurani u bën thirrje besimtarëve të kontribuojnë në pëparimin material, të mendojnë mbi krijatat e Allahut, të pasurojnë dhe forcojnë marrëdhëniet shpirtërore me Krijuesin, të mos mburren me sukseset e tyre materiale, të ruajnë ekulibrin përmes pajisjes me vlera morale dhe të nxjerrin mësim nga pësime të parëve. Kurani dha një kontribut të ri në të gjitha këto aspekte.

Përpjekjet dhe debatet teologjike për ta kuptuar Kuratin përmes ligjërit arab paraislam, i dëmtuan rëndë këto veçori të Kuranit. Më e keqja, shumë komentues të Kuranit nuk u mjaftuan me interpretimin përmes modelit paraislam, por në të njëjtën kohë, përfshinë në tefsiret e tyre mite dhe legjenda prej burimeve hebreje dhe kristiane, të cilat e dëmtuan rëndë shpirtin e Kuranit, duke e shndërruar në një labirinth mitologjik tefsirin e Kuranit.

Interpretues si Fahrudin Razi, u përpoqën të përdorin llogjikën deduktive aristoteliane në interpretimin e Kuranit. Të gjitha këto u bënë shkak për debate jofrytëdhënëse. Debatet teologjike u bënë shumë komplekse, të

vështira për t'u kuptuar nga myslimanët e thjeshtë. Fikhu (jurisprodenca islame) u bë burim diskutimi për çështje të parëndësishme si "gjatë namazit duhet t'i ngrejmë apo jo duart". Në vend që të ishte burim i moralit sublim, Fikhu u bë shkak përçarjeje midis myslimanëve, duke u shndërruar në objekt studimi për çështje të parëndësishme e qesharake.

Sot jemi në një periudhë, ku mosmarrëveshjet midis myslimanëve janë edhe më të mprehta. Siç e përmendëm, këto mosmarrëveshje ishin politike, teologjike dhe intelektuale dhe shumë të vështira për t'i zgjidhur. Klima aktuale politike në botën islame i ka mprehur akoma më shumë këto mosmarrëveshje. Për këtë arsye, sllogani "*Një ymet i vetëm*" mbeti një sllogan bosh. Më e keqja, se çdo përpjekje për bashkim rezultoi me ndarje të reja.



Bota arabe është e copëtuar për arsye të interesave politike. Ekziston një hendek i madh midis arabëve dhe joarabëve. Madje, ata nuk janë në gjendje t'i përgjigjen bashkërisht sfidave politike që vijnë nga Amerika dhe Izraeli. Ky realitet nuk mund të anashkalohet. Për të zhvilluar strategji të përbashkëta, duhet të jemi realistë dhe të mos rrëmbelemi nga retorika.

Myslimanët janë të prirur të jenë emocionale dhe përballë çdo provokimi për përçarje e ndjejnë veten të pasigurt. Për këtë arsye, zhvillojnë reagime emocionale në përpjesëtim të drejtë me pasigurinë që ndjejnë. Sulmet ndaj Islamit janë shtuar më shumë se kurrë më parë dhe kjo i shtyn myslimanët të reagojnë akoma më emocionalisht, në vend të një reagimi sa më racional dhe strategjik. Duhet një zgjuarsi dhe pjekuri politike e madhe për t'u përgjigjur këtyre mësymjeve. Reagimet emocionale, protestat e rrugëve dhe më keq akoma, përdorimi i forcës dhe terrorizmi, nuk bëjnë gjë tjetër veçse e nxisin më tepër armikun të sulmojë edhe më ashpër.

Në nuk po jemi të aftë në kapërcimin e divergjencave për të arritur bashkimin e ymetit. Duhet të zhvillojmë strategji të mirëfillta, larg ndikimeve emocionale për të shpalosur imazhin dinjitoz dhe paqësor të Islamit. Kjo do të rriste shumë respektin për Islamin dhe myslimanët në gjithë botën.

Veprimtaria e qeverisë së Vlorës

Qeveria e Vlorës e filloi punën në rrethanat e jashtëzakonshme të krijuara nga shpërthimi i Luftës Ballkanike, gjatë së cilës trojet shqiptare u kthyen në shesh lufte ndërmjet ushtrisë osmane dhe ushtrive greke dhe serbo-malazeze. Menjëherë pas Shpalljes së Pavarësisë, në fillim të dhjetorit, gjithë Shqipëria Veriore dhe e Mesme ishte e pushtuar nga trupat serbo-malazeze. Shkodra vazhdonte qëndrësën, por ishte e rrethuar. Trupat greke po futeshin në jug, ndërsa luftanijet bllokoni bregdetin, duke prerë çdo mundësi të lidhjes së Vlorës me botën e jashtme.

Megjithatë, krahinat kryesore të vendit u bashkuan me aktin e Shpalljes së Pavarësisë dhe e njohën Qeverinë e Përkohshme si autoritet qendror. Në këto rrethana, territori në të cilin qeveria e shtrinte pushtetin ishte shumë i kufizuar, ai përfshinte trekëndëshin Vlorë-Berat-Lushnjë. Shtrirja e pushtetit të qeverisë zgjerohet pas vendimit të Konferencës së Londrës për caktimin e kufirit verior, nga fundit i marsit 1913.

Në verën e vitit 1913 për Qeverinë e Vlorës u krijuan mundësi për ta shtrirë më tej autoritetin e saj, duke përfshirë gjithë tokat që i mbeteshin Shqipërisë. Në të vërtetë, brenda tre muajve vihet re një gjallërim i veprimtarisë për ngritjen e hallkave kryesore të administratës shtetërore. U bë një ndarje e re administrative territoriale, e cila filloi të vihej në jetë me shpalljen e Statutit Organik, të miratuar më 1914.

Mbi përpjekjet e Qeverisë së Vlorës për organizimin e brendshëm shtetëror hedhin dritë jo vetëm dokumentet vendëse, siç ishte p.sh. organi "Përlindja e Shqipërisë", por edhe raportet e konsujve të huaj në vend.

Një ndër shqetësimet e para të Qeverisë së Përkohshme ka qenë ngritja e një force të armatosur, e një ushtrie sado të vogël për t'u mbrojtur nga sulmet e fqinjëve. Në fillim të qershorit 1913, në Vlorë u ngrit një lloj organi ushtarak me emërtimin "Zyra e Shtatmadhorisë". Ajo hartoi një "Rregullore të Milicisë Shqiptare", sipas së cilës kjo milici do të ishte një forcë, organizuar mbi bazën e detyrimit të përgjithshëm ushtarak. Ajo do të kishte detyrën të mbronte vendin derisa të krijohet një ushtri e rregullt. Në Vlorë mendohej edhe për modelin e sistemit ushtarak. E bindur se modeli ushtarak austro-hungarez ishte më i përshtatshëm për kushtet e vendit, qeveria e përkohshme i kërkonte Vjenës akte të ndryshme, libra shërbimi lidhur me organizimin, stërvitjen e shërbimin e brendshëm të armëve të ndryshme të ushtrisë, si këmbësoria, kalorësia, artileria, xhenioja, prapavija e shëndetësia. Ky projekt nuk shkoi më tej se një objektiv i parakohshëm, i parealizueshëm në këto rrethana. Qeveria e Vlorës vijoi të mbështetej në forcat ushtarake vullnetare.

Ndër masat më të rëndësishme, një vend të veçantë zë shpallja e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare. Njohja e "gjuhës

amtare me shkrim e këndim" vihej si kusht i domosdoshëm për emërimin e nëpunësve në çdo degë të administratës së re. "Përlindja e Shqipërisë", në një nga numrat e vjeshtës së 1913-ës, e quante këtë masë "më të bukurin urdhër që ka dhënë qeveria gjer më sot".

Shprehja më e qartë dhe e thellë e vullnetit politik të Qeverisë së Vlorës për të organizuar administratën, kryesisht me forcat e brendshme, është padyshim "Kanuni i përtashëm i administratës civile të Shqipërisë", që u botua në fundin e nëntorit 1913. Ky akt ligjor themelor për kohën sanksiononte parimin e pushtetit të përqendruar.

"Kanuni" trajtonte çështje të administratës vendore, njësitë



e kompetencat e tyre, por nuk bënte fjalë për organet më të larta të shtetit. Ai nuk kishte karakterin e përmbajtjen e një ligji të plotë themeltar, nuk ishte kushtetutë. Një qëndrim i tillë vetëkufizues nuk ishte i rastit, sepse ishte e qartë që Fuqitë do të caktonin vetë me marrëveshje ndërmjet tyre një princ të huaj në krye të shtetit. Qeveria e Vlorës orvatej t'i vinte përpara faktit të kryer Fuqitë. Me veprimtarinë e saj konkrete gjatë muajve që qëndroi në fuqi, Qeveria e Vlorës tregoi se nuk do të rrinte duarkryq. Megjithatë, ndërtimi i shtetit nuk do të bëhej pa pjesëmarrjen evropiane.

"Kanuni" përmbante edhe dispozita për zgjedhjet në njësitë administrative. Të drejtën e zgjedhjes së Këshillit të krahinës e kishte çdo banor në moshën 21 vjeç, kurse të drejtën për t'u zgjedhur e kishte çdo shtetas 21 vjeç e lart.

Në fushën e organizimit të sistemit gjyqësor, në maj 1913, qeveria e përkohshme vendosi që të lireshin në fuqi ligjet dhe aktet normative të kohës së sundimit osman, derisa të hartoheshin e të miratoheshin ligje të reja. "Kanuni" i ndante gjykatat nga administrata; shpallej pavarësia e gjyqësorit, organet shtetërore nuk mund të ndërhyjnë në fushën e

drejtësisë.

Qeveria e Vlorës u përpoq të merrte disa masa të karakterit më të ngutshëm edhe në fushën ekonomike. Në këtë përpjekje ajo ndeshej me shkatërrimet e dëmet e shumta që pësoi vendi nga Lufta Ballkanike. Vendin kryesor ndër detyrat që qëndronin para saj, e zinte siguri i burimeve financiare e monetare, si dhe krijimi i organizmave dhe i institucioneve përkatëse.

Qeveria e Vlorës e kishte të qartë se zhvillimi i bujqësisë, ngritja e industrisë dhe ndërtimi i rrjetit të komunikacionit mund të realizoheshin kryesisht përmes koncensioneve që do t'u jepeshin kapitaleve të huaja. I. Qemali kishte shprehur mendimin se ato nuk duheshin dhënë vetëm në dorë të një fuqie të madhe, por të disave prej tyre. Me këtë qëndrim besohej se do të mbroheshin më mirë interesat e Shqipërisë përballë Fuqive.

Qeveria e Vlorës i kushtoi vëmendje edhe çështjes së arsimit. Shpallja e Pavarësisë e gjeti vendin me një numër shumë të kufizuar shkollash. Kishte 250 shkolla fillore dhe disa dhjetëra plotore. Në qytetet kryesore kishte nga një gjimnaz të vogël. Shkollat shqipe ishin të pakta. Objektivi i qeverisë ishte hedhja e themeleve të një sistemi arsimor me frymë kombëtare. Ministria e Arsimit, që në hapat e parë të veprimtarisë së saj, mori masa për vitin shkollor 1913-1914. U hapën disa shkolla në trevën e administruar nga Qeveria e Vlorës, në Elbasan, Berat, Lushnjë, Kavajë, Shijak, Krujë, Durrës. Në vitin shkollor 1913-1914 u hapën dhe zhvilluan mësim 64 shkolla shqipe, shumica në fshatra. Në Shkodër, pas largimit të Komisionit ushtarak ndërkombëtar, u hap shkolla shqipe me mësues Gaspër Mikelin.

Një element bazë i zhvillimit ishte gjuha amtare. Me iniciativën e Luigj Gurakuqit, Ministria e Arsimit ngriti një komision, i cili do të merrej me hartimin e terminologjisë shqipe për degët e ndryshme të administratës, të arsimit dhe të sferave të tjera të jetës së vendit. Komisioni filloi nga puna në qershor 1913 dhe arriti të përgatiste termat për sferat e drejtësisë, financës, ushtrisë. Në nëntor 1913 u vendos të ngrihej edhe një qendër shkencore për studimin e gjuhës amtare të programeve dhe të teksteve shkollore. Ishte projekti për themelimin e një "Akademie Kombëtare" për çështje të gjuhës e programeve shkollore.

Veprimtaria e Qeverisë së Vlorës shtrihej më së shumti në rrafshin e ideve, të aspiratave. Ajo ende ishte e brishtë si pasojë edhe e mosnjohjes prej Fuqive. Kështu, ditët e saj ishin të numëruara. Megjithatë, duhej vlerësuar drejt që, prej formimit të saj e gjatë gjithë kohës kur çështja shqiptare ishte në shqyrtim nga Konferenca e Ambasadorëve, kur edhe në veri dhe në jug nuk pushonin sulmet serbo-malazeze e greke, Qeveria e Vlorës nuk e ndërpreu asnjëherë veprimtarinë atdhetare. Përpjekjet e saj, edhe pse në rrethana tepër të acaruara, ishin shprehje e vullnetit politik për të ndërtuar shtetin me forcat kombëtare. Ishin po ashtu, një provë e aftësisë së elementit kombëtar për vetëqeverisje, që u kundërvihej argumenteve të kundërta të shteteve fqinje, planeve të tyre për copëtimin e plotë të Shqipërisë dhe për mohimin e pavarësisë së saj.



Të rinjt e sotshëm si mejtojnë edhe kujt i mbesojnë?

Nji pyetje kjo aqe me randsi sa munda të themi pa druajtësi fare se përgjegjëja e aajë meritonë studime të thella, dhe ka hijë me të vertet me qenë landa shkrimore e ç'do Rivistë qi ka për program mbarësin e njerzisë ashtu edhe udhëheqjen morale.

Nji pyetje kjo qi ka tërhequn mbas vedi mendimin e gjith botës, dhe qi përfundimi i përgjegjës do të na tregojë se shekulli i sotshëm me të rinjet e vetë cilli pritmë i është drejtuar tue i hedhun mrapa ç'ka ka gjetun si themele morali e mbesimi.

Po kalojnë do kohra qi n' Amerikë e Sosjeteja e krishterve të rinjë po vazhdonë në anqete mbi këtë pyetje, dhe po mbledhë përgjegjëjt për me kuptuëm sot si mejtojnë e kujt i mbesojnë të rinjët. Për fat të keqë përfundimi i këtyne studimeve po na jep të kuptojmë se të rinjet e sotshëm m'at nuk po i mbesojnë Fesë, dhe në Amerikë e Ingjilterë ku shquheshin njerzia me respektimin krishterizms sot të rinjet po thonë nuk i mbesojmë Zotit e se Feja e sotshëm nuk është e mundun të na perulim ndjenjat e mendimet me bazat e saja të gabueshme.

Kjo duhije kundreshtimi ka pushtuar Europën dhe asht hedhun në Asijë, po thuë se në mëndjen e gjith të rinjivet asht bamun nji hije e pa ndame. Tash mujin e fundit edhe Rivista e shquëme e Turqisë "Sevimli aj", i bante nji anqet mbi të rinjët e Turqisë dhe ndërmjetësonte me kuptuëm rezultatin për sa i përket vendit të vetë. Mbas evolucionit të madhë qi bani Turqija asht e ditun qi të rinjët e s'ajë nuk do të japin nji mendim të kundërtë me

ato të Amerikës, nuk do të mejtojnë tjetër llojë nga ata t'Europës qi po imitojnë tue marrë për shëmbëll të mirat e të ligat tokë.

Sa për të rinjët t'onë ktu në Shqipni nuk duhet të vrasim mendjen edhe aqi shum se pjesa e këtyne qi po marrin mësimin n' Europë naturisht po hiqen prapa atij rrymi qi ka marrë ky qytetnim dhe kanë me dalun në atë breg të çuditshëm qi po prapulizet i tanë rruzelemi.

Nji kryengritje mendimi është tue pushtuë me avullin e flakën e s'ajë të gjith të rinjet të cillët duanë t'i këputin marëdhanëjet qi kanë me tradicionet e kohrave të kalueme; të cillat nuk pelqejnë Fenë, rregullat sociale, lidhjet morale. Në shekujt e kaluëm shumë herë ka ndodhun qi njerzia e pushtruarë nga mësytypjet naturale ka arritun në harresën e Fev'e të zakoneve; por shekulli i sotshëm që numërohet m'at i përparuem se të tjerët nuk duket të ngeli prap i metë para shekujve qi kanë me ardhun.

Midis faktorëve kryesurë qi kanë shtytun të rinjet e sotshëm me këtë bindje janë lufta e Përgjithëshme, dhe mbas kësajë kurentet e çuditsëshëm të komunizms e të Fashizms. Me të vertetë nga mjerimet e luftës tue lindun komunizma me tjetër anë si shëmbëllë gjallënie kundra saj ringrefja e Fashizms i shkaktoj krye-këputë mejtimet e të rinjëvet. Për këta sot nuk ka ngelun nji fuqië shpirtnore të tërheqin mbas vedi, nuk ka ngelun nji streh adhurimi qi ti përmbledhim në gjinin e vetë të pastër. Këta ankohen nga jeta e sotshme sociale morale e Fetare, por nuk janë të zotnit të

kujtojnë një bazë të sakët për udhëheqjen e tyre
lëndore e shpirtënore.

Nuk mjaftonë qeshja e tyre me konsideratat e
moralit të vjetër, nuk siguron lumtënië liria e paku-
fizuëme që dëshrojnë të kenë për me rojtun pa kur
fare pengese të rinjë e të reja tokë tue mos qenë
mbi krye si një mprojtës i mirësjellimit Mëma, Ata,
Feja dhe Faltorja.

Nuk duhet të harrojmë se qytetëtnimi bazën e
vetë e ka të pështetun në jetën familjare dhe kjo
jetën e sajë ja ka huaj, ja detyron trashëgimit që
vargoset pa u çmuarë me raca e fize të tjera. Këto
i dinë të rinjë, dhe prandaj ankohen nga jeta tue
mos ditun cilës ideë kanë me u pështetun; kta janë
bamun krejt materialist dhe nuk mejtojnë tjetër
gjâ, veç se me fituë të holla, m'u bâmë pasanik me
rrojtun një jetë plotë qetije e zbavitje. Para syve të
riut sotshëm mâ i madhi njeri në botë është Krali
i Automobilavet: Fordi, mâ i vlefshemi Libër është
Romani i dashunisë.

Pra po e shofim çiltazi se në jetën e mbrendës-
hme kemi një shkretë të përgjithshme; as një gja
nuk na bindë dëshirat as kur sendi nuk kënaqë; si
një detë që përplasit me shtërgata ashtu tue lloç-
kitë tue u tramzuë mendimi i brezit të rijë dhe po
mundohet me gjetun shtroherën që të prekin pakë
ndjesit e ashpëruara.

Po vallë ku? Dhe kurë?...

Këta për m'e gjetun duhet t'a dimë ku jemi tue
shkuë? Profidet të rinjë e të remë a kanë me qenë
të zotnit si ata të vërtetët që të shpetojnë njëz-
min nga një shkatërrim i tillë? Neve jemi sigur që
shpirti sa duhet në faqe të dheut, porositi e tij aq
të nalta janë të mjaftëushme për mbarvajtjen e
jetës sociale e morale; por mjaftonë që njeriu tue
përparuëm mos të harronjë përfitimin e vlefshim
t'asajë fuqije shpirtënore.

Fuqia jetike e madhshëtore në gjithësi asht po
thuë si mëndja në trup të njeriut; po ngrite mën-
djën sa parë vlënë njeriu; shpirti ndaj fuqisë jetike
është si syni kundërt mëndjes; po mos të ishte drita
e synit si do të tregonte vehten mëndja?...

Me pakë fjalë duam të themi se mbesimi kund-
rejt Zotit është i domosdoshëm për njerinë; shpir-
ti sa do që nuk shifet, por me shfaqësinat e tij të

përhershme na detyron mos t'a mohojmë; në një
Trioletë shpirtënore që kemi shtypun në "GJIMIMIN
E TOMORRIT" kemi pas thanë:

Ku ke qenë e bukur lule,
Me këtë erë pa të metë;
As më thuaj mos je flutur,
Flutur e jetës së vërtetë;
S'i lule?

Shoqet në foletë,
Si u ndave nga ajo jetë?

Për të treguarë një shëmbëll se si ndodhet shpirti
në trup të njeriut mâ posht kishin thanë:

Si pasqyra në Dhom' t'errët,
Që s'tregon gjâ sendi brenda,
Të ka mbytyr krejt ënda;
Si përllante munë lerët,
Të është veshurë fytyra;
Nuk shkëlqen më si nga hera;
Je në Dimër të la vera!

Dhe me të vërtetë kur hedhim veshtrimet stud-
juëse mbi jetën e kaluëmë të njeriut takojmë shumë
herë në kundërshtim me çashtjen e ekzistencës të
shpirtit. Por nuk duhet harruë se mâ të lumnu-
him në këtë jetë kanë qenë e janë ato njerëz që
përpara universeri t'ambjentit janë të pështetun
në shtyllën e mbesimit (Le fondement de la foi).
Hafezi Shirazit ka pasë thanë:

Në këshillën e zëmres nga shkëlqimi i fytyrës
t'ande u ndezën një qind drita; Çudija është këtu që
në fytyrën t'ande ndodhën një qind llojë napash
(perde); dhe me të vërtetë njeriu pa dashun të kup-
tonji ç'është mëndja ose tue mos kuptuë nga cili
burim i ka ardhun drita e tij nuk asht i zoti të shofin
dritën e Zotit e cila në naurë shfaqet në trajta të
provimeve të përtritshme e të njëfarshim (expe-
riences repetes et homogènes) por nuk duhet të
harrojmë edhe mendimet e të mdhanjevet mend-
jetar si de karti e Malbranshi që thonë në gjithësinë
materiale shkaqet e ndodhinave e të ngjarjeve janë
Occasionnelles – ndermjetore për ditjen e Krijuesit
që është i vetmi urdhënuës i vërtetë. Malbranshi
ksodore ka pranue përfundimisht thurin "La vision
en dieu" vishtrim në Perendinë që të cilës Tesavufi
Islamikë i ka thanë:

d.m.th. nuk pashë as një gjâ që mos të shofë Pe-
rendinë në atë.

Butësia

Me të vërtetë, feja islame është fe e butësisë, e mirësisë dhe e dashamirësisë. Ajo kërkon që njeriu të jetë i butë, i njerëzishëm dhe i mëshirshëm me të tjerët. E tërë jeta e myslimanit, besimi, ibadeti, morali dhe marrëdhëniet e tij ndërnjerëzore duhet të jenë të ndërlidhura me butësinë. Me këtë cilësi, u dërgua edhe krijesa më e nderuar mbi sipërfaqen e tokës, Muhamedi (s.a.v.s.), i cili kërkonte nga njerëzit të ishin të butë dhe të mëshirshëm mes tyre.

Allahu i Madhëruar na e bën të qartë pozitën dhe prestigjin e personit më të dashur për Të, Muhamedit (s.a.v.s.) dhe na rrëfen shkaktuesin e njerëzit e deshën dhe u bashkuan pas tij! Pra, ishte pikërisht mëshira dhe butësia e madhe e tij, me të cilat ai i fitoi zemrat e njerëzve. Allahu (xh.sh.), në Kuranin famëlartë urdhëron: "Ti (o Muhamed), ishe i butë ndaj tyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë e, sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje..." **(Ali Imran, 159)**

Allahu (xh.sh.), na bën me dije në Kuranin famëlartë se butësia është një ndër cilësitë me të cilën ai i dërgoi të gjithë peygamberët e Tij, përpara se t'i dërgonte te faraoni, i cili e kishte shpallur veten zot, duke thënë: "Unë jam zoti juaj më i lartë!"

Allahu i madhëruar i porositi dy peygamberët e Tij, Musanë dhe Harunin (a.s.), duke u thënë:

"Shkoni te faraoni! Ai, me të vërtetë, i ka shkelur të gjithë kufijtë! I thoni fjalë të buta, ndoshta mendohet a frikësohet" **(Ta Ha, 43-44)**

Nëpërmjet këtyre ajeteve, Kurani i Madhëruar na ka treguar domethënien dhe rëndësinë e butësisë dhe na fton të gjithë ne myslimanëve të sillemi me butësi me të gjithë njerëzit, në mënyrë që të jemi të suksesshëm në realizimin e qëllimeve tona.

Transmetohet nga Ibn Abasi (r.a.), se Pejgamberi (a.s.), i ka thënë Eshexh ibn Abdulkajsit: "Ti zotëron dy cilësi, të cilat Allahu (xh.sh.), i do pa masë: sjelljen e butë dhe maturinë." **(Myslimi)**

Ne duhet të tregohemi të butë ndaj fëmijëve, prindërve, miqve e farefisit, më të rinjve, më të moshuarve, të dobtëve, të pikëlluarve, si dhe ndaj çdo njeriu tjetër me të cilin ne kemi marrëdhënie.

Në një hadith të transmetuar nga Myslimi Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

"Personi që nuk di të sillet me butësi, është si të jetë privuar nga të gjitha mirësitë!"

Një nga shembujt e butësisë së Pejgamberit (a.s.), është edhe tregimi i Thumame ibn Uthadit, njërit prej prijësve të fisit Beni Hanife. Ai ka qenë armik i përbetuar i Pejgamberit (a.s.) dhe kishte luftuar me ashpërsi kundër myslimanëve. Mirë-



*“Ti (o Muhammed),
ishe i butë ndaj tyre,
ngase Allahu të dhuroi
mëshirë e, sikur të ishe
i ashpër dhe i vrazhdë,
ata do të largoheshin
prej teje...”*

(Ali Imran, 159)

po, pasi e zunë rob, e ftuan për tre ditë rresht të pranonte fenë islame. Kur e pa i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.), se nuk dëshironte të hynte në Islam, u tha myslimanëve ta lironin, sepse e kishte falur. Pasi fitoi lirinë, Thumame filloi të mendohej thellë për ato që kishin ndodhur, duke thënë me vete: “Unë kam qenë armiku dhe kundërshtari i përbetuar i Muhamedit, por ai jo vetëm që nuk më detyroi ta pranoja Islamin, por edhe më shpëtoi jetën. Vërtet, një gjë të tillë nuk e bën kush përveç atij njeriu që ka moral profetik”. U pendua dhe menjëherë shkoi te i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.), të cilit iu drejtua me këto fjalë: “O Muhamed, dije se nuk ka pasur qytet më të urreyer për mua sesa qyteti yt, por tani ai është qyteti më i dashur. Nuk ka pasur fytyrë më të urrer për mua sesa fytyra jote, ndërsa tani nuk ka fytyrë më të dashur për mua se fytyra jote e ndritur. Nuk ka pasur fe më të urreyer për mua se feja jote, por tani nuk ka fe më të dashur për mua se feja jote, prandaj dëshmoj dhe deklaroj

se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se ti je i Dërguari i Tij”. Pra, shikoni se si ky njeri e përqafoi Islamin si shkak i butësisë së Muhamedit (s.a.v.s.).

Butësia, dashamirësia dhe sjellja e mirë forcojnë lidhjet mes besimtarëve. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Allahu e do butësinë në çdo çështje”.

(Buhari, Myslim, Ahmedi, Tirmidhiu)

Allahu është i butë dhe jep për butësinë shpërblime që nuk i jep për ashpërsinë. Këto shpërblime janë të veçanta vetëm për butësinë”. **(Myslimi)** Për këtë gjë, myslimanët duhet të jenë të butë dhe të dashur me njëri-tjetrin.

Ibn Mes’udi (r.a.) transmeton se Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Zjarri i xhehenemit nuk do t’i djegë njerëzit e butë, të thjeshtë dhe të dashur me të tjerët.”

(Tirmidhi, Ahmedi)

Njeriu duhet të dijë se çfarë ha

Nga Marifetnameja kuptojmë se natyra e një njeriu është e thatë ose e lagësht, e ngrohtë ose e ftohtë. Ushqimet që merr, ia shtojnë thatësinë dhe ftohtësinë ose ngrohtësinë dhe lagështinë. Nisur nga kjo, çdo njeri i vetë-dijshëm duhet ta njohë strukturën e tij, duhet t'i dijë veçoritë e rëndësishme të ushqimeve mjekësore që merr dhe të gjitha këto duhet t'i konsumojë duke pasur kujdes për kohën e tyre.

Spinaqi: është i ftohtë dhe i lagësht në shkallë të parë. Ushqimi me të është i shijshëm. Ai u bën dobi mushkërive të bardha dhe mëlçisë së zezë. E zbut barkun dhe lufton sëmundjet e shpinës.

Qepa: është tharëse në shkallën e dytë dhe ngrohëse në shkallën e tretë. Në të njëjtën kohë, është dekompozuese dhe zbutëse. Hap hyrjen e damarëve. Nëse i shtypet fara dhe me vajin e saj lyhet lëkura e sëmurë me lebrozë, e shëron atë. E shkul me kripë lurdhësin. Nëse hahet në mënyrë normale, forcon stomakun dhe hap oreksin. Qepa e zier është e dobishme. Liron rrugët e urinës, zbut natyrën e njeriut dhe lufton erërat helmuese. Nëse lidhet plaga me të, ndalon dhimbjet dhe rrjedhjet.


Veza e pulës: gjysmë e skuqur në vaj, është më e mira. Nëse veza zihet shumë, nuk ka asnjë lloj dobie. Por e verdha e saj ka shumë dobi për nxehtësinë dhe e bardha për të ftohtët. Nëse e lyejmë fytyrën me të bardhën e vezës, e mbron atë kundrejt rrezeve dhe nxehtësisë së diellit. Nëse e përziejmë të verdhën e saj me mjaltë dhe lyejmë me të dëmtimet dhe qukat e fytyrës, i shëron. Veza ka fuqinë e mishit dhe pjesa më e dobishme është e verdha e saj.

Arra: është tharëse në shkallë të parë dhe ngrohëse në shkallë të dytë. Shkakton dhimbje koke. Tretet me

vështirësi dhe jep shumë ngrohtësi. Vaji i saj është ndriçues, dekompozues dhe dobësues. Ajo është e dobishme për skuqjet, qukat dhe dridhjet e fytyrës. Është e dobishme për dhimbjet e kokës dhe të krahavorit. Largon rrufën dhe kollën e thatë, që kanë lidhje me të ftohtët. E forcon stomakun dhe qetëson zemrën. Hap bllokimet e mëlçisë së zezë. Është e dobishme për dhimbjet e veshkave dhe të mitrës. I vjen mirë errësimit të syrit dhe kataraktit.

Fiku: i freskët është pak i lagësht dhe i ngrohtë. Ka shumë lëng dhe ushqim. Tretet menjëherë në stomak. Është më i ushqyeshëm se të gjithë frutat e tjerë. Pjesa e tij ndërmjet bërthamës dhe lëkurës i pjek dhe i zbut plagët dhe ulçerën. E ul temperaturën dhe e rregullon ngjyrën që prishet prej sëmundjes. I pjek çibanët dhe u nxjerr qelbin. E heq kollën e vjetër. Është i dobishëm për mushkëritë e bardha dhe krahavorin. Hap bllokimet e mëlçisë së zezë, shpretkën, veshkat dhe fshikëzën e urinës. Është shumë i dobishëm kur hahet me bajame ose me arra. Nuk është mirë që fiku të hahet me ushqime të rënda. Ai që ha tre kokrra fiq para ushqimit, të zier në ujë me uthull, për tre ditë në mëngjes, shpëton nga ethet dhe tëmthi.

Nga këto që thamë më lart, mund të mendojmë se Hazreti Ibrahim Hakiu këshillon që njeriu duhet të jetë doktori i vetvetes, sepse ai e këshillon lexuesin e tij që së pari të njohë strukturën e trupit të tij, pastaj veçoritë e ushqimeve që i ka marrë si ilaç apo ushqim dhe mënyrën e duhur për përdorim. Ai tregon se duhet të respektohen parimet kryesore të mjekësisë mbrojtëse. Në fund, thotë: "Të gjitha ilaçet dhe ushqimet ndikojnë në lejen e Allahut të Madhëruar. Faktikisht, Krijuesi është Ai që u jep gjërave forcën e ndikimit. Ai u jep dobi apo u shkakton dëm gjërave."



Historia e postës elektronike

Nëse kodet e Morsit apo teleqramet i konsideroni si postë elektronike origjinale, dërgimi i tekstit nga një person tek tjetri ka evoluar padyshim. Hidhini një sy mënyrës si nisi zyrtarisht posta elektronike apo ndryshe e-mail dhe si është bërë një pjesë e madhe e jetës sonë, duke na konsumuar 28% të ditës.

1971: Programuesi amerikan Raymond Tomlinson dërgoi "qwertyuiop" si e-mailin e parë dhe ai ishte i pari që lidhi kompjuterin e tij me një kuti postare, duke përdorur simbolin "@".

1977: Metoda e e-mailit të Tomlinson-it ka punuar për kompjuterët në rrjet duke përdorur të njëjtin softuer, por shumë njerëz filluan përdorimin e Projektit të Rrjetit të Avancuar të Departamentit të Mbrojtjes Amerikane (ARPA), që të lidheshin me rrjetet jashtë.

1981: Agjencia Amerikane e Informacionit të Kodit Standard përshtati një proces shkronjash, shenjash pikësimi dhe simbolesh dixhitale për të ruajtur informacione.

1985: Qeveria dhe ushtarakët, studentët dhe profesionistët akademikë ishin përdorues të zakonshëm të e-mailit në mesin e viteve 1980.

1991: Pajisësit me Shërbim Interneti (ISP) lejuan qasje të gjerë në internet, por ka pasur opsione të kufizuara për përdorimin, derisa Tim Berners-Lee krijoi World Wide Web-in në vitin 1991.

1998: Futet "Spam" (emaili i padëshiruar) në Fjalorin e anglishtes të Oksfordit pas rritjes së saj në mesin e viteve 1990.

1991: Astronautët Shannon Lucid dhe James C. Adamson dërguan e-mailin e parë nga hapësira me një kompjuter Macintosh, duke shkruar 'Përshëndetje Tokë'.

1993: Kompanitë IDN dhe Bell South tregtuan celularin

e parë PDA, i cili shitej për \$900 dhe ka shërbyer si një telefon, makinë llogaritëse, faks, email dhe peixer.

1997: Microsoft-i bleu Hotmail-in për rreth \$400 milionë.

1998: Komedia romantike "You've Got Mail", me aktorët kryesorë Meg Ryan dhe Tom Hanks, doli në kinema (dhe uebfaqja e filmit ekziston ende).

2003: Black Berry hedh në treg telefonat e parë inteligjentë RIM 850 dhe 857, të cilët përhapën platformën e lëvizshme duke u përqendruar në e-mail.

2004: Presidenti Xhorxh W. Bush nënshkroi Aktin për Kontrollin e Pornografisë dhe Aktin e Marketingut në vitin 2003, i cili mori kritika për mungesën e veprimit kundër dërguesve të e-maileve të padëshiruara (spam).

2008: Presidenti Barak Obama u bë presidenti i parë që përdori e-mail në celular dhe pranoi varësinë e tij ndaj Black Berry-it, pavarësisht nga shqetësimet e sigurisë, ai aktualisht e përdor atë në zyrë.

2011: Një studim zbulon se fjalëkalimet më të pasigurta të email-it janë Passwordet123456.

2012: Ka më shumë se 3 miliardë llogari e-maili në të gjithë globin dhe rreth 294 miliardë e-maile dërgohen çdo ditë. Afërsisht 78% e tyre janë e-maile të padëshiruara.



Shkencëtarët amerikanë zbuluan një material të ri nano-mbrojtës.

Jelekët e rinj antiplumb

Një grup shkencëtarësh prej Universiteteve me famë botërore MIT dhe RICE, bënë të ditur zbulimin e një materiali të ri nano-mbrojtës të përbërë nga xhami dhe kauçuku. Nano-mbrojtësi nuk depërtohet as nga plumbat dhe as nga shrapnelat.

Ndërkohë që jelekët anti-plumb prej çeliku mbrojnë vetëm pjesën e gjoksit, materiali i ri nano-mbrojtës, do të mbrojë të gjithë trupin. Dr. Ned Thomas prej universitetit të RICE, tha se një lloj materiali i tillë mbrojtës kaq i hollë, nuk është prodhuar kurrë më parë. Gjithashtu, ai tha se brenda vitit të ardhshëm, materialin nano-mbrojtës do ta perfeksiononin edhe më tepër.

Bëhet e ditur edhe se të parët që do ta përdorin këtë material të ri mbrojtës, do të jenë forcat speciale amerikane.

ERDOGAN: Izraeli është shtet terrorist

Dhuna e Izraelit ndaj popullit të pambrojtur palestinez u aktivizua përsëri qyshkur Izraeli ka vrarë shefin ushtarak të Hamasit, që kontrollon Rripin e Gazës. Prej atij momenti, numri i të vrarëve dhe të plagosurve në territorin e Rripit të Gazës, sa vjen e shtohet. Nga sulmet ajrore me artileri të rëndë nga ana e ushtrisë pushtuese izraelite, kanë humbur jetën me dhjetëra foshnje, gra e të moshuar.

Për këtë arsye, në një takim të Këshillit Islamik të Euroazisë në Stamboll, Kryeministri turk, Rexhep Tajip Erdogan, e ka quajtur Izraelin "shtet terrorist".

"A mund të kenë vend në këtë botë ata që masakrojnë fëmijë? A mund të themi se ata respektojnë njerëzimin? Për këtë arsye, unë them se Izraeli është shtet terrorist", ka thënë Erdogan.

Ndërsa gjatë fjalimit që mbajti në Universitetin e Kajros, në Egjipt, kryeministri turk Rexhep Tajip Erdogan ka thënë: "Herët ose vonë, do të jepet llogari për ato foshnja të

pafajshme, të masakruara në mënyrë çnjerëzore. Llogaria ka për t'u kërkuar patjetër".

"Izraeli po realizon çdo lloj veprë çnjerëzore për ta kthyer rajonin në një pellg gjaku", - shtoi kryeministri Erdogan.

Kurse në konferencën e përbashkët të shtypit, organizuar pas takimit me Presidentin e Egjiptit Mursi, u vu në dukje se paqja nuk mund të ngrihet mbi gjakun dhe mbi vdekjen.

Në lidhje me Sirinë, kryeministri Erdogan vuri në dukje se Esad është vazhdimisht duke u përpjekur për të fituar kohë dhe tha: "Por me dhunë nuk mund të arrish prosperitetin".

Edhe presidenti i Egjiptit Mursi, vuri në dukje se Izraeli është një fuqi pushtuese në Palestinë. "Tashmë, vendet e rajonit nuk janë ato të mëparshmet, edhe liderët e rajonit nuk janë ata të vjetrit", - tha Mursi.

BERISHA: Rishqyrtim të historisë kombëtare

Në Tiranë është zhvilluar konferenca shkencore për rolin e Kosovës në themelimin e shtetit shqiptar. Gjatë seancave shkencore ligjëruan historianë eminentë, të cilët shqyrtuan rolin e figurave historike nga Kosova në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe më pas ndërtimin e shtetit shqiptar.

Konferenca është hapur nga ambasadori i Kosovës në Tiranë, Sylejman Selimi, ndërsa marrin pjesë edhe kryeministri Berisha, kryesocialisti Edi Rama, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi e shumë figura të tjera nga jeta politike e shkencore.

Gjatë fjalës së tij në konferencën shkencore "Roli i Kosovës në krijimin e shtetit shqiptar", ambasadori i Kosovës, Sylejman Selimi, theksoi se ky 100-vjetor nuk do të kishte kuptim pa pavarësinë e Kosovës. Ambasadori Selimi vlerësoi rolin e UÇK-së në Kosovë, duke i cilësuar aksionet e ushtrisë si shpresa e vetme që kishte populli në momente mjaft të vështira.

Në këtë konferencë kryeministri Berisha ka theksuar se në këtë 100-vjetor të shtetit shqiptar nuk kishte si të mungonte një konferencë për rolin e Kosovës në historinë e kombit tonë. "Pa Kosovën, kremtimet e 100-vjetorit do ishin të mangëta", ka deklaruar Berisha.

Për kreun e qeverisë shqiptare ka ardhur koha që të gjithë shqiptarët të mësojnë të vërtetat historike ashtu siç janë, pasi në Shqipëri historia ka qenë e manipuluar dhe në Kosovë e ndaluar.

"Roli i Kosovës në themelimin e shtetit shqiptar dhe në vazhdim ka qenë i madh. Në rast se i referohemi kohës së Kongresit të Berlinit, do gjejmë se Kosova u shndërrua në djepin ku po zhvillohej dhe konsolidohej përpjekja kombëtare e shqiptarëve. Në lidhjen e Prizrenit ideali kombëtar i shqiptarëve, u shndërrua në idealin udhëheqës të tyre", - ka theksuar ai.

Kryetari i Partisë Socialiste, Edi Rama, ka theksuar rëndësinë që vështirimi nga e kaluara të na shërbejë për të ndërtuar të ardhmen.

"Kjo është një përpjekje e ndarë e historianëve nga njëra anë dhe e politikës nga ana tjetër. Kemi jo pak energji të konsumuara në drejtim të paditur, për shkak të politikanëve që përpiqen të rishkruajnë historinë dhe historianëve që përpiqen ta modelojnë atë sipas interesave politike. Në këtë moment kaq themelor për shtetin, siç është 100-vjetori, ne duhet t'i referoheshim të ardhmes si domosdoshmëri për të mos humbur kohë", - u shpreh Rama.

Ai nënvizoi nevojën e bashkëpunimit, në mënyrë që siç tha ai, brezat që vijnë të mos trashëgojnë plagët e së kaluarës, Rama theksoi se lavdia e së shkuarës nuk mund të mbulojë dot boshllëqet e së ardhmes.

Sipas Ramës, sot Kosova dhe Shqipëria kanë mundësi të krijojnë një strategji kombëtare, që kapërcen kufijtë, e cila do t'i shërbejë përballimit të sfidave që do vijojnë nga bashkimi i dy vendeve në BE.